



Republika e Shqipërisë
Ministria e Mjedisit

Strategjia dhe Plani Kombetar i Veprimit për zbatimin e Konventës së Åarhusit

Tiranë 2005



Republika e Shqipërisë
Ministria e Mjedisit

Strategjia dhe Plani Kombëtar i Veprimit për zbatimin e Konventës së Åarhusit

Dokumenti është përgatitur nga grupi i punës:

Afërdita PONARI – Oficer për Komunikimin në Parkun e Prespës
Afroviti GUSHO – Shoqata “Refleksione” Pogradec
Ahmet MEHMETI - “Klubi Ekologjik” Elbasan
Bajram MEJDIAJ - Ministria e Mjedisit
Ermira DEÇKA – Ministria e Integritit
Kreshnik NOKA – Këshilli i Ministrave
Marita SELFO – Ministria e Shëndetësisë
Xhemal MATO - Shoqata “Massmedia dhe Mjedisi”, Tiranë

Falënderime

Falënderime të veçanta janë për Dhimitër Haxhimihali, Pika Fokale e OjF-ve Shqiptare për projektin REReP 2.2, Magda Toth Nagy, Drejtuese e Departamentit të Pjesëmarrjes Publike, në Zyrat Qendrore të REC për kontributin e tyre në procesin e zbatimit të projektit dhe komentet e dhëna në lidhje me materialin.

Mbështetur nga



THE REGIONAL ENVIRONMENTAL CENTER
for Central and Eastern Europe

Në kuadër të projektit REReP 2.2
“mbështetje për hartimin e strategjive për zbatimin e Konventës së Aarhusit”
financuar nga
Ministria e Punëve të Jashtme e Mbretërisë së Hollandës

Përmbajtja

Parathënie	3
Hyrje	5
Kreu I – Rezultatet e arritura për zbatimin e kërkesave të Konventës	9
Kreu II – Synimet dhe Objektivat	16
Kreu III – Përgjegjësitë e strukturave shtetërore	44
Kreu IV – Burimet Financiare për zbatimin	71
Kreu V – Monitorimi i zbatimit të Konventës	76
Plani i Veprimit	80
Shtojca	90

PARATHËNIE

Strategjia dhe Plani Kombëtar i Veprimit për zbatimin e Konventës së Aarhusit në Shqipëri është dokumenti bazë që parashtron politikën shtetërore për rritjen e rolit aktiv të shoqërisë civile, të publikut, të OJF-ve, të organizatave të biznesit e të individit në fushën e mbrojtjes së mjedisit.

Qëllimi themelor i hartimit, i miratimit dhe i zbatimit të tij është plotësimi i detyrimeve kushtetuese ndaj shtetasve që ata të jenë të informuar për gjendjen e mjedisit që mjedisi të mbrohet e të administrohet sipas kërkesave të parimit të zhvillimit të qëndrueshëm dhe që ata të jetojnë në një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për vete dhe për brezat e ardhshëm. Në këtë mënyrë, ai nxit përafime të dukshme me legjislacionin komunitar për çështjet e mjedisit, i cili, gjithashtu, synon të kontribuojë për ruajtjen, mbrojtjen dhe për përmirësimin e cilësisë së mjedisit, si dhe për mbrojtjen e shëndetit njerëzor.

I mbështetur në arritjet e deritanishme në vendin tonë, duke marrë parasysh mungesat dhe problematikën aktuale mjedisore kombëtare, vlerësimin e mbrojtjes së mjedisit si prioritet kombëtar, rritjen e shkallës së ndërgjegjësimit të vendimmarrësve, të publikut dhe të komunitetit, ky dokument sugjeron një sërë detyrash dhe përgjegjësish të rëndësishme për të gjithë aktorët, zbatimi me sukses i të cilave do të çojë në përmirësimin e dukshëm të pjesëmarrjes së publikut në mbrojtjen e mjedisit, do ta kthejë mbrojtjen e mjedisit në çështje të mbarë komunitetit.

Hartimi i politikave mjedisore dhe zbatimi i planeve të veprimit, përsosja e sistemit kombëtar të administrimit mjedisor, shfrytëzimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore, kompletimi dhe përafrimi i kuadrit ligjor rregullator me atë evropian dhe zbatimi i tij, rehabilitimi i zonave të nxehta dhe të ndjeshme mjedisore, nxitja e praktikave parandaluese në raport me ato korigjuese, kryerja e vlerësimit të ndikimit në mjedis për veprimtari të ndryshme dhe vlerësimi strategjik mjedisor për plane, programe dhe politika, plotësimi i detyrimeve që rrjedhin nga anëtarësia në marrëveshje ndërkombëtare, aktivizimi i qeverisjes vendore në problematikën mjedisore, pjesëmarrja në proceset mjedisore globale dhe rajonale, forcimi dhe bashkëpunimi i inspektoriateve që ndikojnë në mbrojtjen e mjedisit, nxitja e teknologjive të prodhimit të pastër, edukimi shkollor mjedisor, ndërgjegjësimi publik për mbrojtjen e mjedisit, administrimi dhe trajtimi i mbetjeve urbane, rritja e kapaciteteve për të thithur me efikasitet asistencën e huaj përbëjnë drejtimit kryesore të veprimtarive publike në mjedis që kanë ndikime të shumëfishta në zbatimin e kërkesave të Konventës së Aarhusit. Këto përfaqësojnë, gjithashtu, edhe drejtimit kryesore ku synohen informimi i vijueshëm i publikut dhe rritja e ndjeshme e pjesëmarrjes së tij.

I konceptuar me këto lidhje e varësi të gjera vertikale dhe horizontale, me detyra e përgjegjësi të identifikuar për secilin aktor, zbatimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit kërkon ngritjen e një organizmi ndërsektorial, të përbërë nga përfaqësues të ministrive e të organeve vendore që kanë detyra të rëndësishme në zbatimin e tij, të publikut dhe të shoqërisë civile, i cili do të udhëheqë, do të kontrollojë dhe do të ndihmojë zbatimin e këtij plani.

Për të ndjekur në vijimësi ecurinë e zbatimit të këtij dokumenti, për të siguruar informacione të vazhdueshme për veprimtaritë që kryhen në zbatim të tij, si dhe për të ndërhyrë në rastet e nevojshme, është bërë një përpjekje për të identifikuar indikatorët që matin punën zbatuese dhe efektshmërinë e saj. Është parashikuar, gjithashtu, prania e një organizmi përgjegjës, në nivel kombëtar, një OJF e specializuar që do të monitorojë zbatimin e kërkesave të Konventës dhe do të publikojë arritjet dhe mangësitë e këtij procesi.

Si dokument i rëndësishëm shtetëror në fushën e mbrojtjes së mjedisit, Strategjia dhe Plani Kombëtar për zbatimin e Konventës së Aarhusit, vjen kur mbrojtja e mjedisit po meriton gjithnjë e më shumë vëmendje të veçantë nga qeveria dhe publiku. Tashmë, për të gjithë është mëse e qartë se mbrojtja e mjedisit përbën një nevojë të domosdoshme për të arritur zhvillim ekonomik shoqëror të shëndetshëm e afatgjatë dhe cilësi të lartë jetese për sot dhe për të ardhmen.

HYRJE

Ndër Konventat mjedisore, me të drejtë, Konventa e Aarhusit është vlerësuar më e rëndësishmja, si Konventa e demokracisë në fushën e mjedisit. Ajo përfaqëson një dokument madhor ndërkombëtar me karakter të theksuar politik, sepse kërkon të realizohen në praktikë liri dhe të drejta bazë të njeriut në fushën e mjedisit.

Të përcaktuar përfundimisht në rrugën e demokracisë, publiku dhe shteti shqiptar, tek kjo Konventë identifikojnë të drejta e detyra, gjejnë hapësira për angazhime e gjithëpërfshirje, shohin mundësi për rakordime e koordinime, piketojnë alternativa dhe zgjidhje për trajtimin bashkëkohor të mjedisit, mbështesin në të synime dhe aspirata jetësore, për të tashmen e për të ardhmen.

E përcjellë në mënyrë të plotë dhe realiste, bëhet e qartë se puna e angazhimet për zbatimin e kërkesave të saj nuk mund të jenë formale. Ato duhet të mbështeten në mendësi bashkëkohore, larg shfaqjeve të fushatizmit, spontanitetit e rutinës. Për rëndësinë e problemeve me të cilat merret, për shtrirjet e gjera hapësinore e kohore, për angazhimet gjithëpërfshirëse që kërkon zbatimin e kërkesave të Konventës meriton një Strategji Kombëtare e një Plan Veprimi, ku natyrshëm ta gjejnë veten të gjithë të interesuarit e të detyruarit për zbatimin e saj.

Strategjia dhe Plani i Veprimit është konceptuar si dokumenti bazë, në të cilin janë fiksuar:

- Kërkesat që shtrihen Konventa për çdo shtet dhe shoqëri që e pranon dhe angazhohet ta zbatojë
- Përparësitë, synimet dhe objektivat ku do të arrihet me zbatimin e kërkesave të Konventës;
- Fushat e drejtimeve themelore ku do të kryhen veprimtaritë zbatuese;
- Të angazhuarit në nivel kombëtar dhe lokal, përfshi organet publike, OJF-të mjedisore, organizatat e biznesit, mediat dhe të interesuar të tjerë.
- Detyrat konkrete, të menjëhershme, afatmesme e afatgjata që do të përballohen nga secili prej të angazhuarve për zbatimin e Konventës.

Gjithashtu, në këtë dokument, bëhen përpjekje për të përcaktuar:

- Indikatorët në bazë të të cilëve do të monitorohen të gjitha veprimtaritë zbatuese për kërkesat e Konventës
- Dokumentet e standardizuara, në të cilat do të pasqyrohen veprimtaritë zbatuese
- Organizmi që monitoron (një OJF mjedisore kombëtare) zbatimin e Planit të Veprimit në nivel kombëtar
- Kostot dhe fondet që nevojiten për mbështetjen dhe për mbulimin e veprimtarive zbatuese

I hartuar me këto kërkesa e synime, shpresohet se ky dokument do të ndihmojë, sa të jetë e mundur që të gjitha veprimtaritë që do të ndërmerren në kuadër të tij t'i shërbejnë racionalisht zbatimin optimal të Konventës.

KREU I

REZULTATET E DERITASHME NË ZBATIMIN E KËRKESAVE TË KONVENTËS

I. Çfarë kërkon Konventa

Është e njohur që interesimi për mjedisin dhe mbrojtjen e tij ka ardhur duke u rritur në mbarë komunitetin botëror. Atyre u janë kushtuar legjislacionet kombëtare të të gjitha shteteve, si dhe dokumente juridike ndërkombëtare, globale e rajonale, të cilat kanë synuar unifikimin e qëndrimeve të shteteve të ndryshme për probleme të caktuara të mbrojtjes së mjedisit.

Nëse deri nga vitet '90 shumë nga këto dokumente, si Konventa, protokolle, marrëveshje u janë kushtuar, përgjithësisht, anëve materiale të mjedisit, në vitin 1998 u përgatit dhe filloi nënshkrimi i Konventës së Aarhusit që u kushtojë aspekteve shoqërore të tij, të cilat duket se kishin mbetur pas dhe duheshin emancipuar nëpërmjet demokratizimit të tyre. Në këtë sens, krahas angazhimit shtetëror për mbrojtjen e mjedisit, Konventa kërkon të fusë në veprim edhe angazhimin gjithëpërfshirës të publikut, rritjen e ndjeshme të rolit të shoqërisë civile që do të sjellin demokratizimin e ndjeshëm të marrëdhënieve mjedisore.

Si dokument juridik ndërkombëtar, Konventa përfaqëson një tërësi të drejtash, detyrimesh, rregullash e procedurash të detyrueshme për zbatim për shtetet që e nënshkruajnë dhe e ratifikojnë. Kërkesat e Konventës, të drejtat dhe detyrimet që ajo përmban, janë orientuar në momente kyç të marrëdhënieve mjedisore dhe grupohen në tri drejtme themelore të tyre që jo pa qëllim janë quajtur edhe tri shtyllat e Konventës:

1. E drejta e publikut për të patur e për të kërkuar informacion mjedisor;
2. E drejta e publikut për të marrë pjesë në vendimmarrjet publike për çështje të mjedisit;
3. E drejta e publikut për t'u ankuar në gjykatë për çështje të mjedisit.

Për të formuar një tablo sa më të qartë për këto tri të drejta, që, në pamje të parë, duken shumë të thjeshta e modeste, është e rëndësishme të theksohen disa momente dhe të përmenden nocionet bazë me të cilat operon Konventa:

Ndryshe nga shumë dokumente normative që janë të mbushura me ndalime e detyrime për individin, për qytetarin, për grupe shoqërore, Konventa e Aarhusit është një dokument i një lloji të veçantë, duke përfaqësuar një tërësi të drejtash që u jepen këtyre subjekteve. E vlerësuar kështu, Konventa e Aarhusit mund të cilësohet si Karta e të Drejtave të Publikut në fushën e mjedisit.

Secila prej të drejtave që Konventa i njeh publikut, nënkupton njëherësh edhe një sasi detyrimesh për shtetin dhe organet e tij. Konventa operon me një mesazh të qartë: Çdo e drejtë që ajo i njeh publikut, kërkon angazhime të gjera shtetërore që të garantojnë zbatimin e saj në praktikë; që publiku ta ushtrojë atë thjesht dhe natyrshëm, ashtu siç i takon atij.

Binomi të drejta e detyrime, në rastin e Konventës, nga një këndvështrim formal dhe nga pikëpamja sasiore, shfaqet si një raport i shbalancuar. Për njohjen dhe për

realizimin praktik të një të drejte që parashikon Konventa, identifikohen një mori detyrimesh të shumë organeve shtetërore dhe që i përkasin një vargu të gjatë të fushave të veprimtarisë së tyre. Në fakt, kjo dukuri ka të bëjë me thelbin e Konventës, e cila kërkon nga shtetet të marrin maksimumin e masave, të bëjnë të gjitha rregullimet e nevojshme, të përgatisin tërësisht terrenin për të përmbushur një detyrë madhore: demokratizimin rrënjësor të marrëdhënieve aktuale mjedisore, si rruga e domosdoshme për të garantuar ardhmërinë e mjedisit e të komunitetit njerëzor. E shtruar kështu, bëhet e qartë që zbatimi i Konventës është një detyrim tërësisht shtetëror, është një mundësi që shteti të dëshmojë praktikisht konstitucionin e vet demokratik dhe sensin e tij reformues.

Zbatimet praktike të të drejtave nga publiku luajnë rol të ndjeshëm ekuilibruar në konfrontimin e interesave të aktorëve kryesorë që operojnë në mjedis. Ato, njëherësh, janë edhe amortizues të trysnive të vazhdueshme që ushtrojnë biznesi dhe investimet mbi mjedisin; ato bëjnë të mundur dhe lehtësojnë zbatimet praktike të kërkesave që shtron parimi i zhvillimit të qëndrueshëm.

Për të lehtësuar zbatimin e saj, Konventa ka qartësuar dhe ka përkufizuar një varg konceptesh të rëndësishme për të, ka detajuar vëllimin dhe përmbajtjen e tyre. Kështu, ajo ka bërë të qartë se çfarë kupton me “publik”, me “informacion mjedisor”, me “organe shtetërore përgjegjëse”, etj., të cilat lehtësojnë veprimtaritë për zbatimin e saj.

II. Arritjet e deritashme në zbatimin e kërkesave të Konventës

Nga viti '98, kur Republika e Shqipërisë e nënshkroi Konventën e, sidomos, pas vitit 2000, kur Kuvendi e ratifikoi atë, veprimtaritë për zbatimin e saj janë intensifikuar dhe janë zgjeruar fushat e zhvillimit të tyre. Është e vërtetë që kanë kaluar 5 vjet nga nënshkrimi i saj dhe, në pamje të parë, duket se jemi pak vonë për të hartuar tani një strategji dhe plan veprimi për zbatimin e saj. Por është, gjithashtu, e vërtetë se vitet që kanë kaluar, kanë qenë të mbushur me veprimtari, madje, të planifikuara e të programuara, më së pari, për të përgatitur ratifikimin e saj dhe, më pas, për të kaluar në zbatimin integral të të gjitha kërkesave që shtron Konventa.

Me veprimtaritë që ndërmori dhe me detyrat që vuri në rrugën e zgjidhjes, kjo periudhë u përdor për të përmbushur disa synime:

- Të konceptohej e të realizohej një proces zbatues sa më i gjerë, në përputhje me veçoritë e Shqipërisë. Që në fillim u bë e qartë se, për kushtet e shoqërisë shqiptare, zbatimi i Konventës nuk do të ishte një sipërmarrje e thjeshtë dhe procesi zbatues, ndryshe nga shumë vende të tjera, do të përballlej me vështirësi e pengesa suplementare, do të ishte më i vështirë dhe do të merrte shtrirje e dimensione shumë të gjera. Nëse për shumë vende të tjera angazhimet e domosdoshme teknike e profesionale do të përbënin thelbin e përpjekjeve për të siguruar zbatimin e kërkesave të Konventës, në rastin e vendit tonë ato do të zinin vetëm një pjesë të tyre dhe do të bashkëshoqëroheshin domosdoshmërisht me masa, veprime e aksione shumë më të gjera e të thella. Konkretisht, nëse për shumë vende, në aspektin ligjor, detyra shtrohej për disa plotësime e amendime që të integroheshin në ligjet kombëtare ekzistuese kërkesat e Konventës, në Shqipëri, detyra dimensionohej shumë më e gjerë e më e thellë. Më së pari, duhej krijuar legjisllacioni mjedisor kombëtar bashkëkohor dhe në të të integroheshin edhe kërkesat e Konventës.

- Të merrte përparësi përgatitja e kushteve dhe e terreneve të favorshme që do të lehtësonin zbatimin e Konventës. Në planin praktik kjo do të thoshte të ngriheshin me shpejtësi dhe të funksiononin në normalitet të gjitha lehtësitë dhe infrastruktura e domosdoshme, që, në kushtet e Shqipërisë, thuhet mungonin dhe pa të cilat as që mund të bëhej fjalë për zbatimin bashkëkohor të Konventës.

- Të sigurohej një drejtpeshim, një raport sa më i drejtë që të ishte e mundur, midis angazhimeve përgatitëse dhe punës zbatuese që përgatitja e terreneve dhe zbatimet konkrete të ecnin bashkërisht e të ishin të njëkohshëm. Duke e vlerësuar këtë mendësi, nisën që herët veprimtaritë konkrete zbatuese, sidomos për informimin e publikut dhe për tërheqjen e tij në vendimmarrjet mjedisore. Kështu, ka 4-5 vjet që OJF-të ftohen dhe marrin pjesë në hartimin e dokumenteve të rëndësishme shtetërore për mjedisin; nuk ka komisione, komitete, grupe ndërsektoriale, ku të mos jenë anëtarë të tyre edhe përfaqësues të OJF-ve.

- Të përcaktoheshin drejtimet dhe fushat ku do të përqëndroheshin angazhimet për të siguruar zbatimin e kërkesave të Konventës dhe, si të tilla, u identifikuan:

- njohja me Konventën dhe ndërgjegjësimi për zbatimin e saj;
- plotësimi i kuadrit ligjor mjedisor dhe integrimi në të i kërkesave të Konventës;
- përsosja e rritjes institucionale mjedisore dhe rritja e kapaciteteve të tij për të përballuar realizimin në praktikë të të drejtave që i jep Konventa publikut.

Nga gjithë sa është bërë deri tani, në mënyrë të përmbledhur dhe sipas këtyre drejtimeve, vlen të përmenden:

a. Vijueshmëria në rritje e veprimtarive njohëse e ndërgjegjësuere për Konventën

Njohjes me Konventën, si një dokument i ri ndërkombëtar në fushën e mjedisit, i është kushtuar kujdes i përhershëm. Qendra Rajonale e Mjedisit (REC), Ministria e Mjedisit, Milieukontakt Oost Europa dhe mjaft OJF mjedisore janë organizueset dhe realizueset e shumë programeve e veprimtarive për njohjen me kërkesat e Konventës. Me mbështetjen dhe përkrahjen e REC-Budapest, ato u bënë kontribueset kryesore për njohjen e Konventës. Veprimtari të ndryshme si trainime, seminare, ëorkshop-e, botime e publikime, projekte e veprimtari konkrete në terren, në nivel kombëtar dhe lokal, janë përdorur e shfrytëzuar gjerësisht prej tyre. Sidomos këto 3-4 vitet e fundit, cilësia dhe efektiviteti i këtyre veprimtarive u bënë më të dukshme. Puna për njohjen dhe për ndërgjegjësimin e publikut me Konventën u konsolidua si një drejtim që siguroi dhe përthithi me efektshmëri të lartë asistencën e huaj që u dha për këto, qëllime.

b. Rregullimet gati të plota në legjislacionin e ri mjedisor për të integruar kërkesat e Konventës

Integrimi i kërkesave të Konventës në legjislacionin kombëtar u identifikua që herët si drejtim i rëndësishëm i punës për të siguruar zbatimin e kërkesave të saj. I njëkohshëm me reformën legjislative të Qeverisë, me nismën për përafrimin e legjislacionit me standardet e BE-së, si dhe me kërkesën urgjente për të plotësuar legjislacionin mjedisor, i cili deri në vitet 2000 ishte me mangësi të ndjeshme, ky

drejtim u zhvillua me përgjegjësi nga Ministria e Mjedisit dhe dha rezultate pozitive. U hartuan mjaft ligje të reja mjedisore që nuk ekzistonin fare deri në këtë kohë, si dhe akte nënligjore që lehtësojnë zbatimin e ligjeve. Gjatë viteve 2002-2003 u miratua nga Kuvendi një paketë e “plotë ligjore për mjedisin që përmbledh:

Ligje

1. Ligji ” Nr 8934,datë 05.09.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”
2. Ligji Nr 8906 datë 06.06.2002 “Për zonat e mbrojtura”
3. Ligji Nr.8897,datë 16.05.2002 “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”
4. Ligji Nr 8905,datë 06.06.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja dhe dëmtimet”
5. Ligji Nr.9115, datë 24.07.2003 “ Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotur
6. Ligji Nr.8990,datë 23.01.2003 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”
7. Ligji Nr.9010.datë 13.02.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”
8. Ligji Nr. 9103 datë 10.07.2003 “Për mbrojtjen e liqeneve ndërkufitare”
9. Ligji Nr. 9108 datë17.07.2003 “Për substancat dhe preparatet kimike”

Vendime të Këshillit të Ministrave

1. Vendimi Nr 103,datë 31.03.2002 “Për monitorimin e mjedisit në Republikën e Shqipërisë”
2. Vendimi Nr.34,dt 28.01.2002 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Mjedisin”
3. Vendimi Nr 248,dt 24.04.2003 “Për normat e shkarkimeve në ajër”
4. Vendimi Nr 676, dt 20.12.2002 “Për shpalljen e monumenteve të natyrës shqiptare”
5. Vendimi Nr. 531, dt. 31.10.2002 “Për shpalljen e Butrintit zonë Ramsar”
6. Vendimi Nr. 364 dt.18.07.2002 “Për miratimin e planit të menaxhimit të Zonës Bregdetare”
7. Vendimi Nr. 659, dt 18.12.2002 “Për krijimin e Institutit të Mjedisit”
8. Vendimi Nr 267, dt 24.04.2003 “Për procedurat e propozimit dhe shpalljen e zonave të mbrojtura dhe buferike”
9. Vendimi Nr. 268,dt 24.04.2003 “Për certifikimin e specialistëve për të hartuar VNM-të dhe auditim mjedisor”
10. Vendimi Nr.266, dt.24.04.2003 “Për administratat e zonave të mbrojtura”
11. Vendimi Nr 249,dt 24.04.2003 “Për miratimin e dokumentacionit për leje mjedisore dhe të elementëve të lejes mjedisore” etj.

Në të gjithë këtë legjislacion dhe në çdo ligj të veçantë, kërkesat e Konventës janë përfshirë tërësisht dhe në mënyrë të detajuar, në pajtim me natyrën dhe me objektin e secilit ligj dhe vendim.

Veç kësaj, kërkesa të Konventës u pasqyruan edhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, duke u kthyer në norma kushtetuese; u miratua ligji “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, ligji “Për avokatin e popullit”. Po kështu, informimi i publikut dhe pjesëmarrja e tij në vendimmarrjet publike janë trajtuar gjerësisht në Kodin e Procedurave Administrative, në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjeve vendore”, në ligjin “Për emergjencat civile” etj.

c. Përmirësime në aspektin institucional të organeve mjedisore që i shërbejnë direkt zbatimit të kërkesave të Konventës

Edhe në aspektin institucional, gjatë këtyre viteve, janë shënuar arritje të rëndësishme që ndikojnë pozitivisht në zbatimin e Konventës. Ato mund të përmbledhen në dy momente:

- Momenti i parë ka të bëjë me konfirmimin ligjor të ekzistencës dhe të funksionimit të rrjetit publik mjedisor shqiptar. Në nenin 64 të ligjit nr.8934, datë 05.09.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, theksohet:
 1. Tërësia e organeve të specializuara, të ngarkuara me ligj për mbrojtjen e mjedisit në Republikën e Shqipërisë, përfaqëson rrjetin institucional mjedisor shqiptar.
 2. Rrjeti institucional mjedisor përbëhet nga Ministria e Mjedisit, nga agjencitë rajonale të mjedisit, nga Inspektorati i Mjedisit, nga organizmat mjedisorë në përbërje të organeve qendrore e vendore dhe nga organizmat ndërmisorë, të miratuar nga Këshilli i Ministrave për të ndjekur probleme të rëndësishme të fushës së mjedisit.
- Momenti i dytë ka të bëjë me krijimin e Ministrisë së Mjedisit. Me krijimin e kësaj ministrie, aspekti institucional i organeve mjedisore, përgjegjëse për zbatimin e Konventës, mori pamje dhe dimensione të reja. Në përbërje të strukturave të saj janë ngritur dhe funksionojnë drejtori, sektore e organizma vartës që i shërbejnë drejtpërdrejt realizimit të detyrimeve që ka ministria në kuadër të Konventës. Tashmë, funksionon Drejtoria e Komunikimit që ka në përbërje edhe Qendrën Kombëtare të Informacionit Mjedisor, e cila organizon dhe drejton gjithë problematikën e informacionit mjedisor; Drejtoria e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (DVNM) që zbaton procedurat e rregullat për VNM-të dhe për akordimin e lejes mjedisore të veprimtarive që ndikojnë në mjedis dhe, në këtë kuadër, zbaton kërkesat ligjore për informimin dhe tërheqjen e publikut në këto veprimtari shumë të rëndësishme; Drejtoria e Parandalimit të Ndotjeve të Mjedisit (DPNM), së bashku me Drejtorinë e Mbrojtjes së Natyrës dhe Biodiversitetit (DMNB), secila në linjën e vet, po luajnë rol të ndjeshëm në përgatitjen e kushteve për zbatimin tërësor të kërkesave të Konventës, duke përgatitur regjistrat e ndotësive, trajtimin e pikave të nxehta e të ndjeshme mjedisore, me rregullat e administrimit të zonave të mbrojtura e të monumenteve natyrore etj. Në varësi të ministrisë u krijua Instituti i Mjedisit që pritet të japi ndihmesë të ndjeshme në realizimin e programeve të monitorimit të gjendjes së mjedisit dhe të gjenerojë informacione e të dhëna shkencërisht të sakta e të besueshme, të cilat mund të ofrohen lehtësisht për publikun. Riorganizimi i Inspektoratit të Mjedisit, si organ i specializuar kontrolli dhe zbatues i ligjit mjedisor, jep mundësi për informacione të kualifikuara për shkallën e zbatimit të ligjit dhe për ndotjet e dëmtimet e mjedisit, për të cilat publiku është shumë i interesuar.

Përmirësime të ndjeshme institucionale që do të lehtësojnë zbatimin e kërkesave të Konventës, janë bërë edhe në plane më të gjera, ndër të cilat vlen të përmenden:

Janë ngritur dhe funksionojnë organizma të ndryshëm ndërsektorialë si komitete, komisione, grupe, këshilla, të cilët kanë për objekt të veprimtarisë së tyre problematika të rëndësishme mjedisore si: për biodiversitetin, për të luftuar shkretëtirizimin e tokës, për të zbatuar planin kombëtar të veprimit për mjedisin, etj. Veç Këshillit Kombëtar të Ujit dhe sekretarisë teknike të tij, në të gjithë vendin, duke e ndarë territorin në gjashtë basene, u ngritën dhe funksionojnë Këshillat e Baseneve që administrojnë përdorimin dhe mbrojtjen e ujërave. Aktualisht ata përfaqësojnë një rrjet të plotë institucional për administrimin e ujërave dhe, si të tillë, identifikohen si struktura gjerësisht të detyruara në zbatimin e kërkesave të Konventës.

U krijua dhe funksionon Avokati i Popullit si institucion i specializuar në mbrojtje të drejtave të publikut e të qytetareve dhe që deri tani është angazhuar disa herë në krah të ankimeve kolektive për probleme të ndryshme mjedisore.

U ngritën dhe funksionojnë, në nivel qendror dhe lokal, strukturat shtetërore për përballimin e emergjencave civile që kanë rol të pazëvendësueshëm në manaxhimin e situatave emergjente për të mbrojtur shëndetin e njerëzve dhe mjedisin.

U riorganizuan Këshillat e Rregullimit të Territorit në të gjitha nivelet dhe pritet që ky hap të mundësojë angazhime më reale të tyre në zbatimin e kërkesave të Konventës në fushën e administrimit të territoreve e të urbanistikës, për të cilat interesat e publikut janë mjaft të spikatura.

Janë riorganizuar disa inspektorate e polici dhe janë ngritur të rinj, që, me ligj, janë ngarkuar të mbrojnë përbërës të rëndësishëm të mjedisit, si policia ndërtimore, inspektorati për hidrokarburet etj. Këto organizma, të profilizuar në zbatimin e ligjit, janë burime gati unike për të dhëna e informacione që dëshmojnë shkallën e zbatimit të ligjit, ndotjet e dëmet që i shkaktohen mjedisit nga veprimtari të ndryshme, të ligjshme e të paligjshme.

Me legjislacionin e ri mjedisor, struktura e organeve doganore që funksionon në Republikën e Shqipërisë, ka marrë role, përgjegjësi e detyra të reja në mbrojtjen e mjedisit që kanë të bëjnë me kontrollin e importeve dhe të eksporteve të lëndëve, materialeve, pajisjeve, gjallesave të faunës dhe florës, me, qëllim që ato të kryhen duke u zbatuar rigorozisht kërkesat e ligjit.

Edhe pse deri tani nuk është bërë pak në zbatimin e kërkesave të Konventës, ajo që mbetet për t'u bërë përfaqëson ende një detyrë të vështirë e shumë dimensionale. Brenda saj duhen vlerësuar më realisht e duhet të marrin zgjidhje të pranueshme një varg problemesh të brendisë e të aspekteve të organizimit të punës zbatuese. Kështu:

Mbi bazën e asaj që është arritur dhe me përvojën e fituar duhet të atakohen në front problemet me të cilat përballen realisht të angazhuarit me zbatimin e Konventës dhe të arrihen rezultate të qëndrueshme në plotësimin e të gjitha kërkesave të saj.

Nga hulumtimet, bisedat dhe konsultat me specialistë e ekspertë të fushave juridike, sociologjike e mjedisore, si dhe me përfaqësues të OJF-ve, rezulton se drejtimet në të cilat është punuar deri tani, siç u përmendën shkurtas më lart, duhet të vazhdojnë të mbeten fusha angazhimesh edhe për të ardhmen. Veçse kontributet në to kërkohen të jenë në nivele më të kualifikuara e me synime më ambicioze. Në këtë material ato do të zenë vend si të tilla, duke sugjeruar nisma dhe zgjidhje konkrete për secilin problem dhe të lidhura ngushtë me kontekstin e çdonjërit prej kërkesave të Konventës.

Është në detyrat e këtij materiali të sugjerojë hartimin e një pasqyre koncize dhe realiste se si po zbatohen në praktikë kërkesat e Konventës dhe në përputhje me këtë gjendje reale, të përzgjidhen masat, aksionet e veprimet që duhet të ndërmerren menjëherë që do të realizohen në një periudhë afatmesme e që do të duan angazhime afatgjata për të rritur rezultatet në zbatimin e kërkesave të saj.

Në punën për zbatimin e Konventës, të mbahen parasysh kushtet konkrete të vendit tonë, vështirësitë që hasen e shanset që ofrohen. Siç dihet, Konventa nisi të zbatohet

në kushtet e vështira të tranzicionit shqiptar dhe për të gjithë është e qartë se kjo rrethanë madhore shfaqet e vepron si një tërësi mangësish e pengesash që ndikojnë negativisht në zbatimin tërësor të saj. Shkalla e demokratizimit të marrëdhënieve shtetërore e shoqërore, niveli ende i ulët i emancipimit qytetar të shoqërisë, stadi foshnjor i shoqërisë civile, reminishencat e të shkuarës diktatoriale etj. përbëjnë aspektin botëkuptimor, psikologjik e pse jo edhe administrativ e praktik të pafavorshëm për zbatime optimale të këtij dokumenti demokratizues.

Ndonëse vjen duke u zbehur, kjo situatë do të vazhdojë të jetë e pranishme edhe në të ardhmen e afërt dhe, si e tillë, do të meritojë në vijimësi kujdes dhe vëmendje për të gjetur zgjidhje që zbusin dhe amortizojnë ndikimet e saj negative në procesin zbatues të Konventës. Si rruga më e mirë për të zbutur këto efekte, sugjerohet që përpjekjet për zbatimin e Konventës të integrohen në nismat e reformat demokratizuese mbarëkombëtare që po zhvillohen aktualisht; të realizohen si pjesë e veprimtarive dhe e synimeve të tyre; të jenë në përputhje dhe në harmoni me to. Reforma legjislativë, reforma institucionale, nisma për përafrimin e legjislacionit, procesi i decentralizimit në favor të qeverisjeve vendore etj. janë angazhime prestigjioze, me të cilat Konventa është e lidhur dhe e ndërvarur në brendinë dhe në synimet e saj.

Krahas kësaj, në terrene dhe me synime më konkrete, sugjerohet të mbahen parasysh edhe disa mangësi praktike, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në zbatimin e kërkesave të Konventës. Në zbatim të nismës së lirë dhe të iniciativës private, gjatë kësaj periudhe në Shqipëri janë krijuar dhe vepronë organizma të shumëllojshëm si studio, agjenci, byro etj., të cilat ofrojnë shërbime të profilizuara për këdo që është i interesuar dhe i kërkon. Por, të tilla organizma nuk janë krijuar ende për probleme të mjedisit që të japin asistencë për legjislacionin mjedisor që marrin përsipër përballimin e procedurave administrative dhe gjyqësore për çështje konkrete ankimore në fushën e mjedisit; që këshillojnë OJF-të mjedisore, biznesin, investitorët dhe publikun për qëndrimet që duhet të mbajnë në raste konkrete etj. Prania dhe veprimtaria e tyre do të përbënte një “forcë të tretë” aktive, mbështetëse dhe që do të ndihmonte ndjeshëm në zbatimin e kërkesave të Konventës.

Ka vërtet një zhvillim të investimeve dhe të bizneseve, por nuk janë shfaqur ende ato organizma të krijuara prej tyre që të ndërmarrin nisma e veprimtari të rëndësishme praktike që mbrojnë mjedisin nga ndikimet negative të bizneseve që përfaqësojnë. Për shembull, aktualisht, janë me qindra subjektet që prodhojnë e përdorin ambalazhet plastike për lëngjet, të cilat hidhen pasi përdoren dhe ndotin ndjeshëm mjedisin. Këtë vit filloi të zbatohet për herë të parë edhe taksa mbi këto ambalazhe, me synim që të reduktohet përdorimi i tyre ose që të merren masa plus për të zbutur ndikimet e tyre negative në mjedis. Megjithatë, mungon ende një organizëm i këtyre subjekteve që të merret me mbledhjen dhe përpunimin e këtyre ambalazheve pasi janë përdorur, siç ka në shumë vende të botës, madje, edhe të Ballkanit.

KREU II

SYNIMET DHE OBJEKTIVAT

I. Çfarë synojnë strategjia dhe plani i veprimit

Synimet e Konventës janë të gjera dhe shumëplanëshe. Duke ruajtur këtë tipar të saj, Strategjia dhe plani i veprimit, me konstatimet e analizat që bën, si dhe me kërkesat që parashtron, synon t'u hapë rrugë të gjera zbatimi, me qëllim që të konsolidohen edhe në Shqipëri mendësi, psikologji, metoda pune e veprimtari praktike bashkëkohore për administrimin dhe mbrojtjen e mjedisit, të cilat duhet të zbatohen, më së pari, në zbatimin e kërkesave që shtron Konventa dhe konkretisht:

- Në përcaktimin e rregullave, procedurave e afateve të sigurimit, përpunimit dhe publikimit të vazhdueshëm të informacionit mjedisor, si dhe të plotësimit të kërkesave të publikut për të (aktiv dhe pasiv);
- Në tërheqjen në rritje të publikut dhe të pjesëmarrjes së tij në vendimmarrjet publike për çështje të mjedisit;
- Në konsolidimin e rregullave dhe të praktikave të thjeshta e operative që publiku të ushtrojë natyrshëm të drejtën ankimore në rrugë administrative dhe gjyqësore për çështje të mjedisit.

Zbatimi i kërkesave të Konventës në këto drejtime nuk përbën qëllim në vetvete, nuk është plotësim formal i një qëndrimi ndaj një akti ndërkombëtar të ratifikuar. Prej zbatimit cilësor të tyre pritet:

- Të demokratizohen thellësisht marrëdhëniet mjedisore;
- Të ngushtohen hapësirat për abuzime në fushën e mjedisit;
- Të ekuilibrohen dhe të amortizohen trysnitë e politikës dhe të biznesit ndaj kërkesave të ligjësive mjedisore;
- Të sigurohet nivel i lartë i transparencës në vendimmarrjet e organeve publike për çështje të mjedisit;
- Të realizohen lehtësisht oponenta, lobingu deri dhe referendimet për çështje të mjedisit;
- Të përmiresohet ndjeshëm mbrojtja e mjedisit;
- Të sigurohet përafrimi deri edhe unifikimi i rregullave, procedurave e praktikave të zbatimit të Konventës me kërkesat dhe standardet komunitare për këtë qëllim, duke synuar që e gjithë veprimtaria zbatuese të përfaqësojë një hap të rëndësishëm konkret integruar.

Të realizuara me nivel dhe në kohën e duhur, këto objektiva do të çojnë:

- Në një vlerësim të ri shtetëror dhe shoqëror të mjedisit e të mbrojtjes së tij;
- Në rritjen e dijeve, të kulturës, të edukatës qytetare dhe të rregullave të sjelljes ndaj mjedisit e përbërësve të tij;
- Në krijimin e një shoqërie me qëndrim të emancipuar ndaj mjedisit, të interesuar dhe aktivë për problemet e mjedisit;
- Në transformimin përfundimtar të veprimtarisë shtetërore për administrimin dhe mbrojtjen e mjedisit në një veprimtari tërësisht të demokratizuar me pjesëmarrje të gjerë dhe aktive të shoqërisë civile.

Plotësimi i këtyre objektivave do të lehtësojë realizimin praktik të kërkesave kushtetuese “për një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm” dhe do të kontribuojë ndjeshëm në finalizimin me sukses të përpjekjeve mbarëkombëtare për integrimin e Shqipërisë në Evropë.

II. Drejtimit ku duhet të përqëndrohet puna për zbatimin e kërkesave të Konventës

Ashtu si edhe deri tani, zbatimi i kërkesave të Konventës do të vazhdojë të meritojë angazhime të njëkohshme dhe në disa drejtime.

Kështu, raporti midis përgatitjes së kushteve për zbatim dhe zbatimi konkret i të drejtave të publikut do të vazhdojë të përfaqësojë gjithë hapësirat dhe vëllimet ku do të përqëndrohen angazhimet dhe veprimtaritë zbatuese. Veçse, nëse deri tani kishte përparësi përgatitja e kushteve për zbatimin e kërkesave të saj dhe zbatimet praktike ishin më të pakta, tani dhe në vitet në vazhdim do të marrë përparësi të dukshme zbatimi praktik i të drejtave të publikut. Kjo do të përbëjë thelbin e angazhimeve për zbatimin e kërkesave të Konventës, ndërsa përgatitja e kushteve dhe e terreneve sa më të përshtatshme për t’u realizuar lehtësisht të drejtat e publikut do të vazhdojë të realizohet si veprimtari mbështetëse që do të bëjë rregullimet e nevojshme në praktikat konkrete.

Gjithashtu, do të vlerësohet më mirë fakti që me ratifikimin e Konventës, publikut, OJF-ve e deri qytetarit të thjeshtë i janë garantuar me ligj të drejta të rëndësishme në fushën e mjedisit. Dhe aq sa është e nevojshme të thellohet puna për hartimin e kuadrit rregullator procedural dhe për forcimin e kapaciteteve të organeve publike që mundësojnë ushtrimin e këtyre të drejtave, po aq e rëndësishme është të ndërgjegjësohen nëpunësit publikë për detyrat që duhet të kryejnë në zbatim të këtyre të drejtave.

Po kështu, jo vetëm do të vazhdojë puna për njohjen dhe zbërthimin e kërkesave të Konventës, por do të insistohet që edhe publiku e OJF-të të ndërgjegjësohen për këto të drejta që u janë dhënë, të njihen me përmbajtjen e tyre, të bëhen aktivë në ushtrimin e tyre, të fitojnë shprehitë dhe përvojat vetjake në ushtrimin praktik të secilës prej të drejtave që u jep Konventa.

Ky kompleksitet detyrash për zbatimin e kërkesave të Konventës kërkon domosdoshmërisht:

- përcaktimin e drejtave të punës për të ardhmen;
- ndërthurjen e këtyre drejtave me realizimet konkrete të secilës kërkesë të Konventës;
- identifikimin e angazhimeve konkrete për të gjithë ata që janë të detyruar në zbatimin e saj.

Nga ç’është bërë deri tani dhe nga përvoja e fituar, sugjerohet që angazhimet zbatuese duhet të vazhdojnë të përqëndrohen në:

1. Thellimi i procesit ndërgjegjësues për të siguruar njohje dhe zbatim të kualifikuar të kërkesave të Konventës

Edhe pse në këtë drejtim nuk është bërë pak, nuk mund të thuhet se është arritur ajo që synohet, sidomos përsa u përket dijeve, kulturës dhe edukatës mjedisore të publikut dhe të shtetarëve, të biznesit dhe investitorëve të vendit tonë. Për kushtet e Shqipërisë, puna ndërgjegjësuese e njohëse duhet të vazhdojë dhe të thellohet më tej, si fushë ku kërkohen përmirësime rrënjësore dhe që ka mundësi të gjera iniciative, koordinimi dhe bashkërendimi midis OJF-ve, mediave të ndryshme dhe organeve shtetërore të të gjitha niveleve.

Aktualisht dhe në të ardhmen e afërt, çështja shtrohet për zgjerimin e këtyre veprimtarive, për rritjen e efektivitetit të tyre, si dhe për forcimin e aspekteve organizative. Nga kjo pikëpamje, do të ishte e drejtë dhe e dobishme që vëmendja të përqëndrohej në disa momente:

- Të zgjerohen veprimtaritë njohëse në nivel vendor; ato të zhvillohen sa më pranë komuniteteve vendore;
- Të punohet me grupe më konkrete e më homogjene, si me gratë, me të rejtat, me biznesin, me mediat etj. me të cilët deri tani është bërë pak;
- Të përzgjidhen tematika në përputhje me interesat e grupeve; ato t'i përgjigjen drejtpërdrejt interesave të tyre dhe t'i përgatitin ata për t'u angazhuar në realizimet faktike të të drejtave që u janë dhënë me ligj;
- Të kryhen veprimtari aktive, ku pjesëmarrësit të mos jenë thjesht dëgjues, por pjesëmarrës aktivë, me debate, me zgjidhje detyrash e situatash, me qëllim që të fitojnë njohuri praktike dhe kurajë për të zbatuar ato që mësojnë.

Me ndikim të ndjeshëm pozitiv duhen vlerësuar sidomos veprimtaritë njohëse e ndërgjegjësuese për zbatimin e kërkesave të legjislacionit të ri mjedisor, të cilat klasifikohen si pjesa më thelbësore e përgatitjeve për zbatimin e kërkesave të Konventës dhe duhet të zenë në to vendin kryesor. Lidhjet dhe vartësitë midis tyre janë aq të ngushta e të shumta sa që me plot të drejtë mund të theksohet se nuk mund të pretendohet dhe nuk mund të ketë realisht zbatim të suksesshëm të Konventës jashtë përpjekjeve për zbatimin tërësor të këtij legjislacioni. Siç është e njohur, ky legjislacion ka bërë të vetat mjaft konceptime e qëndrime bashkëkohore për mbrojtjen e mjedisit dhe detyron zbatimin e tyre në praktikën shqiptare, ndërkohë që njohuritë dhe përvojat për t'i zbatuar ato janë modeste ose mungojnë dhe nuk u përgjigjen dot detyrimeve për t'i zbatuar në praktikë këto kërkesa të ligjeve. Jo vetëm në ligjin bazë për mbrojtjen e mjedisit, por edhe në secilin nga ligjet e veçanta, si për mbrojtjen e ajrit, për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta, për zonat e mbrojtura, për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura etj., ka mjaft kërkesa, pothuajse krejt të reja, zbatimi i të cilave kërkon jo thjesht propagandim, por njohuri të thelluara nga të gjithë aktorët e detyruar me zbatimin e tyre. Hartimi dhe zbatimi i programeve të vetëmonitorimit, administrimi i regjistrave të ndotësve, hartimi dhe zbatimi i programeve për të kapur në një kohë sa më të shpejtë normat e BE-së për shkarkimet në mjedis etj. do të meritonin deri edhe projekte pilot, ku do të trainoheshin operatorët dhe punonjësit shtetërorë, në qendër dhe ata vendorë, të detyruar me zbatimin ose me kontrollin e zbatimit të tyre.

Me programimin, organizimin dhe me realizimin e këtyre veprimtarive ndërgjegjësuere sugjerohet të vazhdojë të angazhohet REC-u, i cili ka mundësi dhe shumë përvojë në këtë fushë. Në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, ai mund të ndërtojë programe kombëtare e lokale, të përgjithshme dhe për degë e drejtime të veçanta sektoriale për këto veprimtari, mund të angazhojë OJF të ndryshme, mund të miratojë dhe të mbështesë projekte ndërgjegjësuere etj.

Duke e marrë të mirëqënë faktin që veprimtaritë njohëse e ndërgjegjësuere janë të domosdoshme dhe që është e nevojshme të zhvillohen në vazhdimësi, të programuara dhe me forma interesante, është e dobishme të theksohen disa nga drejtimet ku ato do të përqëndrohen:

- Në fushën e botimeve e të publikimeve

Njohjes me Konventën, si dhe ndërgjegjësimin të publikut për vlerat e dobite e saj do t'i shërbenin, në radhë të parë, botimet e tekstit të vetë Konventës, si dhe të materialeve të thjeshta në zbërthim dhe propagandim të ideve e të kërkesave të saj. Synimi është që puna e bërë deri tani, të zgjerohet duke përfshirë edhe botime të tjera, deri edhe artikuj njohës e problemorë, pa përjashtuar edhe fletë-palosje, postera, ilustrime etj. E theksojmë këtë kërkesë, sepse nga testimet e bëra në qendër dhe në disa rrethe të vendit me qytetarë, fshatarë, studentë, biznesmenë, del se grupe dhe shtresa të tëra shoqërore nuk kanë fare dijeni për Konventën ose dinë shumë pak për të.

Një grup më vete publikimesh e botimesh, që do të ndihmonin drejtpërdrejt publikun të realizonte praktikisht të drejtat që i jep Konventa, do ta përbënin përmbledhjet e legjislacionit vendas, në të cilin janë zbërthyer kërkesat e Konventës, si dhe dokumentet e organeve të ndryshme shtetërore, si udhëzime, procedura, rregulla njoftime etj., që japin të dhëna, sqarojnë dhe orientojnë publikun për të zbatuar me lehtësi secilën nga të drejtat që i ka dhënë Konventa.

Në këtë linjë, në të ardhmen afatmesme, është shumë i dobishëm përkthimi, botimi dhe shpërndarja e një përmbledhjeje ligjore, me të gjitha direktivat evropiane, të cilat kanë si objekt dhe si qëllim të tyre zbatimin sa më korrekt të kërkesave të Konventës. Ky botim do të ndihmonte të gjithë të detyruarit me zbatimin e saj për të krahasuar dhe për t'i vënë në një linjë punën zbatuese në Shqipëri me orientimet e synimet e BE-së, për të hedhur edhe një hap konkret integrues të natyrës procedurale.

Një grup më vete publikimesh, që i shërbejnë, jo vetëm njohjes me kërkesat e Konventës, por janë, njëherësh, edhe realizime praktike të kërkesave të saj, e përbëjnë dokumentet të hartuara e të miratuara nga organe të ndryshme shtetërore, të cilët detyrohen me ligj të bëjnë publikimin e tyre. Në legjislacionin e ri mjedisor dhe në mjaft ligje të tjera janë të shumta dispozitat që urdhërojnë organet shtetërore t'i bëjnë publike dokumentet që krijojnë. Vetëm brenda sistemit të organeve të mbrojtjes së mjedisit, strategjitë, planet e veprimit, planet e manaxhimit, programet e monitorimit, raportet e gjendjes së mjedisit, përmbajtja e regjistrave, vendimet e licensimit e deri te raportet e grupeve të inspektimit, janë të gjithë dokumente, që, sipas ligjit, duhet të publikohen. Po kështu mund të thuhet për strukturat shtetërore që merren me administrimin e ujërave, të tokës e të territoreve; të pyjeve, kullotave e livadheve, të pasurive minerare etj. Dhe kur gjithë ky material dokumentar të publikohet dhe të

konsumohet lirisht nga publiku, marrëdhëniet shtet-publik për çështje mjedisore do të ridimensionohen dhe do të marrin brendi dhe pamje krejt të re.

Meqë botimi dhe propagandimi janë veprimtari që mund të kryhen nga shumë subjekte, përfshi edhe OJF-të, si dhe duke mbajtur parasysh faktin që Milieukontakt, aktualisht, është organizmi me përvojë në këtë drejtim, do të ishte e dobishme që ai të vihej në krye dhe të merrte përsipër rakordimin dhe organizimin e të gjitha nismave në fushën e botimit e të publikimit në dobi të Konventës. Pa dyshim që Ministria e Mjedisit duhet të ketë kontributin e saj të dukshëm në këtë fushë, duke filluar që nga shkrimet në Buletinin e vet e deri në realizimin e botimeve të plota kushtuar zbatimit të Konventës.

- Në fushën e hulumtimeve, testimeve e investigimeve

Një drejtim tjetër shumë të rëndësishëm sugjerohet ta përbëjnë veprimtaritë hulumtuese, testuese e investiguese me anketa, pyetësorë etj. për të hetuar e njohur saktësisht interesimin e publikut e të grupeve të ndryshme në përbërje të tij lidhur me kërkesat e Konventës, nivelin e njohjes e të përvetësimit të saj, shkallën e ndërgjegjësimit të tyre për të drejtat që kanë fituar, rezultatet konkrete të nismave e të veprimtarive për t'i zbatuar në praktikë këto të drejta, për të njohur problemet që dalin e për të gjetur zgjidhjet për to.

Si veprimtari e kualifikuar dhe me teknika specifike realizimi, sugjerohet që drejtimi dhe organizimi i saj të realizohen me bashkëpunime e rakordime të ngushta midis Ministrisë së Mjedisit, studiuesve sociologë, psikologë dhe OJF-ve me përvojë, duke angazhuar edhe studentë të shkencave shoqërore, të cilët mund të përgatisin edhe tema kursi, artikuj të thjeshtë e tema diplome për probleme të veçanta të Konventës.

- Në fushën e debatit, të rrahjes së mendimeve e të shkëmbimit të përvojave

Një grup më vete do ta përbënin veprimtaritë debatuese, si tavolina të rrumbullakta, takime, seminare, ëorkshope etj. me grupe të ndryshme të publikut që nga më të thjeshtët e deri te grupe specialistësh, ekspertësh të fushave të natyrës, të drejtësisë, të ekonomisë, të sociologjisë, të mediave, analistë e opinionistë etj. OJF-të me përvojë, institutet kërkimore, katedrat universitare, të mbështetura nga Ministria e Mjedisit dhe në bashkëpunim me mediat vizive, mund të piketonin disa takime të tilla, duke përcaktuar paraprakisht edhe tematikat për secilin takim. Zhvillimi i këtij drejtimi do të ndihmonte për të tërhequr në problematikat mjedisore edhe studiuesit e fushave shoqërore, që, aktualisht, nuk janë shumë të pranishëm me mendimin, analizat e me fjalën e tyre, sidomos në aspektet sociale dhe ekonomike të mjedisit.

- Për ndërgjegjësimin e punonjësve publikë

Vëmendja duhet të përqëndrohet sidomos në organizimin e veprimtarive njohëse e ndërgjegjësuere me punonjës të organeve shtetërore të nivelit qendror e lokal, përfshi edhe specialistët e organeve të drejtësisë, duke i vlerësuar ata si faktorë të rëndësishëm aktivë, nga pozicioni e përfshirja e të cilëve varet shumë zbatimi i suksesshëm i kërkesave të Konventës. Të mbajmë parasysh vetëm një fakt shumë domethënës: Publiku, OJF-të, grupe të ndryshme të komunitetit, në çdo rast që do të kërkojnë të ushtrojnë një të drejtë që u jep Konventa do të përballen me këta punonjës, do të trokasin në zyrat e tyre dhe do ta ushtrojnë ose jo të drejtën, do ta realizojnë atë tërësisht apo pjesërisht në varësi të qëndrimit dhe të angazhimeve konkrete të këtyre punonjësve. Veç kësaj, duhet theksuar se veprimtaritë e

organizuar deri tani me grupe të këtyre zyrtarëve kanë qenë shumë frytdhënëse dhe nga më seriozet. Zgjerimi i tyre në të ardhmen kërkon përgatitje të kualifikuara, tematika të zgjedhura, auditorë të interesuar.

Departamenti i Administratës Publike, në vijimësi po organizon veprimtari njohëse e kualifikuese me nëpunësit civilë dhe, në këtë kuadër, është mëse e nevojshme të përfshiheshin edhe trainime për mjedisin, për legjislacionin e ri mjedisor e, në veçanti, për njohjen me Konventën.

Zgjedhjet lokale të vitit 2003 sollën mjaft njerëz të rinj në organet e qeverisjeve vendore, të cilët do të drejtojnë për tre vjet komunitetet vendore dhe do të administrojnë problematikat mjedisore, që vazhdojnë të jenë të mprehta e të komplikuar për ta. Do të ishte jo vetëm në dobi të zbatimit të Konventës nëse Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit do të organizojnë trainime e kualifikime të tyre për çështjet e mjedisit e të Konventës, mbi bazën e një programi të miratuar prej tyre.

- Veprimtaritë njohëse me të rinjtë, me nxënësit dhe studentët

Përqëndrimi i vëmendjes te grupmoshat e reja dhe angazhimet serioze në funksion të edukimit të tyre bashkëkohor mjedisor, përbën një drejtim shumë të efektshëm për të sotmen e për të ardhmen. Kjo nismë është e nevojshme të ndërmerret edhe për faktin se në vendin tonë është ende e pakët dhe e zbehtë përvoja e punës me këto grupmosha dhe se sistemet shkollore janë akoma larg integritit programor të dijeve e të edukatës ambientaliste në programet mësimore të shkollave të të gjitha niveleve.

Organizata Botërore e Shëndetësisë, Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës propagandojnë të drejtën e gjithë fëmijëve për t'u edukuar në shkolla që promovojnë shëndetin, në të cilat arsimit synon të krijojë aftësitë e duhura për nxitjen e sjelljeve të shëndetshme dhe jo që thjesht transmetojnë disa njohuri, qoftë edhe për shëndetin. Shqipëria është anëtare e Rrjetit të OBSH-së për Shkollat e Promocionit të Shëndetit dhe bashkëpunimi me këtë Rrjet po shtrihet edhe në komunitetin përreth shkollave, duke lidhur prindërit dhe anëtarët e tjerë të komunitetit me veprimtari të organizuar në shkolla për përmirësimin e shëndetit. Edukimi brenda grupeve që funksionojnë në kuadër të këtij rrjeti, është identifikuar, gjithashtu, si një metodë efektive për të transmetuar informacion dhe dije për shëndetin, si në shkollë, ashtu edhe në pjesë të tjera të komunitetit të gjerë.

Zgjerimi i bashkëpunimeve midis Ministrisë së Arsimit dhe Ministrisë së Mjedisit për të vënë në rrugën e zgjidhjes këto probleme, tashmë, është kërkesë e ditës dhe plotësisht i realizueshëm.

Në këtë rrugë, ka ardhur koha që në Fakultetin Juridik të ndërmerren disa hapa, si ngritja e Katedrës të së Drejtës Mjedisore, organizimi i kualifikimeve pasuniversitare për të drejtën mjedisore dhe, në kuadër të një ristrukturimi të mundshëm të fakultetit, për t'u bërë me disa degë, të ndërmerren hapa konkretë për krijimin e degës të së drejtës mjedisore.

Këto zgjidhje do t'i ndihnin jo thjesht zbatimit të suksesshëm të Konventës, por do të përfaqësonin faktorë të rëndësishëm bazë, që do të përballonin me nivel zhvillimet e pritshme në fushën e mjedisit.

- Në fushën e veprimtarive shkencore

Një drejtim tjetër do të ishin veprimtaritë e mirëfillta shkencore, si simpoziume e konferenca lokale, kombëtare e ndërkombëtare për problemet më madhore të Konventës. Është e natyrshme që zhvillimi me sukses i veprimtarive njohëse e ndërgjegjësuese, çon në përfundime të frytshme dhe në nevojën për të kumtuar për të në nivele e auditore të ndryshme. Po kështu, rezultatet dhe vështirësitë që po shfaqen në zbatimin e kërkesave të Konventës, kërkojnë edhe debatim të kualifikuar të ekspertëve e specialistëve, deri edhe në nivel ndërkombëtar, sidomos me fqinjët e vendet e rajonit, me të cilët ndajmë probleme e vështirësi të njëjta.

2. Plotësimi i rregullave e procedurave që lehtësojnë realizimin praktik të kërkesave të Konventës

Me miratimin e paketës ligjore për mjedisin, integrimi i kërkesave të Konventës për nivelin e ligjeve mund të thuhet se është problem i zgjidhur për disa vite. Ndërkohë, ai është po aq i pranishëm për aktet nënligjore rregullatore që duhet të dalin për të lehtësuar zbatimin e ligjeve të sapomiratuara. Edhe pse Ministria e Mjedisit është e angazhuar tërësisht në hartimin e akteve rregullatore, çka e provon edhe fakti që në dy vjetët e fundit janë miratuar 15 vendime të Këshillit të Ministrave për mjedisin, plotësimi tërësor i tyre mbetet një detyrë e vështirë dhe voluminoze dhe që meriton të ndiqet si një drejtim i rëndësishëm i angazhimeve për zbatimin e Konventës.

Të lidhura ngushtë me kërkesat e Konventës dhe në funksion të tyre, këto rregullime do të realizohen duke trajtuar:

2/1- Të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me informimin e publikut

Është e njohur që për mjedisin dhe mbrojtjen e tij janë të interesuar mjaft elementë shtetërorë e shoqërorë, si dhe publiku në tërësi. Secili prej tyre i luan rolet, i mban e i zhvillon përgjegjësitë, nisur nga disa premisa, ku rol vendimtar kanë njohja e saktë e gjendjes së mjedisit dhe krijimi i hapësirave ligjore për të luajtur rol aktiv në mbrojtjen dhe administrimin e tij.

Nisur nga fakti që njohja e publikut me gjendjen e mjedisit është hapi i parë i domosdoshëm për të komunikuar me të e për ta kthyer atë në faktor aktiv të ndërgjegjshëm për mbrojtjen e mjedisit, sugjerohet të vlerësohen si veprime të domosdoshme të organeve të specializuara të shtetit për administrimin dhe mbrojtjen e mjedisit furnizimi i vazhdueshëm i publikut me informacione e të dhëna për gjendjen e mjedisit në tërësi e të përbërësve a pjesëve të tij në veçanti.

Nga ana tjetër, duhet theksuar se për vendin tonë zbatimi i kërkesave që shtrun Konventa për informimin e publikut, u përball me disa vështirësi të lidhura me të shkuarën, si mungesa e përvojave dhe e praktikave informuese, prirja e punës së mbyllur, censurimi i informacionit, deformimi i skajshëm i koncepteve për sekretin e konfidencialitetin etj. Po kështu, kur u nënshkrua Konventa, madje, edhe kur u ratifikua nga Kuvendi, në Shqipëri mungonte gati tërësisht një kuadër ligjor i kompletuar për zbatimin e kësaj të drejte. Kështu që angazhimet ishin në dy drejtime: në plotësimin e kuadrit të nevojshëm ligjor, si dhe në marrjen e masave të shpejta nga organet shtetërore për të zbatuar praktikisht këtë kërkesë të Konventës.

Edhe pse, aktualisht, situata ka ndryshuar shumë në sens pozitiv, sugjerohet që të dy drejtimet të vazhdojnë të jenë akoma fusha angazhimesh serioze. Kështu, nëse me ligj mund të quhet, përgjithësisht, e rregulluar situata ligjore për ushtrimin e të drejtës që ka publiku për t'u informuar për mjedisin, mbetet për t'u rregulluar me akte nënligjore situata konkrete procedurale, rregullatore, që bën të mundur zbatimin e kërkesave që, tashmë janë të sanksionuara me ligj. Konkretisht, kërkohet të hartohen udhëzime e rregullore që përcaktojnë rregullat, afatet, mënyrat konkrete të pranimit të kërkesës për informacion e për dhënien e përgjigjes, të drejtën për t'u ankuar kur nuk u plotësohet kërkesa etj. Gjithashtu, priten përmirësime të shpejta praktike për publikimin e informacionit me qëllim që grumbullimi, përpunimi dhe publikimi i tij të bëhet drejtim i përhershëm i punës së organeve përgjegjëse.

Realizimi i këtyre rregullimeve dhe zbatimi praktik i të drejtës së publikut për t'u informuar duhet të shihen të lidhura ngushtë me kuptimet dhe me përmbajtjen që Konventa saktëson për informacionin mjedisor, për publikun, si dhe për organet shtetërore përgjegjëse.

Kështu, lidhur me informacionin mjedisor, Konventa saktëson:

“Informacioni mjedisor” nënkupton çdo informacion të shkruar, viziv, të dëgjuar, elektronik apo çdo lloj materiali tjetër mbi:

- (a) Gjendjen e elementëve të mjedisit, si për shembull, ajrin dhe atmosferën, ujin, tokën, ligatinat dhe zonat natyrore, diversitetin biologjik dhe përbërësit e tij, përfshirë dhe organizmat e modifikuar gjenetikiisht, si dhe ndërveprimin mes këtyre elementeve;
- (b) Faktorët si substancat, energjia, zhurmat dhe rrezatimet; aktivitetet që përfshijnë masa administrative, marrëveshje mjedisore, politika, legjislacione, plane dhe programe që ndikojnë ose mund të ndikojnë elementët e mjedisit brenda qëllimit të paragrafit të mësipërm (a); kostot-përfitimet dhe analiza të tjera ekonomike e supozime të përdorura në vendimmarrjen mjedisore;
- (c) Gjendja e sigurisë dhe shëndetit të njeriut, kushtet e jetesës njerëzore, zonat kulturore dhe strukturat ndërtuese, duke qenë se ndikohen ose mund të ndikohen nga gjendja e elementëve të mjedisit, ose përmes këtyre elementëve, nga faktorët, aktivitetet apo masat e referuara në paragrafin e mësipërm (b).

Është pozitiv fakti që këto kuptime dhe kërkesa të Konventës janë trajtuar me detaje edhe në legjislacionin aktual mjedisor. Ky është hapi i parë shumë i rëndësishëm që u hodh këto tre vjetët e fundit. Ligji ka përcaktuar se çfarë përfshijnë të dhënat për mjedisin:

- a) të dhënat për gjendjen e përbërësve të mjedisit;
- b) të dhënat për zhvillimin e sektorëve të ekonomisë që ndikojnë në mjedis dhe faktorët e drejtpërdrejtë që ushtrojnë trysni në mjedis;
- c) të dhënat për ndikimin në mjedis;
- ç) të dhënat për veprimtaritë e ndërmarra për mbrojtjen e mjedisit;
- d) të dhënat për gjendjen dhe për shfrytëzimin e burimeve natyrore, biologjike, minerare dhe të energjisë;
- dh) të dhënat që përftohen nga zbatimi i programit kombëtar të monitorimit;
- e) të dhënat për shkarkimet në mjedis, për cilësinë e mjedisit dhe për dukuritë natyrore.

Madje, në objektin e informimit janë përfshirë me ligj edhe informimi për hartim strategjish e plane veprimi, për politika e programe mjedisore, për hartim ligjesh, për projekte e nisma konkrete që synohet të zbatohen në mjedis, për rezultatet e kontrolleve mjedisore etj. Por që këto kërkesa të ligjit të zbatohen lehtësisht, duhet të hidhet hapi i dytë: të hartohen e të miratohen sa më shpejt rregulloret dhe udhëzimet përkatëse me rregulla detyruese të thjeshta e procedura operative, që mundësojnë informime të menjëhershme dhe pa komplikime.

Drejtim të veçantë përbëjnë informacionet në raste aksidentesh industriale, procedurat që duhet të ndiqen në rastin e aksidenteve mjedisore apo të emergjencave; përgjegjësitë e autoriteteve për dhënien e informacionit përkatës në rastin e aksidenteve etj. Për këto raste, ligji urdhëron se duhet të japë informacion edhe subjekti përgjegjës drejtpërdrejt.

Vend të ndjeshëm në brendinë e informacionit mjedisor duhet të zenë të dhënat për biodiversitetin, edhe pse ky është i njohur, kjo mbështetur në legjisllacionin e veçantë për të, i cili, tashmë është veprues. Duke u bazuar në ligjin “Për zonat e mbrojtura” duhet të zhvillohen programet për mbledhjen dhe shpërndarjen e informacionit mjedisor dhe në parqet kombëtare apo në tërësi për zonat e mbrojtura. Në ligj theksohet shprehimisht se Ministria e Mjedisit:

- a) harton dhe publikon planin e zonave që do të shpallen të mbrojtura, pasi merr edhe mendimin e organeve të qeverisjes vendore;
- b) jep njoftime publike për zonat e mbrojtura të miratuara, për monumentet natyrore, për drurët e mbrojtur, për llojet e bimëve dhe të kafshëve, veçanërisht të mbrojtura, për gjetjet minerare dhe paleontologjike, duke përcaktuar me hollësi kushtet për mbrojtjen e tyre;
- c) miraton dhe shpall planet për menaxhimin e zonave të mbrojtura, si dhe programet për mbrojtjen e llojeve të bimëve dhe kafshëve, veçanërisht të rrezikuara, për burimet ujore dhe liqenet natyrore e artificiale në këto zona.

Burim i rëndësishëm informacioni për biodiversitetin janë edhe skedarët që kërkohen nga ligji:

4. Zonat e mbrojtura shënohen në skedarin, qendror të Ministrisë së Mjedisit, i cili do të ngrihet duke shfrytëzuar të dhënat e institucioneve përkatëse shtetërore dhe të institucioneve të tjera të specializuara.
5. Ministria e Mjedisit harton dhe miraton rregullat për ndërtimin, funksionimin dhe shfrytëzimin e skedarit qendror.
6. Skedari qendror është publik dhe kushdo mund ta përdorë me leje dhe në prani të punonjësit të autorizuar.

Disa projekte të mëdha GEF me qëllim mbrojtjen e mjedisit, që tashmë ekzistojnë, mund të bëhen pjesë e rrjetit informativ, duke ndihmuar kështu në shkëmbimin e informacionit midis tyre, si dhe duke kontribuar në shtrirjen më të gjerë të pjesëmarrjes së publikut.

Me vlerësimet më bashkëkohore që po i bëhen mjedisit, është e domosdoshme që në brendinë dhe vëllimin e informacionit mjedisor të zerë vendin e duhur edhe informacioni për shëndetin, duke përfshirë në të atë mori dukurish ku dukuritë mjedisore rrezikojnë të çënojnë shëndetin ose e prekin atë. Ky aspekt i rëndësishëm,

lidhjet natyrale midis mjedisit dhe shëndetit janë ende pak të përpunuara te ne dhe do të vazhdojnë të përbëjnë drejtim të veçantë të angazhimeve të ardhshme.

Ky drejtim është, gjithashtu, në të njëjtën linjë me kërkesat e legjislacionit komunitar për çështjet e mjedisit, i cili ka si qëllim të kontribuojë për ruajtjen, mbrojtjen dhe për përmirësimin e cilësisë së mjedisit, si dhe për mbrojtjen e shëndetit njerëzor. I lëvruar edhe te ne me të njëjtat synime, mjete, metoda e zgjidhje, ai përbën një tjetër hap konkret integruar në kuadër të zbatimit të Konventës, për afron cilësinë e zbatimit me standardet komunitare.

E drejta për informim ka në vetvete dy elementë të rëndësishëm:

- detyrimin e organeve shtetërore për të publikuar informacionin mjedisor, pavarësisht nga fakti nëse për të është bërë ndonjë kërkesë;
- detyrimin për t'iu përgjigjur kërkesave të publikut për informim, të quajtura ndryshe, shpërndarja aktive dhe pasive e informacionit.

Secili prej tyre ka veçoritë dhe problemet e veta, kërkon angazhime të veçanta që të funksionojë siç kërkohet nga Konventa.

Lidhur me të dyja këto mënyra të shpërndarjes së informacionit, vlen të theksohen disa dukuri dhe elementë që përbëjnë edhe drejtimet e punës për të ardhmen:

Nëse në shkallë vendi prodhohet shumë informacion mjedisor dhe që përfshin të gjitha fushat e drejtimet e mjedisit, të administrimit e të mbrojtjes së tij, prej tij grumbullohet shumë pak nga organet shtetërore. Ndodh kështu, sepse nuk janë ende të përpunuara dhe funksionale sistemet e përshtatshme të grumbullimit të të dhënave për mjedisin. Është e vërtetë që ana parimore e kësaj çështjeje, po ta quanim kështu, tashmë është e zgjidhur me ligj. Në legjislacionin e ri mjedisor është e prerë dhe kategorike kërkesa që gjithë organet shtetërore dhe subjektet, veprimtaritë e të cilëve shkarkojnë në mjedis, janë të detyruar të publikojnë të dhënat dhe informacionet që kanë për mjedisin. Por duket se kaq është akoma e pamjaftueshme që kjo kërkesë ligjore të zbatohet në të gjitha rastet. Në zbatim të kësaj kërkesë, priten rregullime më konkrete që kanë të bëjnë me procedurat, me kërkesat, me formatimet dhe me metodikat, sipas të cilave realizohet në praktikë ky detyrim ligjor. Veç kësaj, vërehen mungesa të ndjeshme në njohjen dhe ndërgjegjësimin e të detyruarve për t'iu përgjigjur kësaj kërkesë ligjore, po ashtu siç është ende e zbehtë forca detyruese e zbatuesve të ligjit mbi të gjithë ata që nuk angazhohen në zbatimin e kësaj kërkesë të ligjit, duke ushtruar mbi ta trysnitë dhe sanksionet që ligji i ka përcaktuar posaçërisht për raste të tilla.

Nëse janë të njohura organet që grumbullojnë të dhëna dhe informacione për mjedisin, për to është përgjithësisht e papërpunuar praktika se çfarë duhet të bëjnë me informacionet që marrin, me ç'forma, mënyra a mjete duhet ta publikojnë atë, sepse nuk ndejnë asnjë përgjegjësi ligjore apo qytetare për t'iu publikuar ato. Për të dalë nga kjo gjendje dhe duke u nisur nga fakti i njohur që informacioni mjedisor grumbullohet në organe të niveleve të ndryshme të administratës, sugjerohet që si orientim të përdoret tabela e mëposhtme

Tabela 1. Organet kryesore që merren me grumbullimin, përpunimin dhe shpërndarjen e informacionit mjedisor në Shqipëri

Mbrojtja e ujit	Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit Ministria e Mjedisit Agjencitë Rajonale të Mjedisit Ministria e Shëndetësisë Këshilli Kombëtar i Ujërave Sekretariati i Këshillit Kombëtar të Ujërave Këshilli i Baseneve Ujëmbledhës (7 në të gjithë territorin) Bashkitë dhe komunat Instituti i Mjedisit Instituti Hidrometeorologjik Instituti i Shëndetit Publik Inspektoriatet përgjegjëse Ndërmarrjet publike të ujit të pijshëm dhe ujrave të zeza Zyrat rajonale dhe lokale Kompanitë e ujërave Shoqëritë private që shkaktojnë ndotje Shoqatat e përdorimit të ujit
Mbrojtja e ajrit	Ministria e Mjedisit Agjencitë Rajonale të Mjedisit Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit Ministria e Industrisë dhe Energjitikës Ministria e Shëndetësisë Instituti i Mjedisit Instituti Hidrometeorologjik Instituti i Shëndetit Publik Inspektoriatet përgjegjëse Shoqëritë private që shkaktojnë ndotje
Mbrojtja e mjedisit/ Mbrojtja e pyjeve/ Mbrojtja e tokës bujqësore	Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit Ministria e Mjedisit Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe Kullotave Drejtoria e Përgjithshme e Peshkimit Instituti i Tokave Instituti i Pyjeve Intituti i Kërkimeve Biologjike Kopështi Botanik dhe Muzeu i Shkencave Natyrore Policia e Shërbimit Pyjore Inspektoriatet Mjedisore Pushteti vendor(Bashki, Komuna)
Mbeturinat	Ministria e Turizmit dhe Planifikimit Hapësinor Ministria e Industrisë dhe Energjitikës Ministria e Shëndetësisë Ministria e Pushtetit Lokal dhe Decentralizimit Ministria e Mjedisit Agjencitë Rajonale të Mjedisit Bashkitë dhe komunat Inspektoriatet përgjegjëse Kompanitë private të pastrimit Shoqëritë private që shkaktojnë ndotje

Nëse një varg organesh të nivelit qendror dhe lokal, për shkak të veprimtarive që kryejnë dhe të detyrave që zgjidhin si administruese të mjedisit a të pjesëve e përbërësve të tij, gjenerojnë të dhëna dhe informacione mjedisore, deri tani nuk kanë marrë trainimet e nevojshme për t'i bërë të njohura këto të dhëna dhe nuk ndiejnë realisht ndonjë detyrim për t'i publikuar ato.

Këta tregues provojnë fare qartë nevojën e përpunimit urgjent të skemës kombëtare të publikimit të informacionit, në të cilën të jenë të identifikuar:

- të gjitha organet dhe subjektet e detyruara për publikimin e të dhënave dhe të informacionit mjedisor;
- të jenë të precizuara informacionet dhe të dhënat që duhet të publikojë secili, duke përfshirë domosdoshmërisht në to informacionet për vendimmarrjet dhe për hartimin e dokumenteve apo për kryerjen e veprimtarive, për të cilat është e detyrueshme pjesëmarrja e publikut;
- dokumentet standard që njoftojnë informacionin dhe të dhënat mjedisore që disponon secili;
- kohën, vendin dhe mënyrën e publikimit të informacioneve mjedisore nga secili që është identifikuar si i detyruar për të publikuar informacion;
- kjo skemë të jetë lehtësisht e shfrytëzueshme nga publiku, që ky të drejtorientohet për të kërkuar informacionet që i nevojiten, si dhe nga organet e kontrollit, që të kërkojnë llogari për funksionimin e saj.

Këto kërkesa dhe drejtime të punës në të ardhmen janë në përputhje të plotë me kërkesat e legjislacionit të ri mjedisor për këtë çështje. Sipas nenit 56 të ligjit “Për mbrojtjen e mjedisit”, saktësohen në masë të plotë gjithë elementët që kanë të bëjnë me detyrimet e organeve shtetërore për të publikuar informacionet mjedisore:

“1. Organet shtetërore që grumbullojnë të dhëna mjedisore i bëjnë publike ato në media dhe në shtyp ose me mjete të tjera të përshtatshme, në një formë të kuptueshme për publikun.

2. Organet shtetërore dhe personat fizikë e juridikë, sapo vërejnë ndotje ose dëmtim të mjedisit, njoftojnë popullsinë për ndryshimet mjedisore negative, për masat e marra për kufizimin ose mënjanimin e tyre dhe për mënyrën e veprimit të shtetasve për mbrojtjen e shëndetit dhe për sigurinë e tyre.

3. Personat fizikë e juridikë njoftojnë blerësit ose konsumatorët, në kohën e shitjes ose të kryerjes së shërbimit, me shkrim ose me gojë, për përbërësit e rrezikshëm të mallrave e të shërbimeve dhe për ndikimet negative në mjedis dhe në shëndet.

4. Të dhënat me karakter sekret për sigurimin kombëtar ose të konfidencialitetit tregtar kombëtar, administrohen sipas kërkesave të ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror”.

Lidhur me plotësimin e kërkesave të publikut për t'u informuar për gjendjen dhe mbrojtjen e mjedisit, vlen të theksohen:

Praktika tregon lidhje të ngushta e të shumëfishta midis shkallës së përgatitjes për publikimin e informacionit aktiv dhe të realizimeve konkrete të informacionit pasiv. Mosfunksionimi mirë i të parës është pengesa kryesore për realizimin cilësor të së dytës. Nga organe e subjekte që nuk kanë kuptime të drejta për detyrimet e tyre ndaj informacioneve mjedisore, që nuk janë të trainuara për ta bërë këtë punë dhe që nuk njohin rregullat dhe metodikat me të cilat operohet etj., nuk mund të pritët të jenë të afta e të gatshme t'u përgjigjen kërkesave të publikut siç e kërkon Konventa.

Që shpërndarja pasive e informacioneve të funksionojë në normalitet, kërkohet të përcaktohen dhe të saktësohen të gjitha modalitetet, në bazë të të cilave funksionon ky proces. Për publikun duhet të jenë të njohura organi dhe punonjësi të cilit do t'i drejtohet, koha për të marrë përgjigjen, ku mund të ankohet kur e çmon se ka vend për t'u ankuar etj. Ndërsa organi dhe punonjësi i ngarkuar me pranimin e kërkesës dhe me dhënien e përgjigjes, duhet të kenë parapërgatitur të gjitha elementët që janë në ngarkim të tyre, duke filluar që nga regjistri i kërkesave, të kenë përcaktuar kohën e përgjigjes sipas llojit të informacionit, procedurat e pranimit, të refuzimit ose të transferimit të kërkesës, grupin e informacioneve që jepen falas etj. dhe të gjitha këto duhet t'i bëhen të njohura publikut.

Gjithashtu, është i nevojshëm trajnimi i të detyruarve për të fituar njohuritë dhe shprehjet për t'iu përgjigjur me korrektesë dhe në kohë kërkesave të publikut për informacion mjedisor.

Me qëllim që kërkesat e Konventës dhe të legjislacionit të ri mjedisor për informimin e publikut të marrin zgjidhje të qëndrueshme dhe që të sigurohet zbatimi normal i tyre, strategjia sugjeron të ndërmerren këto hapa:

- Në përbërje të çdo organi të identifikuar si i detyruar për të publikuar informacion mjedisor, të caktohet një strukturë e posaçme a një person përgjegjës që do të merret me informacionin. Tërësia e këtyre personave do të formojë rrjetin kombëtar të pikave të kontaktit, i cili duhet të funksionojë edhe si i tillë dhe të institucionalizohen ekzistenca dhe veprimtaria e tij. Janë në objektin e tij të punës realizimi i veprimtarive kualifikuese me anëtarët e tij, bërja e analizave për mbarëvajtjen e punës, ngritja dhe zgjidhja e problemeve, duke sugjeruar në vijimësi përmirësime të të gjithë procesit informues. Kjo sipërmarrje mund të ndahet në dy etapa. Në të parën, që mund të jetë e realizueshme gjatë vitit 2005, të caktohen pikat e kontaktit; ndërsa krijimi i rrjetit të jetë hapi pasardhës, në një kohë më të vonshme dhe, mbi këtë bazë, të funksionojë për të gjithë vendin, Qendra Kombëtare e Informacionit Mjedisor.
- Të përcaktohen metodikat për përpunimin e të dhënave dhe për përgatitjen e informacionit për ta publikuar, në përputhje me llojin dhe natyrën e informacionit.
- Çdo organ të përcaktojë mjetet, mënyrat dhe metodat e publikimit të informacionit, në varësi nga lloji i tij dhe me synimin që të rritet në vijimësi pesha e publikimeve me metoda e sisteme elektronike.
- Çdo organ të hartojë treguesit e saktë për informacionet që disponon dhe t'i bëjë të njohura me rrugë elektronike. Këto indikacione të riazhornohen në përputhje me zhvillimet e informacioneve që gjenerohen e grumbullohen nga organi konkret.

2/2. Tërheqja e publikut në vendimmarrje për çështje që kanë të bëjnë me mjedisin

Siç dihet, Konventa e Aarhusit ka, gjithashtu, si objektiv të garantojë të drejtën e pjesëmarrjes së publikut në procedurat e vendimmarrjes në çështjet mjedisore, me qëllim që të kontribuojë në mbrojtjen e të drejtës së çdokujt për të jetuar në një mjedis të pastër dhe të sigurt për shëndetin dhe mirëqënien e tij.

Kjo kërkesë e Konventës është mjaft komplekse dhe që në fillim u identifikua si një drejtim i rëndësishëm i veprimtarive zbatuese. Deri tani vëmendja është përqëndruar në aspektin ligjor dhe institucional, ku janë realizuar mjaft rregullime të përshtatshme

në legjislacionin mjedisor dhe në ligjet organike të organeve të ndryshme, duke përcaktuar organizatet përgjegjëse, si dhe veprimtaritë në të cilat tërheqja e publikut është e detyrueshme. Në nenin që flet për këtë çështje, ligji “Për mbrojtjen e mjedisit”, urdhëron: Organet vendimmarrëse sigurojnë pjesëmarrje dhe rol aktiv të publikut dhe të organizatave jofitimprurëse gjatë procesit të vendimmarrjes.

Ndërsa zbatimet praktike të saj lenë mjaft për të dëshiruar. Edhe në rastet që mund të thuhet se u realizua tërheqja e publikut apo e OJF-ve, vërehet se ato kanë jo pak formalizëm, spontanitet dhe vlefshmëri të pakët praktike. Në këtë situatë këmbëngulet që angazhimet për zbatimin e kësaj kërkesë të Konventës duhet të vazhdojnë të konsiderohen pikë e nxehtë dhe me përparësi të gjenden zgjidhje e të bëhen rregullime që, tashmë, janë urgjente, si:

- Të identifikohen organet, që, sipas ligjit, realizojnë vendimmarrje që kanë të bëjnë me mjedisin.

Të tilla, në radhë të parë, janë organet e ngarkuara me mbrojtjen e mjedisit a të përbërësve të tij. Në këtë grupim përfshihen Ministria e Mjedisit, Agjencitë Rajonale të Mjedisit, Inspektorati i Mjedisit dhe inspektoriate të tjera, Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe Kullotave, Drejtoria e Përgjithshme e Peshkimit, organizmat ndërsektorialë për mjedisin, si Komiteti Ndërsektorial për zbatimin e PKVM-së, Këshilli Ndërmjedisor për zbatimin e Strategjisë dhe të Planit të Veprimit për Biodiversitetin, Këshilli për zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Shëndetin dhe Mjedisin, Grupi për të mbajtur nën kontroll shkretëtirëzimin etj.

Në radhë të dytë janë organet qendrore, që me ligj janë të ngarkuara me administrimin e përbërësve të mjedisit, si burimet natyrore dhe pasuritë minerare. Në këtë grupim futen ministrinë e linjës me strukturat e tyre.

Së treti, janë organizmat ndërsektoriale, në nivel qendror dhe lokal, që administrojnë territorin apo ujërat si KRRT-të e të gjitha niveleve, Këshilli Kombëtar i Ujërave dhe Këshillat e Baseneve, Komiteti Kombëtar i Turizmit, vendimmarrjet e të cilëve kanë të bëjnë drejtpërdrejt me mjedisin.

Një grup më vete e përbëjnë organet e qeverisjeve vendore të të gjitha niveleve, të cilat realizojnë vendimmarrje të ndryshme për mjedisin që kanë në juridiksion.

- Për secilin nga organet e përmendura, të identifikohen dhe të publikohen për një kohë sa më të shkurtër, vendimmarrjet dhe veprimtaritë ku tërheqja dhe pjesëmarrja e publikut është e detyrueshme sipas Konventës dhe legjislacionit vendas, duke mbajtur parasysh edhe kufizimet që bën vetë Konventa dhe legjislacioni vendas për probleme të sigurisë kombëtare, të sekretit shtetëror, të konfidencialitetit industrial e tregtar, si dhe për rastet e përballimit të emergjencave civile ku vendimet duhen marrë me shpejtësi.

- Të hartohen aktet nënligjore, si udhëzime e rregullore, që do të saktësojnë gjithë procedurën e komplikuar që funksionon në këto raste, duke dhënë zgjidhje të thjeshta për të gjitha momentet e procesit të tërheqjes së publikut, i cili, mund të ketë veçori për organe të ndryshme. Në këto udhëzime e rregullore duhet trajtuar, në radhë të parë, duke zënë vend të dukshëm në to, detyrimi i organeve vendimmarrëse për të informuar publikun për një vendimmarrje të mundshme a për përgatitjen e një dokumenti, si strategji, plan veprimi, plan menaxhimi etj. Po kështu, në këto akte rregullatore duhet të qartësohen si do të bëhet njoftimi, kujt do t'i drejtohet, çfarë materiali do të jepet paraprakisht etj.

Edhe pse duken si kërkesa të thjeshta procedurale e rregullatore, insistohet në hartimin dhe zbatimin e tyre, sepse, sipas kërkesave të Konventës, për organet shtetërore është detyrë e dorës së parë që të kujdesen që publikut t'i jepen në kohën e duhur informacionet dhe mundësitë reale të marrë pjesë në përgatitjen dhe në modifikimin ose në rishikimin e planeve ose të programeve, të cilat parashikohen në aneksin I të saj, si dhe në legjislationin vendas. Për këtë qëllim ato duhet të kujdesen që:

- publiku të jetë i informuar nga mjete të ndryshme të komunikimit elektronik
- publiku të jetë i aftë të formulojë mundësi dhe dhënie mendimesh, përpara miratimit të vendimeve që u përkasin planeve dhe programeve
- gjatë miratimit të këtyre vendimeve duhet të merren në konsideratë mendimet (rezultatet) e pjesëmarrjes së publikut
- pas shqyrtimit të vërejtjeve dhe të mendimeve të publikut, autoritetet kompetente të informojnë publikun për vendimet e marra dhe për arsyet mbi të cilat ato janë mbështetur për marrjen e vendimit.

Për të ilustruar domosdoshmërinë e hartimit dhe të zbatimit të akteve rregullatore, që zgjidhin praktikisht këto detyra konkrete të organeve publike, do të mjaftonin vetëm dy raste nga legjislationi i ri mjedisor. Për tërheqjen e publikut në procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis, ligji “Për mbrojtjen e mjedisit”, përcakton:

1. Në proceset e vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe të vlerësimit strategjik mjedisor marrin pjesë të gjitha palët e interesuara, veçanërisht organet e qeverisjes vendore, publiku dhe organizatat jofitimprurëse mjedisore.

2. Gjatë këtyre proceseve organi përgjegjës vë në dispozicion të publikut për këshillim, për një periudhë të mjaftueshme kohe, dokumentacionin e paraqitur nga kërkuesi.

3. Gjatë marrjes së vendimit, organi përgjegjës merr parasysh mendimin e organeve të qeverisjes vendore, të publikut dhe të organizatave jofitimprurëse.”

Ndërsa në ligjin “Për zonat e mbrojtura”, për një proces që mund të duket fare i parëndësishëm në raport me atë të VNM-së, siç është hartimi i planit për shpalljen e zonave të mbrojtura, thuhet që Ministria e Mjedisit të marrë në konsideratë “rezultatet e proceseve të bashkërendimit dhe të këshillimit me grupet e interesuara të shoqërisë civile, veçanërisht me popullatat ose bashkësitë brenda dhe përreth zonës së mbrojtur, duke përfshirë një përmbledhje të komenteve të marra dhe reflektimin e tyre në propozim”.

Mbi bazën e objektit të vendimmarrjes, të rëndësisë dhe të vlerave të dokumenteve që do hartohen si plane, programe, strategji etj. duhet të qartësohen përfundimisht me udhëzime të veçanta niveli i tërheqjes dhe i pjesëmarrjes së publikut për çdo rast konkret. Ky moment ka rëndësi themelore për shkallën e angazhimit të publikut dhe për vlefshmërinë e angazhimit të tij. Prirjeve thjeshtëzuese që formalizojnë zbatimin e kësaj kërkesë të Konventës, u ngushtohen hapësirat e veprimit, kur me udhëzime e rregullore përcaktohet qartë niveli dhe brendia e pjesëmarrjes së publikut.

Në këtë linjë, elementë shumë të thjeshta e konkrete si: ku do të depozitohen mendimet e publikut, nga kush duhet të studiohen, si do të komunikohet deri sa të bëhet një mbledhje etj. marrin rëndësi të dorës së parë. Por, siç del nga ajo pak praktikë që ekziston, momenti më i rëndësishëm dhe më i komplikuar ka të bëjë me faktin sa dhe si do të vlerësohen konkretisht sugjerimet dhe kërkesat e publikut në një vendimmarrje konkrete; sa do të merren parasysh mundësitë që ai ka paraqitur. Me

fjalë të tjera, u njoftua komuniteti për një vendimmarrje, iu dha mundësia të njihet me problemin që do të shqyrtohet, ka formuluar edhe disa sugjerime e kërkesa, merr pjesë edhe në mbledhjen vendimmarrëse, arrin edhe t'i thotë sugjerimet e tij, çështja është se çfarë bën mbledhja vendimmarrëse me këto sugjerime, sa është e detyruar t'i marrë parasysh dhe t'i reflektojë në vendimin që merr.

Në kuadër të gjetjes së zgjidhjeve sa më të përshtatshme, demokratike dhe funksionale, duket se ky problem do të meritojë edhe debate e konsultime, edhe njohje me përvojat e vendeve që tërheqjen e publikut në vendimmarrje e kanë kthyer në praktikë të rëndomtë pune. Gjithsesi, promovimi i praktikave të tërheqjes së publikut në vendimmarrje, mund të realizohet relativisht shpejt; ndërsa konsolidimi i tyre do të dojë kohë të gjatë dhe do të eci krahas demokratizimit të veprimtarisë shtetërore e të gjithë jetës së vendit.

- Në hartimin e akteve të tilla nënligjore, është e nevojshme të angazhohen edhe dikastere e institucione të ndryshme, secili në linjën e vet. Kështu, Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, së bashku me organet e qeverisjes vendore, duhet të plotësojnë kuadrin rregullator që të lehtësojë pjesëmarrjen e publikut dhe të OJF-ve në vendimmarrjet e qeverisjeve vendore. Kjo është me interesa të dukshme praktike, sepse veprimtaria e këtyre organeve rëndom është e lidhur me mjedisin dhe se publiku vendor është shumë i interesuar për vendimmarrjet e tyre. Natyrisht, që brenda këtyre zgjidhjeve, do të ndjehej e rregulluar edhe tërheqja e publikut për çështje që i përkasin mjedisit.

- Një ndërhyrje tjetër e tillë është e nevojshme të bëhet edhe për KRRT-të. Si organe vendimmarrëse ndërdikasteriale, të profilizuara për administrimin e territorit, KRRT-të e të gjitha niveleve ushtrojnë vendimmarrje me ndikime të dukshme në mjedis dhe me interes të veçantë për publikun. Rregullimet procedurale e administrative që do ta lehtësojnë faktikisht publikun e interesuar të njihet me veprimtarinë e këtyre organeve dhe të jetë i pranishëm në vendimmarrjet e tyre, tashmë, janë të domosdoshme. Sigurisht që nuk mund të mohohet se në disa rrethe e qytete ka përpjekje pozitive, diçka po bëhet në praktikë që t'u hapet rrugë komunikimit me publikun dhe tërheqjes së mendimeve të tij. Por, këto rregullime duhen thelluar më tej, për t'i siguruar mundësinë publikut që të thotë fjalën e tij për ato që do të vendosen, të jetë edhe ai një zë me peshë në këto vendimmarrje.

- Të njëjtat probleme dalin për Këshillin Kombëtar të Ujërave, për Këshillat e Baseneve, për Komitetin e Turizmit, si dhe për dikasteret e institucionet qendrore, në vendimmarrjet e të cilave duhet të jetë i njohur, i pranishëm dhe ta thotë fjalën e vet edhe publiku i interesuar dhe OJF-të e profilizuara. Zgjidhjet konkrete për këto raste do të konceptohen e do të realizohen nga këto organe si njohës më të kualifikuar të praktikës e të ligjit përkatës.

Drejtim ekskluziv i punës së Ministrisë së Mjedisit është zgjerimi i tërheqjes së publikut e OJF-ve në veprimtaritë kryesore të saj. Si organizmi më i ndërgjegjësuar për nevojën e tërheqjes së publikut në problemet mjedisore, ajo duhet t'i përqëndrojë përpjekjet për zgjerimin e ndjeshëm të praktikave modeste të deritanishme. Është në synimet e Ministrisë së Mjedisit që tërheqja e publikut dhe forcimi i lidhjeve me OJF-të të kthehen në element normal i metodës së punës, të vlerësohen si kërkesa themelore të metodikave të organeve e të strukturave të saj.

Aktualisht, Ministria e Mjedisit po punon për ta shtrirë e zgjeruar pjesëmarrjen e publikut dhe tërheqjen e mendimit të tij në veprimtaritë më themelore që ajo kryen dhe konkretisht:

- Në hartimin dhe miratimin e strategjive, programeve dhe planeve të veprimit për mjedisin. Në dokumente të tilla të rëndësishme, me të cilat ministria është vazhdimisht e angazhuar, duke i hartuar e ca më shumë duke i zbatuar, deri tani ka funksionuar me sukses përfshirja e OJF-ve në përbërje të grupeve të punës për hartimin e tyre. Mbi këtë përvojë mund të hidhet fare mirë hapi tjetër, tërheqja e tyre dhe e publikut në veprimtaritë për zbatimin e kërkesave të këtyre dokumenteve, në trajtë bashkëpunimi me ta e pse jo edhe duke u besuar realizime që i shkojnë natyrës së tyre.
- Në hartimin dhe në zbatimin e legjislacionit mjedisor. Këto 5 vjetët e fundit kanë funksionuar dy praktika: Ministria ka mbështetur deri në miratim projektligje të hartuara nga OJF-të, i ka tërhequr ato në diskutimet që ka organizuar për ligjet që janë hartuar prej saj. Është për t'u theksuar se gjatë këtij viti edhe komisionet e Kuvendit realizuan takime të gjera me komunitetin e Shkodrës e të Pogradecit për të diskutuar projektligjin "Për mbrojtjen e liqeneve ndërkufitare". Po kështu, qeverisja vendore e Elbasanit shpërndau në publik dhe organizoi konsulta me banorë të qytetit për projektregulloren e administrimit të mbetjeve urbane. Këto nisma rezultuan të suksesshme dhe sugjerohet të vazhdohet edhe për projekte të tjerë me ato grupe të publikut që janë të interesuar apo të lidhur drejtpërdrejt me aktin normativ.
- Në procesin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis. Në ligjin "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", i cili, tashmë, ka hyrë në zbatim, janë detajuar një varg momentesh të këtij procesi, në të cilët tërheqja e publikut, konsultimi me të dhe marrja parasysh e mendimeve të tij janë të detyruara dhe në përputhje të plotë me kërkesat e nenit 6 të Konventës, që kërkon pjesëmarrjen e publikut për të vendosur për lejimin e aktiviteteve të personave të veçantë ashtu siç është parashikuar në aneksin 1 të kësaj Konvente si dhe në aktivitete të tjera të palistuar që mund të kenë një efekt të rëndësishëm negativ në mjedis. Realizimet praktike të këtyre kërkesave, qëndrojnë në synimet e ministrisë dhe të ARM-ve, në përpjekjet e tyre për zbatimin e ligjit. Ka kohë për shembull që mendimi i komunitetit kërkohet praktikisht për çdo subjekt që i nënshtrohet procedurave të liçensimit. Aktualisht po vazhdon diskutimi me komunitetin e Vlorës dhe me mjaft të interesuar edhe në nivelin kombëtar, për mundësinë e ndërtimit të një TEC-i dhe të depozitave të karburantit në bregdetin e Vlorës. Mbi këto përvoja, mbetet që organizmat e ministrisë në bashkëpunim me qeverisjet vendore ku do të ushtrohet veprimtaria, të organizojnë më shpesh debatet me komunitetin dhe, për vitin 2005, kjo të jetë një objektiv, së paku, për veprimtaritë e rëndësishme që pajisen me deklaratë mjedisore e me leje mjedisore nga ministria.
- Në hartimin dhe në zbatimin e programeve të monitorimit të mjedisit. Tërheqja e publikut në këtë veprimtari është një nismë krejt e re, zbatimi i të cilës synon që në hartimin e këtyre programeve të mbahen parasysh ankesat dhe problemet që ngre publiku për gjendjen e mjedisëve konkrete, për ndotjet e shkarkimet në të, për dëmet që i shkaktohen nga veprimtari të ndryshme etj. Në zbatim të vendimit të Këshillit Kombëtar të Ujit "Për shfrytëzimin e zhavoreve në lumenj", gjatë këtij viti janë licensuar nga organet përkatëse shtetërore një numër i madh subjektsh

për të marrë zhavore nga shtretërit e lumenjve. Ndërkohë, nuk janë të pakta ankesat e fshatarëve se nga kjo veprimtari, lumenjtë po u kërcënojnë tokat, oborret e deri edhe shtëpitë e banimit gjatë periudhës së shirave. Këto do të ishin të mjaftueshme që në programet e monitorimit të përfshihej monitorimi i pasojave mbi mjedisin e këtyre veprimtarive dhe mbi bazën e të dhënave të sakta, të merrej një vendim i bazuar.

- Në veprimtaritë kontrolluese të gjendjes dhe të cilësisë së mjedisit e të veprimtarive ndotëse.

Drejtimit tjetër i rëndësishëm i angazhimeve të Ministrisë së Mjedisit e ARM-ve për tërheqjen e publikut në vendimmarrjet për çështje të mjedisit është përmirësimi i ndjeshëm i punës me OJF-të ambientaliste. Pas disa vitesh përvoja, është plotësisht e mundur që tashmë të dominojnë mendësi bashkëkohore për rolin e pozitën e OJF-ve, për zhvillimin në rrugë ligjore të marrëdhënieve të bashkëpunimit e rakordimit, të partneritetit e të oponencës me to, për angazhimin e të gjitha hallkave e organizmave të ministrisë në lidhjet me to etj. Për t'i institucionalizuar këto lidhje, në fillim të vitit 2004 në Durrës u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit midis Ministrisë së Mjedisit dhe mbi 20 OJF-ve mjedisore.

Kjo nismë është e nevojshme të thellohet, duke u pasuar edhe nga veprime të tjera konkrete, siç mund të ishin:

- Të hartohet adresari i OJF-ve ambientaliste kombëtare.
- Të hartohen adresarët nga Agjencitë Rajonale për OJF-të e Qarkut ku ato veprojnë.
- Të bëhet i rregullt furnizimi i OJF-ve, qoftë edhe me përzgjedhje, me botime e materiale që nxjerr ministria dhe që publikohen edhe nga të tjerët, për Konventën e për mjedisin në përgjithësi.
- Në bibliotekë të formohet fondi i botimeve të OJF-ve dhe të ftohen ato të depozitohen materialet e tyre.
- Të hartohet dhe të miratohet Kalendari Mjedisor Kombëtar.
- Të bashkëpunohet me to në sa më shumë fusha, por, veçanërisht, në kremtimin e ditëve të Kalendarit Mjedisor.
- Me drejtues të OJF-ve, gjatë vitit, të kryhen 2-3 veprimtari kualifikuese si për hartimin e projekteve, për njohjen me synimet e nismat vjetore të Ministrisë, për zbrërthim ligjesh, Konventash e programesh, për të zbatuar strategji të miratuara etj.
- Të publikohen përparësitë e Ministrisë në fushën e projekteve dhe të nxiten OJF-të për t'u angazhuar në hartimin e projekteve konkrete.
- Të kanalizohet dhe të funksionojë shkëmbimi i rregullt i informacioneve nëpërmjet Qendrës së Informacionit.
- Të nxiten OJF-të për të përgatitur e botuar materiale në buletin e Ministrisë, me synimin që çdo numër të ketë material prej tyre.
- Në kuadër të zbatimit të lidhjeve dypalëshe, të krijohen hapësira reale për lidhjet e bashkëpunimet midis OJF-ve të vendeve fqinje e të rajonit.

Tërheqja e publikut në vendimmarrje, përveç si tërësi detyrimesh procedurale e rregullatore që ka organi dhe punonjësi shtetëror, është e ndërvarur edhe nga motivimi e predispozita e këtyre të fundit për t'i zbatuar me nivel dhe cilësi kërkesat ligjore,

regullatore e procedurale. Ky është një drejtim më vete, disi i pamatshëm, i angazhimeve për zbatimin e Konventës që përmbledh ndërjegjësimet, trainimet, veprimtaritë treguese, për të braktisur mentalitetin se tërheqja e publikut është një angazhim plus, është një andrallë për punonjësit e shtetit dhe për të ngulitur mendësitë se ajo është e domosdoshme për vetë punonjësit, të cilët duhet ta sigurojnë e ta realizojnë për interesat e punës së tyre. Në kuadër të të gjithë punëve e veprimtarive zbatuese, ky transformim mendësish e psikologjish nuk mund t'i lihet spontanitetit apo të neglizhohet.

Pjesëmarrja e publikut, OJF-ve dhe organizmave publike në vendimmarrje për problemet e mjedisit dhe shëndetit është e nevojshme, sepse ajo tenton të përmirësojë cilësinë e vendimeve dhe të rritë nivelin e mbështetjes së publikut për rezultatet.

Është e njohur që vlerësimi i ndikimit në mjedis është veprimtaria më serioze dhe më e komplikuar si procedura, që realizojnë organet e specializuara në mbrojtjen e mjedisit. Informimi dhe tërheqja e publikut në fazat e ndryshme të kësaj veprimtarie, përfaqëson një nga kërkesat më themelore të Konventës.

Krahas kësaj, me rivlerësimet aktuale të binomit mjedis-shëndet, vëmendja duhet përqëndruar edhe në informimin dhe tërheqjen e publikut edhe në procedurat vlerësuese që realizohen në kuadër të kësaj kërkesë.

Përsa i përket mundësisë për pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje në procese që kanë ndikime të rëndësishme mbi shëndetin, kjo duhet të forcohet në të ardhmen, qoftë në kuadrin e Konventës apo në kuadër të nismave të tjera. Për shembull, të tjera hapa duhen ndërmarrë për të siguruar pjesëmarrjen e publikut në procesin e autorizimit për transportin e mbetjeve të rrezikshme dhe nukleare, në aktivitete me ndikim të dukshëm mbi shëndetin. Po në mënyrë të njëjtë, në fushën e organizmave gjenetiksht të modifikuara, e bën imperative sigurimin e, së paku, në disa shkallë të pjesëmarrjes publike në vendimmarrje në këtë fushë, sikurse edhe në aktivitete të tjera.

Në dekadat e fundit vlerësimi i ndikimit në mjedis në projekte të ndryshme ka siguruar një mekanizëm veçanërisht të rëndësishëm për pjesëmarrjen e publikut në disa kategori të vendimmarrjes, në një sërë vendesh. Është shumë e rëndësishme që edhe te ne të fuqizohen këto eksperiencia dhe të rritet efektiviteti i saj, duke u përqëndruar kryesisht në tri mënyra:

- së pari, duke përfshirë ndikimin në shëndet në një shkallë më të madhe veprimtarish që u vlerësohet rreziku,
- së dyti, duke i bërë të mundur publikut të marrë pjesë në një shkallë më të madhe, veçanërisht në fazën e përcaktimit të qëllimit të VNM-së, dhe
- së treti, duke zgjeruar llojet e vendimmarrjes, përfshirë këtu politika, plane, programe dhe legjislacion në lidhje me mjedisin dhe shëndetin.

Udhëzimi i dhënë nga Task Force i Komitetit Evropian për Mjedisin dhe Shëndetin përmban rekomandime të ndryshme dhe sugjerime në lidhje me pjesëmarrjen dhe konsultimin me publikun. Në lidhje me këtë, Udhëzimi i Sofies (paragrafi 7), udhëzon nevojën për një strategji të pjesëmarrjes së publikut dhe thekson se përgjigjja e marrë nga publiku është me influencë.

Konsultimi i OBSH/EURO për informimin dhe pjesëmarrjen e publikut për problemet e shëndetit mjedisor përmbledhi situatën në vendet evropiane dhe përgatiti një set me rekomandime se si të adresohen problemet e informacionit dhe të pjesëmarrjes së publikut.

Studimi i kryer nga Qendra Rajonale e Mjedisit për Evropën Qendrore dhe Lindore (REC), vë në dukje se, ndërsa disa vende i kanë dhënë mundësi të madhe publikut për të marrë pjesë në procesin e NEHAP-it, në disa vende të tjera ka pak ose aspak përfshirje të publikut. Në rastin e LEHAP-eve (apo të inisiativave të tilla si Axfenda Lokale 21 ose Qytete të Shëndetshme), duket që ka një pjesëmarrje më të madhe. Megjithatë studimi i REC ka mbuluar një numër relativisht të vogël vendesh në një stad të hershëm të procesit të NEHAP/LEHAP-eve, me sa duket, ka shumë vend për përmirësim.

Në dritën e këtyre nismave dhe sugjerimeve, organet shtetërore duhet të vazhdojnë të rrisin përpjekjet për përfshirjen e publikut dhe OJF-ve në vendimmarrje për problemet e mjedisit dhe shëndetit. Vëmendje e veçantë u duhet kushtuar inkurajimit të pjesëmarrjes dhe të interesimit të publikut dhe OJF-ve në promovimin e objektivave të mjedisit dhe shëndetit. Në veçanti, pjesëmarrja e publikut në zhvillimin dhe zbatimin e NEHAP-eve dhe LEHAP-eve, duhet të sigurohen duke marrë në konsideratë udhëzimet e REC, rekomandimet e dala në konsultimin Michelstadt dhe udhëzimin e Task Force të NEHAP-it. Vlerësimi i ndikimit në shëndet (HIA) është një kombinim i procedurave, metodave dhe i mjeteve me anën e të cilave një politikë, program ose projekt mund të gjykohej e të vlerësohet për efektet e tij të fuqishme në shëndetin e popullatës dhe në përhapjen e këtyre efekteve në popullatë.

Kohët e fundit ka një rritje të njohjes nga qeveritë të ndikimit të determinanteve sociale, ekonomike dhe mjedisore në shëndet dhe të nevojës për t'i adresuar ato si pjesë të strategjive të shëndetit. Ky qëndrim është rforcuar nga Artikulli 152 i Marrëveshjes së Amsterdimit për shtetet anëtare të Komunitetit Evropian dhe nga OBSH-ja për vendet e Rajonit Evropian.

Barrierat kryesore për përdorimin e vlerësimit të ndikimit në shëndet janë mungesa e aftësive dhe ekspertizës, mungesa e ndërgjegjësimit dhe e kuptimit për këtë qëndrim, si dhe mungesa e burimeve për t'u aplikuar. Këto janë të lidhura ngushtë me mungesën e metodologjisë përsa i përket këtij procesi.

Bashkëpunimet midis Ministrisë së Mjedisit dhe Ministrisë së Shëndetësisë duket se janë të domosdoshme për përgatitjen dhe zhvillimin e sistemit kombëtar për vlerësimin e ndikimit strategjik të mjedisit dhe shëndetit, duke përfshirë edhe kërkesat për pjesëmarrjen e publikut.

2/3. Për të drejtën e publikut të ngrejë padi në gjykatë

Duke i sanksionuar publikut të drejtën të ankohet në gjykatë për probleme mjedisore, Konventa ka hedhur një hap vendimtar jo thjesht në zgjerimin e të drejtave të tij, por sidomos në garantimin e zbatimit të tyre, në angazhimin edhe të pushtetit gjyqësor në mbështetjen e publikut në mosmarrëveshjet publik-administratë shtetërore.

Pas Kodit Penal, konkretisht, kapitullit të tij për krimet në mjedis dhe të disa neneve të kodit civil që trajtojnë çështje të mjedisit, e drejta e publikut për t'u ankuar në gjykatë për çështje të mjedisit është një mundësi e re për të rritur ndjeshëm praninë dhe rolin e

organeve të drejtësisë në marrëdhëniet mjedisore e veçanërisht në mbrojtjen e mjedisit. Ajo jep më shumë shanse të futet në rrugën e rregullimit një mangësi e dukshme në mendësitë dhe praktikën e derisotme për çështje të mjedisit, në të cilat prania e pushtetit gjyqësor dhe e organeve të drejtësisë është krejt modeste dhe thuhet nuk ekziston.

Edhe pse krijon një hapësirë të re veprimi në fushën e marrëdhënieve mjedisore, e drejta për t'iu drejtuar gjykatës është e lidhur drejtpërdrejt me dy të drejta e sipërpërmendura dhe njëherësh ndihmon të sigurohet zbatim i qëndrueshëm dhe i efektshëm i kërkesave të Konventës për të drejtën për informim dhe për pjesëmarrje të publikut në vendimarrje. Duke i dhënë publikut të drejtën të ankohet në gjykatë, kur i cënohet e drejta për t'u informuar, si dhe e drejta për të marrë pjesë në vendimarrjet mjedisore, Konventa ka pranuar haptas që publiku të ketë një mjet të fortë detyrues e ndëshkues ndaj kujtdo organi të administratës që i prek të drejtat e tij në këto fusha. Për më tepër, zbatimi në praktikë i kësaj të drejte është një mbështetje e fuqishme e përpjekjeve të shtetit për të zbatuar ligjin mjedisor.

E drejta për t'iu drejtuar gjykatës do të thotë që publiku ka, tashmë, mekanizma ligjorë, të cilët mund t'i përdorë për të përfituar shqyrtimin gjyqësor të shkeljeve të mundshme të kërkesave të Konventës lidhur me të drejtën për informacion dhe për pjesëmarrjen e tij në vendimarrje, si dhe të gjithë kërkesave të tjera që parashikohen në legjislacionin mjedisor shqiptar.

Nga pikëpamja metodike dhe e rendit të gjërave, edhe për ushtrimin e kësaj të drejte, fillimisht, është i nevojshëm informacioni i lidhur drejtpërdrejt me ushtrimin e kësaj të drejte, i cili mund të përmblihet:

Së pari: Në informimin e publikut lidhur me të drejtat dhe garancitë ligjore që ai gëzon në legjislacionin shqiptar (p.sh. në Kodin Civil, në Kodin e Procedurës Civile, në Kodin e Procedurave Administrative).

Së dyti: Në informimin e publikut për të drejtat që ai gëzon sipas Konventës së Aarhusit dhe Direktivës së vitit 2003 të Parlamentit e të Këshillit Evropian.

Së treti: Në informimin e publikut për të drejtën e tij të ankimimit nga pikëpamja procedurale.

Lidhur me këtë informim specifik deri tani është bërë pak dhe, për të dalë nga kjo gjendje, sugjerohet që gjatë vitit 2005 të realizohen disa veprimtari të gjera njohëse, si dhe të përgatiten e të publikohen materiale të thjeshta informuese sipas drejtimeve që u përmenden më lart.

E konceptuar si e drejtë ankimore, e drejta që i jep Konventa publikut ka një shtrirje dhe mundësi shumë të gjera realizimi, duke u bazuar në legjislacionin aktual, kur zbatohet në rrugë administrative. Që nga koha e hyrjes në fuqi të Kodit të Procedurave Administrative, është përmirësuar mjaft situata ligjore në zbatim të kësaj kërkesë të Konventës, duke u mbështetur në dy elemente të rëndësishme:

Së pari, në këtë kod parashikohet rregulli që një ankim në gjykatë ndaj një vendimi administrativ mund të bëhet vetëm pasi për të është kryer ankimi në rrugë administrative. Pra, për çdo rast, përfshi edhe problemet mjedisore, para se të bëhet ankimi në gjykatë duhet të jetë bërë dhe të ketë përfunduar ankimi në organin më të lartë të administratës shtetërore nga varet organi për vendimin e të cilit do bëhet ankimi. Kjo rrethanë procedurale është me vlerë të madhe praktike, sepse legjitimon

ankimin në gjykatë, kur ai zbaton të gjitha kërkesat proceduriale dhe kalon nga ankesë administrative në ankesë gjyqësore.

Së dyti, në këtë kod janë parashikuar dhe janë rregulluar deri në detaje rregullat, procedurat, afatet etj. për të ushtruar lehtësisht të drejtën ankimore në rrugë administrative, përfshi edhe për problemet që shtrihen Konventa e për çështje të mjedisit në tërësi, sa kohë që ato shfaqen si vendime të organeve shtetërore mjedisore ose kanë të bëjnë me probleme të mjedisit.

Në mënyrë të veçantë duhet theksuar se legjislacioni i ri mjedisor është treguar i vëmendshëm, mbështetës dhe përkrahës i të drejtës ankimore të publikut, duke krijuar hapësirat e nevojshme për ankimin mjedisor në rrugë administrative. Konkretisht, në ligjin e ri “Për mbrojtjen e mjedisit”, theksohet: “Kushdo ka të drejtë të ankohet tek organet shtetërore të mjedisit për çdo veprimtari që përdor, kërcënon, dëmton dhe ndot mjedisin dhe të kërkojë mbylljen e saj në rast rreziku. Përveç marrjes së masave, këto organe i përgjigjen kërkesës brenda një muaji nga marrja e saj.” Veç kësaj, ky konfirmim i përgjithshëm është detajuar në ligjet e veçanta për rastet konkrete që ato shqyrtojnë dhe është plotësuar kuadri më i gjerë i rasteve për ushtrimin e ankimit administrativ.

Si arritje në plotësimin e kushteve dhe në përgatitjen e terreneve ligjore e institucionale për zbatimin e ankimit në rrugë administrative, duhen përmendur edhe rregullimet shumë pozitive të bëra në legjislacionin e ri për shoqatat, rregullime të cilat janë tërësisht në frymën dhe në kërkesat e Konventës. Duke u njohur shoqatave të drejtën të interesohen e të ankohen në rrugë administrative për çështje të karakterit dhe të interesit të përgjithshëm, këto rregullime kanë çelur shtegun që kërkohet, kanë legjitimuar të drejtën e ankimit edhe për çështje të interesave jo vetjake.

Ankimi në organet më të larta, për vendime të organeve më të ulta, pjesëmarrja në një procedurë administrative, në praktikë po ushtrohen rëndom. Ka, tashmë, një praktikë relativisht të pasur të ushtrimit të së drejtës ankimore në rrugë administrative, në nivel qendror dhe në nivel lokal. Në këtë klimë edhe në organet mjedisore po shfaqet përherë e më shpesh ankimi, si mjet për të rregulluar një situatë praktike, një veprim ose mosveprim të një organi a të një operatori etj. Sigurisht që shumica dërrmuese e ankimeve janë nga persona fizikë, të cilët mendojnë se u është shkelur një e drejtë dhe u cënohen interesa vetjake. Por është pozitiv fakti që po shtohen edhe ankimet kolektive, nga grupe të komunitetit, nga shoqata mjedisore e, madje, edhe nga disa shoqata njëherësh, për probleme të rëndësishme mjedisore. Të tilla mund të përmenden rasti ndaj mundësisë që parashikonte qeveria për ndërtimin e Hidrocentralit të Bushatit, që, sipas komunitetit lokal e disa OJF-ve, prishte ekosistemin e përbashkët të lumenjve Drin, Bunë e Liqeni i Shkodrës; rasti i vendosjes së sondës për shpim-kërkim nafte dhe gazi në Lagunën e Nartës; rasti i ndërtimit të një ndërtese kulturi në qendër të Tiranës në një sipërfaqe të gjelbër të saj; rasti më i freskët i mundësisë për të futur në Shqipëri një sasi prej 16 mijë ton misër dhe soje gjenetikisht të modifikuar etj.

Sigurisht që këto raste nuk janë pak për realitetet shqiptare. Ato dëshmojnë për interesim e rol aktiv të publikut e të OJF-ve, për angazhim të lavdërueshëm të tyre në mbrojtje të mjedisit e të shëndetit të njeriut, sipas frymës dhe kërkesave të Konventës, si dhe të kërkesave të legjislacionit të ri mjedisor. Megjithatë, vlen të evidencohen

disa momente që meritojnë vëmendje në raport me zbatimet autentike të së drejtës që jep Konventa për t'u ankuar:

E gjykuar si një e tërë, e drejta ankimore e publikut ndahet në dy faza dhe ushtrohet në dy rrugë: si e drejtë ankimore në rrugë administrative dhe, pas kësaj, si e drejtë ankimore në rrugë gjyqësore, në gjykatë. Sipas këtij përcaktimi të legjislacionit vendas, në pamje të parë, duket sikur nga pikëpamja procedurale publikut i vështirësohet e drejta për t'u ankuar në gjykatë. Në thelb, kështu ajo është e plotë dhe në praktikë krijon favore të ushtrimit tërësor dhe përfundimtar të saj. Ndërkohë, meritojnë vëmendje harmonizimi dhe përputhshmëritë në zbatim për të dy nivelet; lehtësimi i procedurave, i afateve, i tarifave etj. në të gjithë procesin ankimor, qoftë administrativ, qoftë në rrugë gjyqësore.

Thelbi i ankimit në rastet që u përmendën ka qenë organizimi i veprimtarive kolektive, sensibilizimi i opinionit, duke përdorur mediat vizive dhe shtypin, hartimi i peticioneve, çka dëshmojnë më shumë për një revoltë e protestë që duket se janë më të thjeshta për t'u organizuar, sepse dominohen e realizohen nga vetë organizatorët.

Ka munguar në këto raste dhe në të tjera më të thjeshta ushtrimi i të drejtës ankimore sipas rregullave dhe procedurave e duke iu drejtuar një organi konkret me ankesë të shkruar. Dhe ndodh kështu për faktin e thjeshtë, por mjaft domethënës se mungojnë informacioni dhe njohuritë për rregullat e procedurat që duhen zbatuar për t'u ankuar në rrugë administrative në kësi rastesh; sepse kontaktet dhe komunikimet me organet shtetërore shfaqen më të vështira e me më pak rezultat se sa organizimi i protestave që realisht duan shumë mund, energji e përkushtim për t'u realizuar. Nga kjo situatë, kuptohet lehtësisht se njohja e punonjësve të organeve të ndryshme shtetërore dhe të drejtësisë me legjislacionin mjedisor, me Konventën e me direktivat përkatëse të BE-së, trainimi i tyre për të realizuar zbatimet praktike të së drejtës për t'u ankuar në gjykatë mbeten drejtime të angazhimeve për zbatimin e Konventës.

Edhe pse me këto vlera e ndikime pozitive në zbatimin tërësor të Konventës, duhet thënë që në fillim se sigurimi i kushteve dhe i lehtësive për zbatimin nga publiku i të drejtës për t'u ankuar në gjykatë për çështje mjedisore dhe sidomos zbatimet praktike të saj, vazhdojnë të mbeten pika më e dobët në përpjekjet për zbatimin e Konventës. Në raport me dy të drejtat e tjera, në këtë rast ka një prapambetje e një ngadalësi dhe zor se mund të flitet për rezultate që meritojnë të evidentohen. Arsyet e kësaj shtate janë të shumta dhe, përgjithësisht, të njohura. Ato kanë të bëjnë me traditat jo shumë të kultivuara për t'iu drejtuar gjykatës, me opinionet e vlerësimet aktuale për nivelin e rolin e gjykatave etj., të cilat duhen përballuar me masa të shumëanshme për ta ndryshuar pozitivisht gjendjen.

Por, veç këtyre meritojnë të evidencohen edhe disa faktorë, që kanë një peshë, shpjegojnë gjendjen e prapambetur dhe përbëjnë njëherësh drejtime parësore të punës në të ardhmen:

Në ndryshim nga të drejtat e tjera, për të cilat ishte e lehtë të identifikoheshin organet shtetërore përgjegjëse për krijimin e terrenit dhe për zbatimin e tyre dhe për të siguruar zbatimet praktike (këtë barrë deri tani e ka përballuar përgjithësisht Ministria e Mjedisit), për të drejtën për të ngritur padi në gjykatë nuk u identifikua ndonjë organ

shtetëror që të angazhohej realisht dhe të siguronte të gjitha kushtet që nevojiten për zbatimin e saj.

Në legjislacionin e ri mjedisor për këtë të drejtë është bërë një punë e veçantë. Kështu, u miratua një nen i veçantë, i titulluar “E drejta për padi gjyqësore” (neni 81 i ligjit “Për mbrojtjen e mjedisit), i cili sanksionon: “Në rast kërcënimi ndaj mjedisit, ndotjeje dhe dëmtimi të tij, qytetari, publiku dhe organizatat jofitimprurëse kanë të drejtë:

- t’u kërkojnë organeve shtetërore përkatëse marrjen e masave të duhura brenda afateve dhe në përputhje me autoritetin që u jep ligji;
- të ngrenë padi në gjykatë, në kushtet e parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile, kundër organit publik ose personit fizik e juridik që ka sjellë dëme në mjedis ose që rrezikon ta dëmtojë atë”.

Gjithashtu, fushë e gjerë për ankimin në gjykatë është hapur në të gjithë ligjet e reja për mjedisin, të cilat, për çdo rast vendimesh të organeve mjedisore, kanë sanksionuar të drejtën për t’u ankuar edhe në gjykatë, si shkalla e fundit ku mund të ushtrohet proceduralisht e drejta ankimore. Dhe duhet thënë se raste të tilla janë me dhjetëra, qoftë në kuadrin e procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis e të akordimit të lejes mjedisore, në kuadrin e kontrolleve mbi mjedisin dhe mbi veprimtaritë ndotëse etj.

Por edhe pse këto përbëjnë një arritje në krijimin e kushteve për zbatimin e të drejtës së publikut për t’u ankuar në gjykatë, ky rregullim ligjor është akoma pak për të zgjidhur dhe për të garantuar tërësisht ushtrimin e saj në praktikë. Mbetet detyrë urgjente që legjislacioni aktual të plotësohet me norma që të shprehen drejtpërdrejt dhe t’i njohin publikut të drejtën që të ankohet në gjykatë edhe kur i cënohen, i pengohen, i vonohen etj. të drejtat e tij për informacion mjedisor e për të marrë pjesë në vendimmarrjet për mjedisin, momente këto me të cilat është e lidhur thelbësisht e drejta e tij për t’u ankuar në gjykatë.

- Rregullimet e deritashme në legjislacionin e ri mjedisor, duhen vlerësuar si hapi i parë në plotësimin e kërkesave të Konventës edhe për një arsye tjetër, që ka të bëjë me konceptimin dhe me realizimin e plotësimeve e të përmirësimeve jashtë legjislacionit mjedisor. Aktualisht, ai kërkon të pasohet nga hapa të tjera ligjore e institucionale, në sferën e organeve të drejtësisë.

- Si një e drejtë specifike dhe krejt e re, e drejta e publikut për t’u ankuar në gjykatë meriton angazhimin më të dukshëm të gjykatave, të Ministrisë së Drejtësisë, të avokatëve, të Avokatit të Popullit, të Fakultetit Juridik, për të bërë rregullimet e nevojshme në Kodin e Procedurës Civile, për të hartuar dhe miratuar rregulla e procedura favorizuese për publikun siç i kërkon Konventa, si dhe për të ndjekur me vëmendje zbatimin e saj në praktikë. Në këtë kuadër, ka nevojë të menjëhershme për përgatitjen dhe publikimin e informacioneve të bollshme se si funksionon e drejta për t’u ankuar në gjykatë dhe se çfarë duhet të bëjë publiku për ta ushtruar atë në rastet konkrete.

Hapat dhe veprimet që u përmendën deri tani, mund të pasohen edhe nga të tjera që kanë të bëjnë me zgjerimin e kuptimit për gjykatën ku mund të ankohet publiku dhe konkretisht:

- Realizimin praktik të të drejtës për t’u ankuar në gjykatë, do ta ndihmonte thellimi i reformës së organeve të drejtësisë dhe i sistemit gjyqësor. Nuk është më i

parakohshëm sugjerimi që në kuadër të ndarjes e të profilizimit të gjykatave, të mendohet edhe për të krijuar gjykatën mjedisore, qoftë edhe si një nëndarje e gjykatës administrative.

- Si gjykata për të pranuar ankimet e publikut për çështje të mjedisit, duhet të konceptohen gjykatat e të gjitha shkallëve dhe niveleve, duke respektuar rregullat e procedurat për ankim, si dhe funksionet e kompetencat e tyre. Kjo duket si një kërkesë e tepruar apo e parakohshme, kur, në fakt, është normale dhe e kohës. Siç dihet, sipas kushteve të parashikuara me ligj, publiku mund të ankohet në gjykatë për ligje e akte nënligjore të fushës së mjedisit, që vijnë në kundërshtim me Kushtetutën, dhe të kërkojë shfuqizimin e tyre. Një kërkesë e tillë mund të parashtrohet për gjykim edhe në Gjykatën Kushtetuese.
- Madje, publikut duhet t'i shpjegohet se për çështje të mjedisit, ka të drejtë të ankimojë edhe në Gjykatën Ndërkombëtare të Hagës.

Këto kërkesa nuk kanë për qëllim të shtojnë numërat e gjykatave thjesht për dukje apo për modë, por kanë të bëjnë me rritjen e shanseve që publiku të fitojë proceset gjyqësore që i takojnë me ligj.

Si edhe për të drejtën për të marrë pjesë në vendimmarrjet mjedisore edhe në ushtrimin praktik të kësaj të drejte, përcaktimi i saktë i përmbajtjes së emërimit “publik” merr rëndësi të veçantë, së paku, në aspektet proceduriale. Është e rëndësishme të theksohet se Konventa detajon nën këtë emërtim grupe të ndryshme të komunitetit e të bashkësive, të cilët, në raste konkrete, shfaqen si publik i interesuar, si publik i ndikuar, si OJF, si një person i vetëm etj. Në nenin 2 të Direktivës nr. 2003/35/CE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e 26 majit 2003, e cila parashikon pjesëmarrjen e publikut gjatë përpunimit të planeve dhe programeve për mjedisin dhe modifikon direktivat 85/337 /CEE dhe 96/61 CE të Këshillit, që trajtojnë pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe të drejtën për t'u ankuar në gjykatë, “publiku” përkufizohet si një ose disa persona dhe, në pajtim me legjislacionin dhe praktikën e nje vendi, mund të quhen: Shoqatat, Organizatat ose grupet e përbëra nga këta persona juridikë.

Për të pasur ushtrim praktik të së drejtës për t'u drejtuar në gjykatë, duhet të marrin zgjidhje dhe të kapërcehen vështirësitë praktike dhe financiare që shfaqen në këto raste, si, për shembull, përdorimi i tarifave dhe i kostove të favorshme, të përballeshme nga publiku.

Ushtrimin e së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës do ta ndihmonte sigurimi i ekspertizave të specializuara për çështjet objekt shqyrtimi, si dhe ngritja e një zyre a një organizmi paragjyqësor me kompetenca për zgjidhjen e problemeve të mjedisit dhe të shëndetit, sipas përvojës së disa vendeve ku kjo praktikë funksionon.

3. Intensifikimi i përpjekjeve për zbatimin e ligjit

Nga sa u trajtua deri tani, është e nevojshme të ritheksohet me forcë se momenti më i rëndësishëm ku kërkohen angazhime shumë serioze dhe zgjidhje të afta të sjellin

ndryshime të menjëhershme, ka të bëjë me ecurinë e zbatimit në praktikë të të drejtave e detyrave që lidhen me:

- grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e informacionit mjedisor;
- tërheqjen e publikut në vendimmarrjet mjedisore;
- ushtrimin praktik të të drejtës ankimore në gjykatë.

Nga vëzhgimet, konsultat me OJF-të etj. del se informimi për mjedisin është shumë më ulët se mundësitë dhe kapacitetet aktuale në shërbim të tij. Ndërkohë që konfirmohet edhe ana tjetër e çështjes se janë ende të pakta e të rralla kërkesat kolektive apo individuale për të marrë informacion mjedisor nga organet shtetërore. Po kështu, tashmë, ekziston detyrimi ligjor për organet shtetërore që të sigurojnë pjesëmarrjen e publikut në mjaft veprimtari e vendimmarrje që përcaktohen me ligj; ndërsa në praktikë interesimi dhe aktivizimi i publikut dhe i OJF-ve për ta ushtruar këtë të drejtë është sporadik, po ashtu sikurse detyrimi i organeve dhe i punonjësve shtetërorë për ta tërhequr publikun lë shumë për të dëshiruar. E njëjta gjë mund të thuhet më me vërtetësi për zbatimin e të drejtës për t'u ankuar në gjykatë.

Pra, përgatitja e lehtësive dhe e infrastrukturës, po ta quanim kështu, në shërbim të zbatimit të kërkesave të Konventës, ka ecur, ato, gjithësesi, janë plotësuar e janë përmirësuar; ndërsa zbatimet praktike të të drejtave të publikut nuk kanë ecur me të njëjtin ritëm, ato janë në fillosat e tyre të drojtura dhe jo në nivelet që kërkohen nga Konventa. Kjo është situata me të cilën përballen aktualisht përpjekjet për zbatimin e Konventës; ky është problemi që meriton investime dhe kërkon zgjidhje.

Sigurisht që veprojnë shumë faktorë dhe mund të renditeshin shumë arsye të besueshme të karakterit botëkuptimor e psikologjik të përvojës, të vështirësive praktike etj. që ndikojnë në këtë situatë. Ka nevojë që ato të studiohen e të gjenden zgjidhjet për kapërcimin e secilës prej tyre. Por, faktori më me peshë, i lidhur drejtpërdrejt me këtë zhbalancim raportesh midis përgatitjes së kushteve dhe zbatimeve praktike, është shkalla ende e ulët e zbatimit të ligjit.

Që shkalla e zbatimit të ligjit edhe në nivel kombëtar dhe në të gjitha fushat është ende e ulët, përbën një të vërtetë të njohur e të pranuar dhe ky është i identifikuar si problem i rëndësishëm, me të cilin përballet shoqëria aktuale shqiptare. Akoma më shumë është i vërtetë ky konstatim për legjislacionin mjedisor, qoftë për faktin e thjeshtë se njohja, kultura dhe edukata shtetërore e qytetare për mjedisin është ende në foshnjërinë e saj; qoftë për rrethanën që ai është një legjislacion krejt i ri, i miratuar këto dy vitet e fundit dhe që ende nuk pretendon të jetë në rreshtat e parë në renditjen e ligjeve sipas rëndësisë.

Sigurisht që kjo situatë po ndryshon pozitivisht dhe po zgjerohet vazhdimisht kuadri i faktorëve shoqërorë e shtetërorë që po angazhohen për ta përmirësuar rrënjësisht situatën. Për të dinamizuar këtë prirje, duke shfrytëzuar faktin që legjislacioni i ri mjedisor është në valën e përpjekjeve për të realizuar zbatimin e tij, si dhe nisur nga fakti se zbatimi i ligjit do t'i ndihmojë zbatimit të Konventës, sugjerohet që gati të gjitha veprimtaritë që do të zhvillohen për njohjen dhe zbatimin e Konventës, të përdoren edhe për të rritur shkallën e zbatimit të ligjit. Kjo kërkon që veprimtaritë praktike të konceptohen e të realizohen, duke njohur lidhjet e varësitë midis zbatimit të ligjit mjedisor dhe rritjes së zbatimit të Konventës:

- Duke e njohur karakterin shumë kompleks të kësaj situatë, mbështetur edhe në përvojat e pasura të vendeve të përparuara, si dhe në rezultatet fillestare që po arrihen edhe në realitetin tonë, veprimtarinë njohëse e ndërgjegjësuëse, të konceptuara e të realizuara me forma e metoda interesante për publikun, mbeten drejtim i përhershëm i përpjekjeve për forcimin e zbatimit të ligjit mjedisor.
- Drejtim tjetër, me vlera të spikatura, cilësohet informimi i vazhdueshëm dhe tërheqja masive e publikut në veprimtarinë për mbrojtjen e mjedisit. Informimi i publikut, furnizimi i tij i vazhdueshëm me të dhëna për gjendjen e mjedisit, ku përvoja jonë është në fillesat e saj, është premisa për ta bërë aktiv dhe të ndjeshëm publikun, është mekanizmi që e kthen atë nga një masë indiferente, në mbështetës aktiv të përpjekjeve për zbatimin e ligjit. Një publik i angazhuar në veprimtari mjedisore, është faktor i natyrshëm aktiv në zbatimin e ligjit mjedisor.
- Tërheqja e publikut në veprimtarinë e organeve shtetërore e sidomos të atyre vendimmarrëse, rrit trysninë e publikut mbi vendimmarrësit dhe vetëpërgjegjësinë për vendimmarrje sa më të efektshme, zgjeron komunikimet midis organeve shtetërore dhe publikut, ngushton inkoherencat midis tyre. Si një nismë e re, si përpjekje për të zbatuar një parim demokratik, tërheqja e publikut në veprimtarinë vendimmarrëse, ka nevojë për mbështetje e përkrahje, duke përmirësuar aspekte procedurale e administrative të legjislacionit ekzistues, me qëllim që pjesëmarrja e publikut të jetë jo vetëm normë e detyrueshme, por dhe lehtësisht e zbatueshme.
- Rritja e pjesëmarrjes dhe e rolit aktiv të OJF-ve, forcimi i oponencës së tyre ndaj veprimtarisë së organeve shtetërore, veçohet si faktor specifik me ndikim të ndjeshëm në zbatimin e ligjit. Çështja është se, si dukuri e re në shoqërinë tonë, ato meritojnë edhe përkrahjen e mbështetjen e organeve shtetërore, sidomos për t'u krijuar mjedisin e përshtatshëm që ta luajnë rolin e tyre aktiv. Kjo kërkon përcaktimin e rregullave për koordinimet e bashkëveprimet me to, për tërheqjen e tyre sistematike në mjaft veprimtari të organeve shtetërore, për ruajtjen e pavarësisë së tyre etj.
- Mund të duket si një rikthim në të kundërt, por moment me ndikim të drejtpërdrejtë në forcimin e zbatimit të ligjit mjedisor është që publiku të ushtrojë të drejtën për të paditur në gjykatë këdo që nuk zbaton apo shkel ligjin mjedisor që ndot e dëmton mjedisin.
- Si një legjislacion i ri, disi specifik e në mjaft raste me karakter të theksuar teknik e profesional, për të lehtësuar zbatimin e tij, ligji mjedisor ka nevojë ta ketë më të dukshme e lehtësisht të lexueshme mbrojtjen e interesave të publikut. Sigurisht që kjo nuk është një çështje e thjeshtë. Në përgjithësi, ligjet mjedisore janë protektive dhe ndaluese të sjelljeve a të veprimeve dëmtoëse ndaj mjedisit e përbërësve të tij. Në këtë mënyrë, ligji mjedisor synon të përmbysë koncepte e praktika të ngulitura thellë te njerëzit, t'i ndalojë e t'i cilësojë të dënueshme sjellje e veprime që deri tani kanë qenë "të natyrshme", pjesë e rutinës së përditshme. Garantimi i zhvillimeve normale të llojshmërisë biologjike, për shembull, do të ndalojë me ligj e do të ndëshkojë me sanksione edhe shqetësimin e banorëve të pyllit e jo më kapjen apo vrasjen e tyre, të cilat, tradicionalisht, janë quajtur "të drejta të natyrshme" të banorëve të Zonës. Kjo rrethanë kërkon konceptimin e veprimtarive ndërgjegjësuëse si kompensuese e zbutëse të qëndrimeve negative ndaj ligjeve e rregullave që mbrojnë mjedisin.
- Një moment tjetër, ku kërkohet ndërhyrje e gjerë për të siguruar zbatimin e ligjit mjedisor, është veprimtaria e organeve shtetërore. Të gjitha organet shtetërore, qendrore e lokale, janë, drejtpërdrejt a tërthorazi, administruese të mjedisit apo të pjesëve e përbërësve të tij. Veçmas dhe së toku, ato kanë të drejta, detyra e

përgjegjësi ligjore për mjedisin dhe prej tyre kërkohen veprime praktike dhe hartim e miratim aktesh nënligjore që të lehtësojnë zbatimin e ligjit mjedisor në fushat ku ata punojnë në të mirë të mbrojtjes së mjedisit e të zbatimit të kërkesave të Konventës. Dhe, në tërësi, për të gjitha organet shtetërore meriton të gjykohet prej tyre se sa po bëhet drejtim i veçantë pune për to, mjedisi dhe mbrojtja e tij.

KREU III

DETYRA TË ORGANEVE SHTETËRORE

1. Përcaktimi i organeve të angazhuara dhe detyrat e tyre

Edhe me një shikim të shpejtë mund të konstatohet që Konventa detyron të gjithë aktorët e interesuar për mjedisin dhe ndikues në të dhe një plan veprimi për zbatimin e kërkesave të saj, medoemos, është gjithpërfshirës. Me këtë synim, përcaktimi i rolit dhe i përgjegjësiive individuale për organet publike është i domosdoshëm për të identifikuar angazhime konkrete, për racionalizim forcash, për koordinime e bashkërendime dhe, së fundi, për të siguruar sa më shumë rezultate praktike.

Të vlerësuar si të detyruar për të gjeneruar, grumbulluar, përpunuar e publikuar të dhëna dhe informacione për mjedisin, si dhe për tërheqjen e publikut në vendimmarrjet publike për çështje që kanë të bëjnë me mjedisin, do të renditeshin:

- Organet e specializuara në mbrojtjen e mjedisit;
- Institucionet qendrore që me ligj janë ngarkuar të administrojnë pjesë të mjedisit e përbërës të tij, si burime natyrore e pasuri mirerare;
- Organet e qeverisjeve vendore për mjedisin që kanë në juridiksion;
- Institutet kërkimore-shkencore, laboratorët dhe katedrat universitare për të dhënat, informacionet dhe studimet që kryejnë në kuadër të monitorimit të mjedisit.

1/1. Roli i Ministrisë së Mjedisit

Ministria e Mjedisit me organet e strukturat e saj, si drejtoritë dhe sektorët, Agjencitë Rajonale të Mjedisit dhe Inspektorati i Mjedisit janë të angazhuarit kryesorë për zbatimin e kërkesave të Konventës. Pozita dhe roli i tyre janë disaplanëshe. Ministria e Mjedisit është njëkohësisht:

- Realizuese e të gjitha kërkesave të Konventës në organet e strukturat e sistemit të saj;
- Drejtuese dhe organizuese e gjithë punës për zbatimin e kërkesave të Konventës në shkallë vendi;
- Përmbushësja më me peshë e detyrimeve shtetërore që përcakton Konventa ndaj publikut;
- Është e pranishme, gjithashtu, në të gjitha drejtimet e punës e angazhimet që konceptohen e realizohen për zbatimin e Konventës.

Me këtë pozitë e me këto angazhime, Ministria e Mjedisit, më së pari, vendoset në krye të përpjekjeve për të miratuar dhe për të zbatuar sugjerimet e kërkesat e këtij dokumenti.

Sigurisht që roli dhe pozita e saj në zbatimin e Konventës ka edhe shtrirjet e veta kohore dhe, nga gjithë këto angazhime të ngjeshura dhe intensive, këtu do të evidencohen ato që do të përbënin detyrimet e menjëhershme që kanë nevojë të kryhen mundësisht gjatë vitit 2005. Si të tilla, janë përzgjedhur disa nga detyrat që sanksionon legjislacioni i ri mjedisor.

Legjislacioni i ri mjedisor, në të cilin janë integruar maksimalisht kërkesat e Konventës, i ka detajuar detyrat e Ministrisë së Mjedisit dhe të organeve e të

strukturave të saj në të gjitha drejtimet e fushat e veprimtarisë së tyre dhe ka qartësuar detyrat e secilit prej tyre për çdo rast konkret.

Pikërisht me plotësimin e kërkesave që sanksionon ligji për çdo rast konkret, fillojnë angazhimet intensive të Ministrisë, të cilat, si një drejtim shumë i rëndësishëm i përfshirjes së saj për zbatimin e Konventës, fokusohen në hartimin dhe në miratimin e akteve nënligjore që lehtësojnë drejtpërdrejt zbatimin e kërkesave të Konventës.

Që të funksionojnë grumbullimi, përpunimi, publikimi i informacionit mjedisor dhe të plotësohen kërkesat e publikut për ta marrë atë, veç sa është bërë deri tani, nga Ministria e Mjedisit kërkohen:

1. Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore të identifikuara në ligj e që lidhen me informimin. Kështu, në ligj theksohet shprehimisht se:

- Publiku dhe organizatat jofitimprurëse njoftohen për gjendjen e mjedisit nëpërmjet publikimit të të dhënave nga organet shtetërore dhe nga personat fizikë e juridikë, si dhe duke kërkuar të dhëna pranë organeve shtetërore.
- Ministri i Mjedisit përcakton rregullat dhe procedurat për bërjen publike dhe shpërndarjen e të dhënave mjedisore nga organet e mbrojtjes së mjedisit.
- Për të siguruar grumbullimin, përpunimin dhe bërjen publike të të dhënave mjedisore, Ministria e Mjedisit krijon sistemin kombëtar të të dhënave mjedisore.
- Ministria e Mjedisit harton regjistrin kombëtar për shkarkimet në mjedis, për çlirimet dhe transferimet e ndotësve në mjedis, për përdorimin e ujit, të energjisë elektrike dhe të burimeve natyrore e minerare.
- Forma, përmbajtja, afatet dhe mënyra e plotësimit, organi që e administron dhe rregullat e përdorimit e të bërjes publike të regjistrit përcaktohen me urdhër të ministrit të Mjedisit.
- Të dhënat mjedisore që grumbullohen nga Ministria e Mjedisit dhe nga Agjencitë Rajonale, nga ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore dhe organet e qeverisjes vendore kërkohen, hartohen dhe paraqiten sipas rregullave të caktuara nga ministri i Mjedisit.
- Ministria e Mjedisit përgatit çdo 2 vjet raportin kombëtar për gjendjen e mjedisit.
- Rregullat e hollësishme për formën, përmbajtjen dhe për administrimin e dosjes mjedisore, përcaktohen nga ministri i Mjedisit.
- Veprimtaria kontrolluese e Inspektoratit të Mjedisit pasqyrohet në dokumente standarde të miratuara nga ministri i Mjedisit.
- Rregullat e hollësishme për funksionimin e Inspektoratit të Mjedisit përcaktohen nga ministri i Mjedisit.

2. Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore të identifikuara në ligj dhe që lehtësojnë pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje. Kështu, në ligj theksohet shprehimisht se:

- Ministri i Mjedisit miraton rregullat dhe procedurat që realizojnë pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjet e organeve të mjedisit.
- Ministri i Mjedisit përcakton rregullat dhe procedurat e detyrueshme për organet mjedisore, për të realizuar të drejtat e organizatave jofitimprurëse, sidomos:
 - në hartimin e politikave, të strategjive, planeve të zhvillimit, si dhe të programeve për mbrojtjen e mjedisit;
 - në hartimin dhe në zbatimin e planeve të menaxhimit të zonave të ndryshme;
 - në hartimin dhe në zbatimin e programeve të monitorimit;
 - në kontrollet mjedisore;

- në procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe të miratimit të lejes mjedisore;
- në hartimin e projekteve normative mjedisore.
- Ministri i Mjedisit përcakton rregullat dhe procedurat për komunikimin e organeve publike mjedisore me organizatat profesionale të biznesit.

Lidhur me këto detyra të Ministrisë meritojnë të theksohen disa momente:

E para, për të mos krijuar në këtë material listime të gjata e të lodhshme, më sipër u evidencuan vetëm detyrimet që dalin nga ligji bazë “Për mbrojtjen e mjedisit”, ndërkohë që të tjera të tilla janë të specifikuar në ligjet e veçanta dhe mund të merren të gatshme prej andej dhe të përfshihen në objektivat e Ministrisë për vitin 2005 e në vazhdim.

E dyta, krijimi i regjistrave, formatimi dhe përdorimi i tyre, është një nismë e re që do të përdoret për së pari në vendin tonë, si një hap integrues me vendet e përparura në mbrojtjen e mjedisit. Gjithashtu, fjala është për një numër të konsiderueshëm regjistrash, me të cilët do të punohet që nga operatorët e veprimtarive ndotëse, nga organet e qeverisjeve vendore, nga institucionet qendrore etj. sipas detajimeve që janë bërë në ligjet e veçanta, madje, edhe nga disa vendime të Këshillit të Ministrave, si për shembull, Regjistri i Specialistëve të Çertifikuar apo në rregullore e udhëzime të ministrit, si për shembull, Regjistri i Kërkesave të publikut për informacion mjedisor etj.

1/2. Agjencitë Rajonale të Mjedisit

Mbështetur në përvojën e tyre gati 10-vjeçare e në detyrat që kanë përballuar, në legjislacionin e ri mjedisor për të theksohet:

1. Agjencitë Rajonale të Mjedisit janë organe të specializuara për mbrojtjen e mjedisit që varen nga Ministria e Mjedisit dhe organizohen e veprojnë në nivel qarku.
2. Në zbatim të përparësive dhe të objektivave të Ministrisë së Mjedisit, Agjencitë Rajonale:

- a) realizojnë zbatimin e ligjshmërisë për mbrojtjen e mjedisit në nivel vendor;
- b) ndihmojnë organet e pushtetit vendor për administrimin dhe për mbrojtjen e mjedisit që kanë në juridiksion, bashkëpunojnë për hartimin dhe zbatimin e planeve vendore të veprimit për mjedisin;
- c) nxisin përdorimin e teknologjive të pastra dhe futjen e sistemeve të administrimit mjedisor;
- ç) marrin pjesë në procesin e miratimit të lejes dhe të deklaratës mjedisore, duke përmbushur detyrat që përcakton ministri i Mjedisit me udhëzim të veçantë. Japin pëlqimin dhe autorizimin mjedisor për veprimtari vendore;
- d) hartojnë dhe paraqesin për miratim në këshillin e qarkut raportin dyvjeçar të gjendjes së mjedisit të qarkut. Pas miratimit, ky raport i bëhet i ditur publikut nëpërmjet mediave të shkruara dhe elektronike;
- dh) ndërmarrin veprimtari ndërgjegjësuere për mjedisin, bashkëpunojnë me bashkësitë, me organizatat jofitimprurëse mjedisore dhe profesionale të biznesit.

Siç vihet re edhe nga kjo parashtesë e shkurtër, roli, funksionet, kompetencat e detyrat e Agjencive Rajonale të Mjedisit janë të lidhura ngushtë me kërkesat e Konventës, qëndrojnë në një linjë me brendinë dhe synimet e saj. Nga këto që parashikon ligji për to, si më të ngutshmet dhe që do të sillnin përmirësime të dukshme në zbatimin e Konventës në nivel lokal, meritojnë të veçohen:

Sipas ligjit “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” dhe me miratimin dhe me zbatimin në praktikë të udhëzimit të ministrit të Mjedisit “Për veprimtaritë lokale që ndotin mjedisin, të cilat pajisen me autorizim mjedisor nga Agjencitë Rajonale”, këto organizma duhet të detajojnë shumë detyra për komunikimin me komunitetin dhe për tërheqjen e tij në vendimmarrjet në kuadër të procesit të VNM-së e të licensimit. Këto detyra duhet të fillojnë të identifikohen tani dhe gjatë vitit 2005 të fillojë zbatimi i tyre.

Detyra e hartimit të Raportit të Gjendjes së Mjedisit për qarkun ku vepron secila prej tyre, është krejt e re dhe sugjerohet që përgatitjet për të të fillojnë gjatë vitit 2005, me qëllim që hartimi i këtyre raporteve të bashkërendohet me hartimin e raportit të ardhshëm kombëtar. Në kushtet që informacionet e publikuara nga organet shtetërore për mjedisin janë të rralla dhe shumë modeste, kur interesimi i publikut për to le shumë për të dëshiruar, kur edhe OJF-të mjedisore nuk kanë akoma një traditë të kultivuar për kërkimin, grumbullimin dhe shpërndarjen e informacioneve mjedisore, Raporti i Gjendjes së Mjedisit është i vetmi dokument i plotë zyrtar që ndriçon aq sa mundet me informacionin që jep. Hartimi i raporteve të tilla në nivel qarku, me qëllim që çdo qark të ketë të publikuara të dhënat që tregojnë gjendjen e mjedisit që ai ka në juridiksion, do të ishte një hap i rëndësishëm në informimin e komuniteteve lokale për gjendjen e mjedisit ku ata jetojnë.

Për ta përfaqësuar veten tërësisht të angazhuara në zbatimin e Konventës, ato duhet, gjithashtu, të realizojnë veprimtari njohëse e ndërgjegjësuere me komunitetin e me biznesin lokal për Konventën e për legjislacionin e ri mjedisor.

Te ARM-të, OJF-të mjedisore lokale duhet të gjejnë mbështetje dhe përkrahje për të kapërcyer vështirësitë e kuptueshme që hasin, mundësi angazhimesh në veprimtari konkrete për mbrojtjen e mjedisit, hapësira për lidhje e koordinime me simotrat e tyre brenda dhe jashtë vendit.

1/3. Inspektorati i Mjedisit

Me legjislacionin e ri mjedisor, ky organizëm i specializuar kontrolli për mjedisin u riorganizua si strukturë e si veprimtari dhe, aktualisht, e gjen veten zbatues të kërkesave të Konventës në kuadër të veprimtarive kontrolluese, që zhvillon për zbatimin e legjislacionit e të mbrojtjes së mjedisit nga ndotjet e dëmtimet. Ligji i ri “Për mbrojtjen e mjedisit” detajon se Inspektorati i Mjedisit:

- a) ushtron kontroll të vazhdueshëm mbi mjedisin dhe ndaj veprimtarive ndotëse, për të siguruar mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet zbatimit të legjislacionit mjedisor dhe kërkesave të vëna në lejën dhe në deklaratën mjedisore;
- b) kërkon pjesëmarrjen e organeve të qeverisjes vendore, të përfaqësuesve të bashkësisë, të organizatave jofitimprurëse mjedisore dhe të mediave në kontrollet mbi veprimtaritë ndotëse;
- c) krijon dosjen mjedisore për çdo veprimtari të pajisur me leje mjedisore;
- ç) ndihmon personat fizikë e juridikë për të realizuar vetëmonitorimin, verifikimin dhe zbatimin e sistemeve të integruara të administrimit dhe kontrollon zbatimin e tyre;
- d) urdhëron masa të detyrueshme për zbatim për përmirësimin e gjendjes së mjedisit, për pakësimin e ndotjes dhe të dëmtimit të mjedisit;
- dh) vë në dijeni rregullisht pushtetin vendor për gjendjen e mjedisit, për veprimtaritë, projektet dhe instalimet e miratuara, sipas kërkesave të këtij ligji;
- e) kontrollon regjistrat e ndotësve, rregulloret e brendshme, teknike e teknologjike, dhe dokumentet e tjera që lidhen me veprimtarinë dhe me rrezikun e ndotjes;

- ë) vendos sanksione, sipas këtij ligji dhe akteve të tjera ligjore, që mbrojnë përbërës të veçantë të mjedisit;
- f) bën publike rezultatet për çdo kontroll të ushtruar.

Siç mund të vërehet, nga detyrat e tij funksionale Inspektorati detyrohet me zbatimin e kërkesave të Konventës në dy drejtime: për informimin dhe për tërheqjen e publikut dhe në të dyja këto drejtime ai ka pozitë e rol të veçantë. Kështu, ai është i aftë të informojë:

- Për shkallën e zbatimit të legjislacionit në nivel vendi, për çdo zonë e deri për çdo veprimtari të pajisur me leje mjedisore;
- Për shpeshinë e shkeljeve e të moszbatimit të ligjit;
- Për ekzistencën e veprimtarive të papajisura me leje mjedisore, të veprimtarive klandestine dhe pirate;
- Për veprimtaritë që ndotin konkretisht, si dhe për llojin dhe nivelin e ndotjes që shkaktojnë.

Po në kuadër të informimit, sidomos të komuniteteve lokale, ai është i detyruar të publikojë:

- Planet vjetore të inspektimeve mjedisore.
- Raportet e hartuara pas çdo inspektimi, ku jepen gjendja e operatorëve të kontrolluar, zbatimi prej tyre i kërkesave ligjore dhe i kushteve të lejes mjedisore, ndotjet e dëmtimet e konstatuara, masat e urdhëruara për përmirësimin e situatës dhe ndëshkimet e akorduara.

Me këto informime Inspektorati jo thjesht zgjeron rrethin e çështjeve për të cilat ka nevojë të informohet publiku, por plotëson kuadrin me informime krejt të veçanta e shumë të nevojshme për publikun e ndikuar e në tërësi për komunitetin lokal, të cilët duan të dinë ndotjen e ujit, të ajrit e të tokës të shkaktuara nga veprimtaritë që operojnë në mjediset e territoret ku ata jetojnë.

Lidhur me tërheqjen e publikut dhe të OJF-ve, Inspektorati ka, gjithashtu, një pozicion të veçantë. Duke i ftuar ata të marrin pjesë në veprimtaritë e tij kontrolluese dhe të asistojnë në kontrollet mjedisore të grupeve të inspektimit, ai çel një përvojë të re në punën e organeve mjedisore, krijon një shans real për rritje të ndjeshme të rolit të publikut në mbrojtje të mjedisit.

Për të promovuar këto drejtime interesante të punës së tij dhe njëherësh të dëshmojë rol aktiv në zbatimin e Konventës, sugjerohet që gjatë vitit 2005 Inspektorati:

- Të hartojë dhe të publikojë planin e kontrolleve mjedisore në shkallë vendi dhe në nivel lokal;
- Të organizojë disa grupe kontrolli me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të komunitetit e të OJF-ve dhe, të paktën, dy prej tyre të organizohen e të zhvillohen në mënyrë të tillë që të shërbejnë edhe si trainime e fitim përvojë për të gjithë pjesëmarrësit.
- Të hartojë dhe të zbatojë 2-3 projekte pilot, që t'i shërbejnë realizimit të detyrës së tij të specifikuar në gërmën „ç“, të përmendur më sipër, sipas së cilës Inspektorati ndihmon personat fizikë e juridikë për të realizuar vetëmonitorimin, verifikimin dhe zbatimin e sistemeve të integruara të administrimit, për të cilat mungojnë njohuritë dhe përvojat praktike.
- Në qendër dhe në nivel qarqesh, të vendosen numërat telefonikë (telefoni jeshil)

nëpërmjet të cilëve publiku, OJF-të dhe çdo i interesuar të paraqesin ankesat, denoncimet, sugjerimet e vërejtjet që kanë për administrimin dhe mbrojtjen e mjedisit, për ndotjet dhe dëmtimet që konstatojnë. Telefon i tille mund të funksionojë edhe ne organet e qeverisjes vendore per problemet mjedisore ne territoret qe administrojne.

Insistohet në këto angazhime, sepse ato do të ndihmojnë në promovimin e veprimtarive krejt të reja që duhet të fillojnë të zbatohen sa më shpejt për të sjellë përmirësime të dukshme në mbrojtjen e mjedisit dhe një terren shumë të favorshëm për zbatimin e Konventës.

2. Ministrinë e Linjës me strukturat përkatëse

Është lehtësisht e kuptueshme që zbatimi tërësor i kërkesave të Konventës në nivel qendror do të ishte i mangët dhe larg maksimumit të synuar nëse në të nuk janë të angazhuara institucionet qendrore. Për fazën konkrete të procesit zbatues, angazhimi i këtyre institucioneve përbën synim parësor, është një hap i ri me shumë peshë në plotësimin e kuadrit të të gjithë të detyruarve në zbatimin e Konventës, nga i cili pritet jo thjesht një zgjerim horizontal i organeve shtetërore të angazhuara, por rezultate të dukshme pozitive në zbatimin e Konventës.

Duhet pohuar që në fillim se gati në të gjitha veprimtaritë e organizuara deri tani për zbatimin e Konventës, aktivizimi dhe ndihmesa e ministrive ka qenë e zbehtë; ndërkohë që ka munguar edhe programimi i angazhimeve të tyre dhe i bashkëpunimeve me to. Në këtë kuptim, kjo është përpjekja e parë serioze për të programuar dhe për të realizuar praktikisht rolet dhe kontributet e institucioneve qendrore në zbatimin e Konventës. Ky dokument e ka ndër synimet e tij më të rëndësishme ndryshimin rrënjësor të kësaj gjendjeje dhe rritjen e ndjeshme të rolit të tyre si faktor me shumë peshë në zbatimin e kërkesave të Konventës.

Në konceptimin e detyrimeve të ministrive në veprimtaritë zbatuese të Konventës, është e nevojshme të mbahen parasysh disa të vërteta të thjeshta:

Roli, pozita dhe angazhimet e ministrive në zbatimin e kërkesave të Konventës, në raport me Ministrinë e Mjedisit, sigurisht që janë detyësore për nga vëllimi, ndërkohë që nga përmbajtja dhe kontributet faktike janë të pazëvendësueshme. Nuk mund të mendohet dhe të funksionojë praktikisht zbatimi tërësor i kërkesave të Konventës në nivel kombëtar, pa rolet dhe kontributet e ministrive të linjës.

Gjithashtu, angazhimet dhe kontributet e ministrive në zbatimin e kërkesave të Konventës janë në raport të drejtë me angazhimet dhe me kontributet e tyre konkrete në mbrojtjen e mjedisit, madje, janë pjesë përbërëse e tyre.

Identifikimi i detyrimeve të institucioneve qendrore, si dhe i detyrave konkrete për ministri të veçanta, është i lidhur ngushtë me funksionet dhe kompetencat që u cakton atyre legjislativi mjedisor, si dhe me fushën konkrete të veprimtarisë së secilës. Në këtë këndvështrim, detyrimet e tyre janë pjesë përbërëse e detyrave të tyre funksionale dhe nuk ka nevojë të dalin jashtë këtyre kufijve ligjorë apo të gjykohen si një barrë suplementare në dobi të mjedisit.

Angazhimet e ministrive të linjës në procesin e zbatimit të Konventës janë pjesë e rëndësishme e përpjekjeve të tyre për zbatimin e kërkesave që u ka vendosur atyre legjislativoni i ri mjedisor, si dhe Konventa, e ratifikuar nga Kuvendi me ligj të veçantë.

Në ligjin “Për mbrojtjen e mjedisit”, lidhur me këtë çështje theksohen dy momente të rëndësishme: E para, detyrat e tyre në fushën e mjedisit janë të përcaktuara me ligj dhe e dyta, angazhimet e tyre për mbrojtjen e mjedisit realizohen nëpërmjet zbatimit të funksioneve të tyre. Konkretisht, në nenin 74 të këtij ligji theksohet se institucionet qendrore kanë për detyrë:

- a) të integrojnë mbrojtjen e mjedisit në politikën e strategjitë sektoriale, duke marrë, përpara miratimit të tyre, edhe mendimin e Ministrisë së Mjedisit;
- b) të bashkëpunojnë me Ministrinë e Mjedisit për hartimin dhe për zbatimin e kuadrit ligjor mjedisor, për futjen e teknologjive të pastra dhe më të mira të mundshme, për hartimin dhe zbatimin e strategjisë së mjedisit e të planit përkatës të veprimit për rehabilitimin e zonave të ndotura dhe të dëmtuara dhe për shkëmbimin e të dhënave për gjendjen e mjedisit;
- c) të publikojnë të dhënat që kanë për mjedisin;
- ç) të bashkëpunojnë me organet e qeverisjes vendore për zgjidhjen e problemeve të mjedisit;
- d) të organizojnë zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit për personat juridikë në varësi të tyre.

Ndërsa në nenin 64 theksohet: Organet shtetërore, qendrore dhe vendore, si administruese të ligjshme të pjesëve dhe përbërësve të ndryshëm të mjedisit, realizojnë mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet zbatimit të këtij funksioni.

Nga kjo parashtrësë del fare qartë se institucionet qendrore janë të detyruara me ligj të zbatojnë kërkesat e Konventës, që kanë të bëjnë me zbatimin në praktikë të të drejtës së publikut për t’u informuar për gjendjen e mjedisit, si dhe të së drejtës së tij për të marrë pjesë në vendimmarrjet shtetërore për çështje të mjedisit.

Për detyrat e tyre lidhur me informimin e publikut, është rasti të nënvizohet fakti shumë domethënës se qysh nga dalja e ligjit nr. 8053, datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, këto institucione kanë formuar përvojën vetjake në zbatimin e detyrimeve për të publikuar e për t’i dhënë informacione publikut. Edhe pse niveli dhe cilësitë e kësaj përvoje janë të ndryshme në ministri të ndryshme, informimi mjedisor që kërkohet nga Konventa, është pjesë e përvojës që tashmë po konsolidon secila ministri. Në këtë kuptim, për informacionin mjedisor, që duhet të japin ministrinë e linjës, ato ecin në një terren përgjithësisht të njohur. Akoma më konkretisht, kërkesat e ligjit, që u përmend, janë themelore dhe tërësisht të zbatueshme edhe për informacionin mjedisor, i cili, në çdo rast, është thjesht një pjesë e informacioneve që duhet të japë organi shtetëror.

Siç dihet, sipas sektorëve që mbulojnë, ministrinë e linjës disponojnë tri kategori informacioni mjedisor:

- Informacion që gjenerohet gjatë realizimit të funksioneve të tyre ligjore, që lidhen me mjedisin apo që kanë ndikime në mjedis;
- Informacion mjedisor që grumbullohet në strukturat e sistemit të secilës prej tyre;

- Informacion që krijohet nga institutet në varësi të tyre, të cilat, përgjithësisht, janë të angazhuara me detyra konkrete në realizimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit.

Sigurisht që për secilën kategori të informacioneve, kërkohen përgatitje të veçanta, qoftë për ta grumbulluar, përpunuar e publikuar informacionin, qoftë për ta bërë të gatshëm e për ta vënë në shërbim të publikut sa herë që ai e kërkon. Dhe për secilën ministri të linjës kërkohet të ndërtojë dhe të riazhornojë metodikat e saj për punën që bëhet me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e shpërndarjen e informacionit nga strukturat e saj.

Gjithësesi, sa për të ilustruar dhe për të dhënë një shembull të radhës së punës se nga duhet nisur, sugjerohet që ministritë e linjës të konkretizojnë të dhënat e informacionet mjedisore për secilën nga kategoritë e informacionit mjedisor, që sigurojnë gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre ligjore. Të tilla do të ishin:

- Listimi i dokumenteve sektoriale si programe, plane, strategji dhe publikimi i saj me qëllim që publiku të njihet dhe të orientohet për të kërkuar ato që i nevojiten
- Listimi i akteve ligjore e nënligjore të fushës që mbulon
- Pjesa që veçohet çdo vit për mjedisin nga buxheti që i caktohet ministrisë
- Listimi i projekteve me karakter mjedisor apo me ndikime në mjedis që menaxhon ministria apo që zbatohen në sektorët që ajo mbulon
- Listimi i vendimmarrjeve për çështje të mjedisit që do të realizohen prej strukturave dhe organeve të saj vendimmarrëse
- Listimi i veprimtarive të ndryshme që kërkojnë të licensohen, si dhe ato që janë licensuara nga strukturat e ministrisë
- Të dhënat vjetore të regjistrit të kërkesave për informacion mjedisor.

Është e rëndësishme që këto dokumente indikative të hidhen sistematikisht në rrjetet dhe sistemet elektronike që funksionojnë për secilën ministri ose në programet dhe sistemet e profilizuara për mjedisin, të cilat është plotësisht e mundur të ndërtohen e të funksionojnë me nismën dhe nën kujdesin e Ministrisë së Mjedisit.

Këto do të përbënin një bazë të mirë fillestare për të hedhur hapat e tjera të domosdoshme në shërbim të publikut dhe do të orientonin edhe publikun e OJF-të për të kërkuar informacione e të dhëna që u nevojiten për t'u njohur me gjendjen e mjedisit, me politikat e programet sektoriale për administrimin dhe mbrojtjen e tij etj.

Nisur nga fakti që ato janë të vetmet organe që grumbullojnë informacione dhe të dhëna në shkallë vendi që i përkasin sektorit që ato mbulojnë; që ato kanë detyrimin ligjor që këto informacione t'i bëjnë publike, po ashtu siç kanë detyrimin që këto informacione t'i përcjellin në Ministrinë e Mjedisit, e cila i përdor për të hartuar raportin e gjendjes së mjedisit, është e kuptueshme se këto detyrime nuk mund të plotësohen pa u shoqëruar edhe me përmirësime institucionale, strukturore e organizative të secilës prej tyre. Pikërisht për këto arsye dhe në tërësi për të mundësuar realizimin e këtyre detyrimeve e për të përfutur një pozicion më të angazhuar ndaj mjedisit, në ligjin "Për mbrojtjen e mjedisit" sanksionohet ngritja e organizmave të veçanta që do të merren me realizimin konkret të detyrimeve të ministrive për mjedisin. Konkretisht, në nenin 75 të këtij ligji, theksohet:

1. Në ministritë e linjës dhe në organet e qeverisjes vendore ngrihen strukturat e mbrojtjes së mjedisit.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrive të linjës dhe të ministrit të Mjedisit, miraton organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e këtyre organizmave.

E vërteta është se disa ministri ka kohë që në strukturat e veta kanë nga një organizëm modest apo qoftë edhe një specialist të ngarkuar për çështje të mjedisit, siç është e vërtetë edhe ana tjetër e çështjes që në ndonjë ministri ky organizëm është suprimuar si i panevojshëm.

Për të dëshmuar përmirësim të dukshëm në angazhimet e tyre me mjedisin e në veçanti me zbatimin e kërkesave të Konventës, duke filluar që nga viti 2005 e në vazhdim, për ministrinë e linjës sugjerohet:

- Të zbatojnë kërkesën ligjore dhe të ngrenë organizmat mjedisore, brenda strukturave të tyre
- Të hartojnë së bashku me Ministrinë e Mjedisit projektvendimin e Këshillit të Ministrave që përcakton detyrat, funksionet, përbërjen etj. të këtyre organizmave
- Të hartojnë ose të riazhurnojnë rregulloret e brendshme për zbatimin e thjeshtë dhe operativ të detyrave konkrete të këtyre organizmave
- Të hartojnë metodikat, rregullat e procedurat për publikimin e informacioneve mjedisore që disponojnë
- Të caktojnë pikën e kontaktit dhe personin përgjegjës që do t'u përgjigjet kërkesave të publikut, OJF-ve a personave të interesuar për informacion mjedisor dhe që mban lidhje me pikën fokale të Ministrisë së Mjedisit
- Të hartojnë dhe të zbatojnë programet për trainimin e tyre në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit
- Të krijojnë dhe të administrojnë regjistrat e kërkesave të publikut për informacion mjedisor

Nëse këto do të ishin një përpjekje për të përcaktuar disa nga detyrimet e ministrive si institucione qendrore, hapi i dytë drejt një konkretizimi më të detajuar do të ishte përpjekja për të evidencuar detyrimet e veçanta të disa ministrive apo të ministrive të linjës, siç është bërë zakon të thirren rëndom në praktikë.

2/1 Ministria e Shëndetësisë

Duke i marrë të mirënjohura lidhjet e varësitë e shumëllojta midis shëndetit dhe mjedisit, pozicionin e veçantë të strukturave të kësaj ministrie për higjienën, për ujin e pijshëm, për mbetjet spitalore, për monitorimin e ujit, të ajrit etj. ajo ka “monopolin”, në nivel kombëtar dhe rajonal, për të dhëna dhe informacione mjedisore që i përkasin fushës së shëndetit dhe të mjedisit, për të cilat publiku është i ndjeshëm dhe opinioni duhet informuar në vijimësi.

Pas hartimit, miratimit dhe vënies në zbatim të Planit Kombëtar të Veprimit për Shëndetin dhe Mjedisin, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 270, datë 10/06/1999 ka një situatë më të mirë dokumentare dhe organizative që mundëson realizimin e detyrimeve të organeve dhe strukturave të kësaj ministrie në kuadër të Konventës së Aarhusit.

Megjithatë, në përgatitjen dhe në publikimin e informacioneve për shëndetin dhe mjedisin, si dhe për tërheqjen e publikut në vendimmarrjet e kësaj fushe, ka disa momente që meritojnë vëmendje për strukturat e Ministrisë së Shëndetësisë.

Angazhimet praktike të tyre për të përmbushur detyrat që u burojnë nga Konventa, parakërkojnë të qartësohen përmbajtja dhe vëllimi i konceptit “informim për çështje të shëndetit e të mjedisit”; kuptimet e veçanta të konceptit “publik”; identifikimi i vendimmarrjeve, ku mund të rritet transparenca dhe njoftimi i publikut etj. Për të lehtësuar realizimet praktike për këtë çështje, sugjerohen të mbahen parasysh Konventa e dokumente të tjera ndërkombëtare që i kanë trajtuar këto çështje:

- Rezoluta që shoqëron miratimin e Konventës së Aarhusit tërthorazi thekson aplikimin e Konventës në procesin e NEHAP-it (Plani Kombëtar i Veprimit për Mjedisin dhe Shëndetin).

- Udhëzimet e dhëna nga Komiteti Evropian për Mjedisin dhe Shëndetin NEHAP Task Force, përmbajnë rekomandime dhe sugjerime në lidhje me pjesëmarrjen dhe konsultimin me publikun. Kjo lidhet edhe me udhëzimet e Konferencës së Sofies në tetor 1995, mbi të Drejtën për Informacion dhe Pjesëmarrje Publike në Vendimmarrjen për problemet e mjedisit.

- Konsultimi i WHO/EURO (1997) mbi informacionin e publikut dhe pjesëmarrjen në problemet e shëndetit mjedisor shqyrtoi situatën në vendet evropiane dhe përgatiti një sëri rekomandimesh se si të adresohen problemet e informimit dhe të pjesëmarrjes së publikut.

- Konferenca e Londrës siguron mundësi për të ofruar disa drejtime për zbatimin e Konventës, e veçanërisht përsa u përket problemeve të shëndetit. Konventa e Aarhusit, një prodhim i procesit “Mjedisi për Evropën”, u zhvillua si Konventë mjedisore. Problemet e shëndetit nuk janë në qendër të negociatave të saj. Si pjesë e procesit për forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar midis sektorëve të mjedisit dhe shëndetit, Konferenca e Londrës mund të ndihmojë në rritjen e theksit për problemet e shëndetit në Konventë.

- Shëndeti referohet në shumë pjesë të Konventës. Artikulli 1, që vendos objektivat e Konventës, i referohet “të drejtës së çdo personi në gjeneratat prezente dhe gjeneratat e ardhshme që të jetojë në një mjedis të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqënien”.

- Studimi i kryer nga Qendra Rajonale e Mjedisit për Evropën Qendrore dhe Lindore (REC) tregon se, ndërsa disa vende i kanë dhënë mundësi publikut me pjesëmarrje në procesin e NEHAP-it, në disa të tjera ka pak ose aspak përfshirje të publikut. Në rastin e LEHAP-eve (ose iniciativave të tilla si Axhenda Lokale 21 ose Qytete të Shëndetshme), duket se pjesëmarrja në to është disi e dukshme. Megjithatë vëzhgimi i REC-ut mbulon një numër të vogël vendesh dhe që është kryer në një stad të hershëm të proceseve NEHAP/LEHAP, rezultatet tregojnë se ka tepër vend për përmirësime. Këtë mund të shprehim edhe për vendin tonë ku ka shumë vend për përmirësime.

- Karta Evropiane për Mjedisin dhe Shëndetin, e miratuar në Konferencën e Parë Evropiane të Ministrave të Mjedisit dhe të Shëndetit e mbajtur në Frankfurt 1989, e njeh pjesëmarrjen e publikut si një element të rëndësishëm në kontekstin e problemeve të mjedisit dhe të shëndetit.

- Në Konferencën e Dytë Evropiane të Ministrave të Mjedisit dhe të Shëndetit, të mbajtur në Helsinki në 1994, kjo u reflektua në fokusimin që u bë në Planin e

Veprimet për Mjedisin dhe Shëndetin për Rajonin Evropian, me qëllim forcimin e përfshirjes së publikut dhe organizatave jo qeveritare (OJF-ve) në vendimmarrjen për shëndetin mjedisor.

- Pjesëmarrja publike, gjithashtu, ka dalë si një përparësi edhe në forume të tjera dhe më e dukshme në procesin “Mjedisi për Evropën”, në Konferencën e Tretë Ministeriale “Mjedisi për Evropën”, mbajtur në Sofie, në tetor 1995.

- Konferenca e Tretë e Ministrave të Mjedisit dhe të Shëndetit, e mbajtur në Londër më 1999, natyrisht, krijon një mundësi, duke ofruar disa drejtime në aplikimin e Konventës, veçanërisht përsa u përket çështjeve të shëndetit, të cilat duhet të merren në konsideratë në një stad të mëvonshëm.

Gjithashtu, në kuadër të zbatimit të Konventës në lidhje me problemet e shëndetit, është e arsyeshme që të pranohet një përkufizim për shëndetin.

Si i tillë, mund të shërbente “shëndeti mjedisor” i përdorur nga Zyra Rajonale e OBSH-së për Evropën (WHO/EURO). Ky përkufizim përfshin drejtpërdrejt efektet patologjike të kimikateve, radiacionit dhe disa agjentëve biologjikë, si dhe efektet në shëndet dhe në mirëqenie nga mjedisi fizik, psikologjik, social dhe estetik që përfshin vendbanimet, zhvillimin urban, përdorimin e tokës dhe transportin.

Për kushtet e vendit tonë, sugjerohet që në vëllimin e informacionit për shëndetin dhe mjedisin të përfshihen edhe aktivitetet që lidhen me përpunimin e ushqimit dhe produktet farmaceutike, të cilat janë fusha që kanë ndikim të madh në shëndetin publik.

Informacioni është mëse i nevojshëm për punëtorët, të cilët mund të ekspozohen ndaj mbetjeve të rrezikshme të veçanta në vendin e punës. Në këtë rast marrëveshjet kolektive ndërmjet punonjësve dhe manaxhuesve që përfshijnë klauzola që kanë të bëjnë me informacionin, duke e trajtuar informimin si një të drejtë të punonjësve, konsiderohen si zgjidhje të efektshme.

Komunikimi me publikun për mjedisin dhe shëndetin nuk është një proces i thjeshtë dhe që funksionon vetëm me një drejtim, prandaj shtrohet me forcë që institucionet shëndetësore duhet të marrin nën kontroll këtë proces komunikimi, duke mbajtur parasysh, që:

- Auditimi mjedisor i aktiviteteve dhe i kompanive, nëpërmjet skemave të tilla, si Skema e Auditimit dhe Menaxhimit Mjedisor, analizimi i plotë i ciklit jetësor të produkteve, mund të ndihmojë në rritjen e ndërgjegjësimit, jo vetëm te prodhuesit, por edhe te konsumatorët, nga ndikimi i mjedisit në aktivitetin e tyre. Skema të tilla duhet të bëhen të detyrueshme, sa më shumë të jetë e mundur, për të siguruar një mbulim të gjithanshëm dhe për të vendosur një “nivel fillestar”, dhe të shtrihen gjithmonë e më tepër sa të mbulojnë ndikimin e shëndetit.

- Regjistrat e shkarkimeve dhe të transferimeve të substancave të ndryshme (PRTR), nëpërmjet raportimit për shkarkimet dhe për transferimet e substancave specifike nga aktivitete potencialisht ndotëse, kanë provuar të jenë tepër efektive dhe relativisht me

kosto të ulët në drejtim të mbledhjes së informacionit mjedisor nga sektorët privatë dhe të vendosjes së tyre në dispozicion të publikut.

- Mekanizmat e raportimit të të dhënave shëndetësore janë, gjithashtu, të nevojshme për të siguruar një bazë për kërkime në lidhje rastësore midis problemeve të shëndetit dhe faktorëve mjedisorë. Hetimi më i mirë i sëmundjeve dhe monitorimi i treguesve mjedisorë, që mund të jenë të lidhur me shëndetin, duke përfshirë këtu edhe shëndetin në punë, janë mëse të nevojshme. Regjistrat për vetitë e substancave me kërcënim për shëndetin, të tilla si Regjistrat Ndërkombëtarë të Kimikateve Toksike, janë me rëndësi të madhe.

- Duhet të vendosen mekanizmat (atje ku ato nuk ekzistojnë), si dhe të forcohen dhe të bëhen më të gjithanshme. Në rastin e PRTR-eve, kuadri ligjor i ofruar nga Konventa e Aarhusit, e kombinuar me përvojën e konsiderueshme të akumuluar në këtë fushë nga organizma të tilla, si Organizata për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik (OECD) në kuadrin e Programit Ndërorrganizativ për Menaxhimin e Kimikateve, duhet të përdoren për t'i dhënë një nxitje përdorimit të PRTR-eve edhe në vendin tonë.

- Lidhja midis këtyre sistemeve të ndryshme të informacionit duhet të forcohet, ndërkohë që ato duhet të rritin në mënyrë të dukshme dobinë e tyre.

- Duhet të mbështeten nismat dhe masat për rritjen e sistemeve për mbledhjen e të dhënave dhe harmonizimin e tyre në shkallë rajoni, për të mundësuar krahasueshmëri më të madhe të të dhënave.

- Informacioni duhet të jetë disponibël për publikun në mënyrë të tillë që të përdoret me lehtësi prej tij. Kjo do të përfshijë interpretimin, strukturimin dhe analizimin e informacionit sipas nevojave dhe interesave të publikut. Gjendja e ëeb-siteve në internet, që lidh adresarë për shkarkimet në mjedis (në formën e sistemit gjeografik të informacionit) me adresarë të ndikimit të shëndetit nga kimikatet toksike, ka treguar se ka një rritje të konsiderueshme të përdorimit të informacionit nga publiku, kur informacioni është në një formë elektronike të lehtë për t'u përdorur.

- Komunikimi me publikun dhe shpërndarja aktive e informacionit janë elementë thelbësorë në zhvillimin dhe zbatimin e politikave të mjedisit dhe të shëndetit. Një publik i mirinformuar është më i aftë për të marrë pjesë efektivisht në vendimmarrje dhe ka mundësi më të mëdha të mbështetë politikat e projektuara për të krijuar një mjedis të shëndetshëm.

- Etiketimi i produkteve të ndryshme është një mënyrë shumë e rëndësishme për të siguruar informacion për publikun. Ky informacion mund të jetë neutral (duke siguruar, për shembull, listën e emrave të përbërësve të produktit) ose vlerësues (duke njoftuar se produkti mund të dëmtojë shëndetin apo mjedisin). Është thelbësore që publiku të informohet e të ketë një informacion të mjaftueshëm, në një mënyrë të përshtatshme, t'u krijojë mundësi atyre që të bëjnë zgjedhjet me përfitim për shëndetin e tyre dhe për mjedisin gjithashtu. Duhet të vendosen kriteret minimale për etiketimin në mënyrë detyruese. Përmbajtja e etiketimeve duhet të jetë konsistente, kështu që konsumatori të marrë një tablo të qartë të zbatimit të shëndetit dhe të mjedisit duke konsumuar këtë produkt. Kriteret e etiketimit duhet të reflektojnë

shqetësimet e publikut, si për shembull, të dhëna për produktet që përmbajnë apo kanë origjinë nga materiale gjenetike të modifikuara.

- Komunikimi i rrezikut dhe i mbetjeve të rrezikshme për shëndetin dhe mjedisin është një nga fushat më sensitive të komunikimit me publikun. Kur ky informacion sigurohet në kohën e duhur, ai do të ndikojë në reduktimin apo në eliminimin e kërcënimeve për shëndetin apo për mjedisin, veçanërisht për publikun që preket potencialisht.

- Komunikimi i rrezikut duhet të ketë qëllim që të përçojë te publiku, potencialisht i prekur, informacionin me objektiv në nivele reale të rrezikut, ndaj të cilit ato janë apo mund të ekspozohen.

- Nëse autoritetet publike fshehin informacionin lidhur me rrezikun apo mbetjet nga aksidentet, aktivitetet e ndryshme apo produktet, kjo mund të shpjerë në një rreth vicioz të komunikimit të dobët dhe në fshehje të së vërtetës. Kështu që publiku nuk mund t'u besojë më informacioneve të dala nga burime zyrtare. Autoritetet publike janë mandej të përforcuara në pikëpamjet e tyre që publiku është irracional, kështu që janë më pak të prirur për të ndarë informacionin për mbetjet e rrezikshme për arsye të frikës e mandej do të ketë një superreaksion.

- Nëse rreziqet do të zmadhohen, kjo mund të shkaktojë stres psikologjik që në vetvete mund të krijojë një ndikim të madh e të pamatshëm shëndetësor në publik, duke shkaktuar njëkohësisht alarm. Në anën tjetër, dukuria e induktimit të informacionit për problemet e shëndetit nuk duhet kurrë të citohet si bazë për ruajtjen e informacionit nga publiku, atje ku ai informacion mund të krijojë mundësi për ndërmarjen e aksioneve të përshtatshme parandaluese për të zbutur kërcënimet e mëdha për shëndetin ose mjedisin.

- Media, gjithashtu, ka një rol shumë të rëndësishëm në komunikimin dhe në informimin për shëndetin dhe mjedisin. Kështu që, publiku që dëshiron të marrë mesazhet duhet të punojë me median në një mënyrë aktive, duke shmangur sekretin dhe duke inkurajuar kredibilitetin. Të dyja palët duhet të jenë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë e tyre dhe për nevojën për komunikim të hapur dhe profesionalizëm me njëri-tjetrin, veçanërisht gjatë emergjencave (ku shpejtësia dhe parandalimi duhet të veprojnë menjëherë).

- Si aktorë të tjerë në komunikimin e informacionit të shëndetit mjedisor, do të veçoheshin mjekët, specialistët e shëndetit mjedisor, institucionet e edukimit, bizneset e ndryshme, unionet tregtare dhe OJF-të. Këta aktorë duhet të bashkohen me specialistët e informacionit në ministritë në të gjithë Rrjetin për Komunikim të Shëndetit në Rajonin Evropian. Ky rrjet i ndërtuar nga OBSH-ja në Rajonin Evropian do të mbështetë zhvillimin e aftësive, të shpërndajë informacionin dhe praktika të mira dhe do të vendosë një kod të etikës dhe udhëzime profesionale.

Institucionet e edukimit në fushën e shëndetit janë burimi kryesor i informacionit për problemet e mjedisit dhe të shëndetit, prandaj ato duhet të nxiten që të përfshijnë tema të shëndetit mjedisor në kurrikulat e tyre. Kjo do të përmirësojë cilësinë e inputeve të publikut në vendimmarrjen afatshkurtër dhe afatmesme, por do të ketë përfitime afatgjata për shëndetin mjedisor në të ardhmen, duke investuar te brezat e rinj.

2/2. Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit

Administruese ligjore e tokës bujqësore, e pyjeve, kullotave, livadheve, drufrutorëve, farërave dhe fidanëve, peshkimit dhe akuakulturës, faunës e florës dhe e ushqimit të popullsisë e të kafshëve shtëpiake, Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit, strukturat dhe organizmat e saj qendrore dhe rajonale, kanë rol parësor dhe të pazëvendësueshëm në zbatimin e kërkesave të Konventës së Aarhusit në këto fusha.

Angazhimet e tyre janë të vlefshme kryesisht për informimin e publikut dhe për të lehtësuar tërheqjen e tij në vendimmarrjet shtetërore që i përkasin fushës së bujqësisë dhe ushqimit.

Është për t'u theksuar në mënyrë të veçantë se Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit ka prej kohësh struktura të kompletuara e me përvojë, tërësisht të afta t'u përgjigjen detyrave që burojnë nga Konventa e Aarhusit. Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe Kullotave me drejtoritë e saj rajonale, me administratat e zonave të mbrojtura dhe me policinë e shërbimit pyjor; Drejtoria e Përgjithshme e Peshkimit; një varg institutesh kërkimore shkencore, si ai i tokave, i pyjeve, i peshkimit, i perimeve e patateve etj. përbëjnë një ansambël institucional të lidhur ngushtësisht me zbatimin e Konventës.

Nga ana tjetër, me punën e bërë deri tani, si për hartimin e politikave e të strategjive, për plotësimin e legjislacionit (legjislacioni i ri i këtyre fushave rezulton nga më të kompletuarit), me zbatimin e disa projekteve madhore për ujitjen, për pyjet, për rehabilitimin e sistemeve kullues, për peshkimin etj., ajo po ndërton gjithë infrastrukturën e nevojshme për t'u përgjigjur me nivel edhe detyrave që burojnë nga Konventa.

Kështu që, krahas Ministrisë së Mjedisit, Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit me strukturat dhe organizmat e saj qendrore dhe rajonale, renditet e para në përgatitjen dhe shpërndarjen e informacionit për llojshmërinë biologjike, për gjendjen dhe përdorimin e tokës, për plehrat kimike, për pesticidet etj.

Duke e vlerësuar atë si një magazinë të madhe e të sistemuar për llojet dhe sasinë e të dhënave dhe të informacionit që disponon në nivel qendror dhe lokal, prej strukturave të saj kërkohet:

- Listimi, formatimi dhe komunikimi elektronik i llojeve të ndryshme të informacioneve që disponohen për mjedisin, duke e specifikuar atë sipas fushave të veprimtarisë që mbulojnë strukturat e saj, me qëllim që publiku, OJF-të, e kushdo i interesuar, të marrë dijeni se në këto organizma disponohen dokumente, të dhëna e informacione të ndryshme, që mund të kërkohen prej tyre;
- Freskimi i metodikave për përpunimin dhe për publikimin në vijimësi të të dhënave dhe informacioneve;
- Caktimi i pikave të kontaktit në secilën strukturë, në nivel qendror dhe lokal, me punonjësit aktualë dhe pa shtuar organikat, të cilët do të përgjigjen për shpërndarjen e informacioneve dhe për plotësimin e kërkesave të publikut për to;
- Miratimi i rregulloreve për organizimin dhe për funksionimin e organizmave mjedisore e të pikave fokale, që do të funksionojnë brenda tyre, duke trajtuar edhe lidhjet e tyre me Ministrinë e Mjedisit;

- Krijimi dhe administrimi i regjistrave të kërkesave të publikut për informacion mjedisor;
- Miratimi i rregullave dhe i procedurave që krijojnë lehtësitë e nevojshme për pjesëmarrjen e publikut e të OJF-ve të fushës në proceset vendimmarrëse që realizojnë strukturat e kësaj ministrie;
- Publikimi i liçensave që akordohen në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit;
- Publikimi i akteve nënligjore që hartohen dhe miratohen nga kjo ministri;
- Listimi dhe publikimi i projekteve që zbatohen në fushat e bujqësisë dhe ushqimit;
- Zbatimi me cilësi i detyrave që u burojnë këtyre strukturave, sidomos instituteve të sistemit të bujqësisë, nga vendimi i Këshillit të Ministrave “Për monitorimin e Mjedisit në Republikën e Shqipërisë”, në zbatimin e të cilit janë gati të gjithë të angazhuar vit pas viti.

Vlen të theksohet, veçanërisht, se pas këtyre veprimeve që, në pamje të parë, duken thjesht si administrative dhe pjesë të punës rutinë, qendrojnë çështje shumë të rëndësishme për mjedisin. Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit, strukturat e saj të specializuara, kanë rol parësor në bioinformacionin mjedisor, në kuptimin më të gjerë të kësaj fjale. Për shumë çështje të bioinformacionit këto struktura janë gati i vetmi burim kompetent dhe të dhënat, studimet, analizat, botimet e kryera prej tyre priten me interes të veçantë nga publiku.

Këto veprime do të qartësojnë situatën për llojshmërinë e informacionit dhe për vendndodhjen a përkatësinë e tij në nivel qendror dhe vendor. Ato do të përbënin njëherësh hapat imediate, pa të cilat nuk mund të ndërmerren hapa më të thelluara në të mirë të zbatimit të kërkesave të Konventës. Ka shumë rëndësi të qartësohet situata për burimet dhe për llojshmërinë e informacioneve, sepse ato përbëjnë pikat e para bazë, referuese për të gjithë të interesuarit që të mësojnë se çfarë ka dhe ku ndodhet. Ndonëse si fillestar, ky do të ishte një hap i rëndësishëm në procesin e zbatimit të Konventës, sepse krijon terrenin, mbi të cilin do të hidhen normalisht hapa të tjerë të domosdoshëm për zbatimin e kërkesave të Konventës, për të konsoliduar traditat që na mungojnë në komunikimet normale të shtetit me publikun.

Si hap i dytë dhe që i përket një periudhe afatmesme do të sugjerohej rritja e përpjekjeve për të zgjeruar hap pas hapi kuptimin dhe vëllimet e informacionit mjedisor që gjenerohet, krijohet e përpunohet nga këto struktura dhe që lidhet me fushat e veprimtarisë së tyre. Pa e tepruar, do të thoshim se listimi dhe evidencimi i detajuar i sa më shumë çështjeve për të cilat mund të mblidhet e të publikohet informacion në fushat që i përkasin bujqësisë dhe ushqimit, përfaqëson një sipërmarrje serioze dhe me vlera të dukshme praktike.

2/3. Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit

Për shkak se në strukturat e kësaj ministrie funksionojnë organizma të specializuara për administrimin e territoreve, të zonave turistike dhe të ujërave, si Këshillat e Rregullimit të Territorit të të gjitha niveleve, Këshilli Kombëtar i Ujit, Këshilli i Politikave të Zhvillimit të Turizmit, me sekretaritë dhe administratat e tyre, është e qartë se prej tyre priten shumë për zbatimin e kërkesave të Konventës.

Ndikimet pozitive të këtyre organizmave dhe ndihmesat konkrete në dobi të zbatimit të Konventës priten në informimin e vijueshëm të publikut për administrimin, përdorimin dhe mbrojtjen e përbërësve të mjedisit, si territoret urbane, zonat e

ndryshme dhe ujërat, si dhe në tërheqjen e tij në vendimmarrjet për këta përbërës mjedisorë.

Është pozitiv fakti që vit pas viti këto organizma po fitojnë përvoja në qëndrimet ndaj publikut dhe ardhmëria do të përfshinte përpjekjet për konsolidimin dhe për zgjerimin e tyre, për ta kthyer informimin dhe tërheqjen e publikut në tipar normal të veprimtarisë së tyre. Sigurisht që brenda këtij sugjerimi detajohen një mori veprimesh konkrete, të cilat, këto organe, specialistët e tyre i njohin më mirë se kushdo.

2/4. Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit

Mbështetur në detyrat e saj ligjore dhe me përpjekjen për të evidencuar veçori larg përsëritjeve, është e vlefshme të theksohet se përqëndrimet e saj në asistencën vijuese dhe të gjithanshme ndaj organeve të qeverisjes vendore, si dhe angazhimet në zbatimin e të gjitha kërkesave të ligjit “Për emergjencat civile”, do të përbënin dy drejtime të rëndësishme ku ndihmesat e saj për zbatimin e Konventës do të përbënin realisht një kontribut.

Lidhur me qeverisjet vendore, ka dy momente, ku priten zhvillime pozitive dhe përmirësime të ndjeshme të udhëhequra, të organizuara e të realizuara nga kjo ministri: thellimi i procesit të decentralizimit dhe ndihma e gjithanshme kualifikuese me të zgjedhurit rishitas në të gjitha nivelet e qeverisjeve vendore. Është e kuptueshme që bashkëpunimet dhe koordinimet me Ministrinë e Mjedisit, lidhur me zbatimin sa më të efektshëm të detyrave që kanë qeverisjet vendore për mbrojtjen dhe për administrimin e mjedisit që kanë në juridiksion, do të rriste cilësitë e veprimtarive të organizuara dhe do të çonte më përpara zbatimin e kërkesave të Konventës nga qeverisjet vendore. Detyra e shprehur drejtpërdrejt në ligjin e ri “Për mbrojtjen e mjedisit”, që kjo ministri të ndihmojë organet e qeverisjes vendore, me qëllim që këto t’i dalin zot mjedisit të tyre dhe të mbrojnë interesat mjedisore të komunitetit që përfaqësojnë, përfshin, më së pari, realizimin e detyrave që këto organe kanë në kuadër të Konventës.

Në zbatim të kërkesave të ligjit “Për emergjencat civile” janë hedhur hapa të vlefshme për plotësimin e kuadrit rregullator që lehtëson zbatimin e ligjit, si dhe për ngritjen e të gjithë rrejtit institucional e të strukturave përgjegjëse për zbatimin e tij, në nivel qendror dhe lokal.

Gjatë vitit 2005 e në vijim, do të hartohen e miratohen edhe planet e veprimit për të lehtësuar përballimin e emergjencave. Sigurimi i bashkëpunimeve edhe me Ministrinë e Mjedisit, për t’u përfshirë në këto plane, dhe përballimi i emergjencave mjedisore, i aksidenteve industriale, i aksidenteve që mund të ndodhin në mjedisin detar janë ndihmesë e efektshme në kuadër të zbatimit të kërkesave të Konventës.

2/5.

Me të tilla këndvështrime e gjejnë me lehtësi veten edhe ministri të tjera dhe janë plotësisht të afta të identifikojnë angazhime konkrete imediate për të ndihmuar në zbatimin e Konventës. Minimalisht do të sugjerohej zbatimi më cilësor i secilës prej kërkesave të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 103, datë 31.03.2002 “Për monitorimin e mjedisit në Republikën e Shqipërisë”, ndaj të cilit ato kanë detyra si institucione qendrore dhe si organizuese e nxitëse të instituteve që kanë në varësi, të cilët janë të përfshirë në monitorimin e mjedisit.

Ky vendim është i vlefshëm jo thjesht në kuptimin e një akti normativ të detyrueshëm për t'u zbatuar, por për ndihmesën që u jep zbatuesve në disa drejtime, që kanë të bëjnë me larminë e informacionit mjedisor që ata mund të sigurojnë, të përpunojnë e të publikojnë në kuadër të angazhimeve për të monitoruar përbërës të caktuar mjedisorë, si toka, uji, ajri etj. Konkretisht, kjo ndihmë realizohet:

- Duke identifikuar indikatorët që do të monitorohen për secilin përbërës të mjedisit. Kështu, vendimi i ka të specifikuar treguesit për gjendjen e mjedisit, duke i ndarë:

1. Për dukurinë e ndryshimeve klimatike:
 - a) temperatura mesatare e ajrit;
 - b) niveli i detit;
 - c) sasia e reshjeve atmosferike;
 - d) niveli i ujërave nëntokësore.
2. Për precipitimet atmosferike:
 - a) përmbajtja e dioksidit të squfurit, SO_2 ;
 - b) përmbajtja e oksideve të azotit, NO_x ;
 - c) përmbajtja e plumbit, Pb;
 - d) radioaktiviteti në precipitimet atmosferike.
3. Për ajrin urban:
 - a) përmbajtja e lëndës së ngurtë, të pezullt në ajër;
 - b) përmbajtja e ozonit, O_3 , në ajër;
 - c) përmbajtja e plumbit, Pb, në ajër;
 - d) përmbajtja e dioksidit të squfurit SO_2 , në ajër;
 - e) përmbajtja e oksideve të azotit, NO_x , në ajër;
 - f) përmbajtja e monoksidit të karbonit, CO në ajër;
 - g) përmbajtja e hidrokarbureve në ajër;
 - h) niveli i zhurmave;
 - i) radioaktiviteti në atmosferë;
 - j) rrezatimi elektromagnetik jo jonizues në atmosferë;
4. Për ujërat:
 - 4.1. Për ujërat sipërfaqësorë (lumenjtë, liqenet):
 - a) alkaliniteti;
 - b) konduktiviteti specifik;
 - c) aciditeti;
 - d) përmbajtja e nevojës kimike për oksigjen, NKO;
 - e) përmbajtja e nevojës biokimike për oksigjen, NBO;
 - f) përmbajtja e nitrateve dhe e azotit;
 - g) përmbajtja e fosforit, P;
 - h) përmbajtja e amoniakut, NH_3 ;
 - i) vlera e pH-së;
 - j) vlera e fondit radioaktiv natyror dhe radioaktiviteti i ujërave;
 - k) qëndrueshmëria e shtretërve të lumenjve;
 - l) treguesit bakterialë;
 - m) prurja e lumenjve.
 - 4.2. Për detin dhe bregdetin:
 - a) nevoja biokimike për oksigjen për ujërat detare, NBO;
 - b) nevoja kimike për oksigjen për ujërat detare, NKO;
 - c) parametrat mikrobiologjikë për ujërat detare dhe plazhet;
 - d) sasia e fito dhe zooplanktonit;

- e) përmbajtja e klorofilit dhe e prodhimtarisë primare;
- f) përmbajtja në midhje e ujërave detare të metaleve të rënda, ndotësve organikë të qëndrueshëm, radioaktivitetit;
- g) radioaktiviteti i ujërave;
- h) ujëkëmbimi det-lagunë;
- i) dinamika e deltave të lumenjve;
- j) morfologjia dhe topografia e shelfit detar;
- k) morfologjia e bregdetit.

4.3. Për ujërat nëntokësorë:

- a) pH;
- b) fortësia;
- c) alkaliniteti;
- d) aciditeti;
- e) përmbajtja e nitrateve;
- f) shkalla e kriptomërisë.

4.4. Për ujërat sipërfaqësorë, nëntokësorë, detarë, ku ka burime të fuqishme të ndotjes industriale dhe bujqësore:

- a) përmbajtja e metaleve të rënda;
- b) përmbajtja e pesticideve;
- c) përmbajtja e komponimeve hidrokarburike.

4.5. Për ujërat për ujitje:

- a) fortësia;
- b) alkaliniteti;
- c) aciditeti;
- d) përmbajtja e pesticideve;
- e) përmbajtja e azotit dhe e nitrateve.

5. Për biodiversitetin:

- a) diversiteti gjenetik për bujqësinë dhe blegtorinë;
- b) diversiteti i ekosistemeve e habitateve;
- c) diversiteti i ekosistemeve e habitateve në pyje;
- d) diversiteti i ekosistemeve e habitateve në zonat e mbrojtura;
- e) diversiteti i ekosistemeve e habitateve në ujëra.

6. Për tokën:

- a) pjelloria;
- b) përmbajtja e kripërave, Na, Cl, SO₄, - për tokat e kripura; përmbajtja e elementeve ushqimorë - në tokat torfike; raporti magnez/kalcium – në tokat magneziale; përcaktimi i aciditetit – në tokat acide;
- c) radioaktiviteti natyror i tokës.

6.1. Ku ka burime të fuqishme të ndotjes industriale:

- a) përmbajtja e metaleve, sipas specifikave të zonës (mërkur, nikel, krom etj);
- b) përmbajtja e hidrokarbureve.

Dhe kështu mund të vazhdohej edhe për mjaft tregues të tjerë që janë të njohur për ata që punojnë me zbatimin e këtij vendimi.

- Drejtim tjetër i rëndësishëm është përcaktimi i instituteve dhe organeve të ndryshme, nisur nga aftësitë, vlerat e përvojat që ata kanë për të monitoruar një grup të caktuar treguesish. Çdo institut dhe ministri e ka të qartë situatën se çfarë kërkohet prej tyre që, për zbatimin e Konventës, do të thotë se çfarë të dhënash e informacionesh priten prej tyre. Dhe qartësimi i këtyre situatave ndihmon publikun të adresohet saktë për të kërkuar informacionet që i duhen për mjedisin. Sa për ilustrim, po përmendim se:

- Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit dhe qeverisja vendore ngarkohen në monitorimin e treguesve sipas pikave Ç3-a,b; Ç4-a dhe Ç5-d.

- Ministria e Industrisë dhe e Energetikës monitoron nëpërmjet Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, pikat B1-d; C3-a,b,c; B4.2-j,k; B4.3-a,b,c,d,e,f; B3-i; B4.1-k. B4.4-a,b,c; C4 – a,b,c; C5; C6-e; Ç11;

- Ministria e Mbrojtjes ngarkohet me monitorimin e treguesve sipas pikave Ç1, Ç2, Ç5, Ç6, Ç7, Ç8, për të gjithë personat, fizikë e juridikë, pronësi brenda sistemit të saj.

10. Personat fizikë dhe juridikë monitorojnë treguesit mjedisorë sipas pikave Ç1, Ç2, Ç5, Ç6, Ç7, Ç8 në nivel individual.

- Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, përgjigjet dhe teston nivelin e treguesve mjedisorë të trysnisë në ajër, Ç2 kreu I.

Gjthashtu, në funksion të zbatimit të Konventës është shumë i vlefshëm edhe detyrimi që kanë të gjithë të angazhuarit në monitorimin e mjedisit për të shkëmbyer të dhënat që krijojnë gjatë zbatimit të programit të monitorimit. Lidhur me këto çështje, vendimi urdhëron:

1. Institucionet zbatuese të programit kombëtar të monitorimit të mjedisit të dorëzojnë të dhënat e përcaktuara në kontratën përkatëse në Ministrinë e Mjedisit, të paktën, një herë në tre muaj, brenda datës 15 të muajit të parë të periudhës tremujore pasardhëse, si edhe sa herë që Ministria e Mjedisit ua kërkon zyrtarisht për arsye urgjente.

2. Personat, fizikë dhe juridikë që janë subjekte të lejes mjedisore, të dërgojnë në agjencitë rajonale të mjedisit (ARM) të dhënat e monitorimit, të paktën, 4 herë në vit, si edhe t'i vënë në dispozicion të inspektorëve të mjedisit gjatë inspektimit të ushtruar prej tyre. Treguesit e monitoruar nga institucionet e Akademisë së Shkencave dhe nga Instituti i Shëndetit Publik përjashtohen nga detyrimi për të dërguar në ARM të dhënat e monitorimit.

3. Ministrinë e përfshira në programin kombëtar të monitorimit të mjedisit, sipas këtij vendimi, dhe Akademia e Shkencave të dorëzojnë në Ministrinë e Mjedisit raporte vjetore për gjendjen e mjedisit, politikat mjedisore sektoriale, të dhëna për projekte mjedisore dhe për komponente mjedisore në projekte të ndryshme, brenda sistemeve të tyre.

4. Ministria e Mjedisit kryen inventarizimin e burimeve të ndotjes, karakteristikat e tyre dhe shpërndarjen sektoriale. Inventarizimi i burimeve të ndotjes dhe shpërndarja sektoriale rregullohen me akt normativ të veçantë.

5. Ministria e Mjedisit raporton për treguesit mjedisorë, në mbështetje të metodologjive bashkëkohore, në Këshillin e Ministrave dhe në organe të specializuara ndërkombëtare.

6. Ministria e Mjedisit përgatit dhe boton, me të dhënat e siguruara nga monitorimi i mjedisit, çdo dy vjet raportin për gjendjen e mjedisit, të cilin ia paraqet Këshillit të Ministrave, si dhe përmbush të gjitha detyrimet shtetërore, ndërkombëtare, të raportimit për gjendjen e mjedisit.

7. Ministria e Mjedisit shkëmben të dhëna të ndërsjella me Institutin e Statistikave në çdo fillim viti kalendarik, sipas një akti normativ të veçantë.

8. Ministria e Mjedisit shkëmben të dhëna të ndërsjella me këshillat e rregullimit të territorit, Sekretariatit Teknik të Ujërave, në fushën e monitorimit të rezervave ujore.

9. Ministria e Mjedisit njej, ruan dhe respekton të drejtën e autorit që institucionet monitoruese kanë mbi të tëra të dhënat që sigurohen nga zbatimi i programit të monitorimit të mjedisit dhe që i vihen asaj në dispozicion.

10. Ministria e Mjedisit i siguron të dhënat në kuadër të programit kombëtar të monitorimit të mjedisit, nëpërmjet raporteve teknike, të përgatitura nga institucionet përgjegjëse, të përcaktuara në këtë vendim.

11. Të dhënat e mjedisit regjistrohen çdo tre muaj në regjistrat përkatës në Ministrinë e Mjedisit dhe hidhen në bazën elektronike të të dhënave. Regjistrat dhe baza e të dhënave janë të hapura për publikun, vendas e të huaj.

12. Institutet zbatuese të programit të monitorimit krijojnë bazën elektronike të të dhënave e të treguesve të monitorimit të mjedisit, sipas përkufizimit të tyre në këtë vendim që duhet të jetë e hapur për publikun.

Sigurisht që angazhimet serioze për të zbatuar këto kërkesa detyruese të vendimit, do të ishin kontribute shumë të vlefshme, në bashkangazhimet e organeve shtetërore për zbatimin e kërkesave të Konventës.

3. Roli dhe detyrat e qeverisjeve vendore në zbatimin e Konventës

Të ngritura sa më pranë komunitetit dhe bashkësive, numerikisht të shumta e të shpërndara në të gjithë territorin e vendit, organet vendore mbajnë peshë të ndjeshme dhe luajnë rol të pazëvendësueshëm në qeverisjen e vendit. Realizimi në praktikë i procesit të decentralizimit, pas nënshkrimit të Kartës për autonominë e qeverisjes vendore, po ndihmon në rritjen e rolit aktiv të këtyre organeve dhe, praktikisht, ato po formojnë përvojën e personalitetin e vet edhe në administrimin dhe mbrojtjen e mjedisit që kanë në juridiksion.

Veç kësaj, në nivel vendor ushtrojnë veprimtarinë e tyre edhe mjaft organe të tjera shtetërore, si gjykatat, prokuroria, policia, drejtoritë rajonale të shërbimit pyjor, agjencitë rajonale të mjedisit etj. Të tëra së bashku, këto formojnë një rrjet të dendur dhe të fuqishëm institucional, potencialisht të aftë të përballojë me nivel edhe detyrat për mbrojtjen e mjedisit. Sigurisht që koordinimet, bashkërendimet e bashkëveprimet në nivel lokal, ndërmjet përbërësve të këtij rrjeti, mbeten drejtime të rëndësishme për të rritur efektivitetin e punës e për të realizuar zgjidhje të qëndrueshme.

Rritja e nivelit të punës së këtyre organeve, forcimi i kapaciteteve të tyre, aftësimi profesional i të angazhuarve në to, njohja dhe zbatimi i kërkesave që shtron ligji para tyre, mbeten drejtimet parësore, që ndikojnë pozitivisht edhe në zbatimin e kërkesave të Konventës së Aarhusit.

Për rëndësinë që ka mjedisi për shoqërinë, për vlerësimin që po merr mbrojtja e tij, si dhe për faktin që problemet e mjedisit ndërthuren gati me të gjitha problemet e shoqërisë, detyrat e qeverisjeve vendore për mbrojtjen e tij parashikohen në mjaft ligje e dokumente të rëndësishme shtetërore. Konkretisht ato parashikohen:

- Në legjislacionin e qeverisjeve vendore, ku janë detajuar një varg detyrash që kanë të bëjnë me furnizimin me ujë të pijshëm; me funksionimin e sistemit të kanalizimeve të ujërave të bardha, të ujërave të zeza dhe kanaleve mbrojtëse të zonave të banuara; me ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve me karakter vendor, trotuareve dhe shesheve publike; me administrimin e parqeve, lulishteve dhe zonave

të gjelbëruara publike; me grumbullimin, largimin dhe përpunimin e mbeturinave; me planifikimin urban, menaxhimin e tokës etj.

- Në legjislacionin për emergjencat civile (Ligji nr. 8756, datë 26.03.2001 “Për emergjencat civile” dhe aktet nënligjore që po dalin në zbatim të tij.)

Të vlerësuara si fatkeqësi që dëmtojnë rëndë jetën, shëndetin, pasurinë e banorëve dhe mjedisin, përballimi i emergjencave civile përbën një drejtim të veçantë dhe shumë të rëndësishëm të veprimtarisë së organeve të qeverisjes vendore për mbrojtjen e sidomos për rehabilitimin e mjedisëve të dëmtuara.

- Në legjislacionin për mbetjet (Ligji nr. 8094, datë 21.03.1996 “Për largimin publik të mbeturinave” me rregulloren përkatëse; ligji “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”; ligji “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”).

Me këto ligje përcaktohen detyrat konkrete gjatë të gjitha fazave të procesit të administrimit të mbetjeve urbane që nga caktimi i pikave të vendosjes së kazanëve, koha, mënyra dhe regjimi i transportimit të mbetjeve, larja e rrugëve dhe e shesheve, përcaktimi i venddepozitimit të mbeturinave dhe rregullat e mirëmbajtjes së tij etj.

- Në legjislacionin e burimeve natyrore e pasurive minerare (Ligji nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën” me ndryshimet e mëvonshme; ligji nr. 7796, datë 17.02.1994 “Minerar i Shqipërisë”; ligji nr.8093, datë 09.11.1996 “Për rezervat ujore” me ndryshimet e mëvonshme; ligji nr.8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tyre).

Për rëndësinë e madhe që kanë rezervat dhe pasuritë natyrore, si ujërat, inertet, mineralet, për të tashmen e për zhvillimet e pritshme të zonës, organet e qeverisjes vendore janë shumë të interesuara për miradministrimin e tyre dhe për përdorimin e qëndrueshëm. Legjislacioni aktual u jep atyre mundësinë të mbrojnë me këmbëngulje interesat e komunitetit për këto pasuri, duke harmonizuar nevojat e zhvillimit kombëtar me ato vendore.

- Në legjislacionin e fushës së bujqësisë (Ligji nr.7623, datë 13.10.1992 “Për pyjet dhe policinë e shërbimit pyjor”; ligji nr.7908, datë 05.04.1995 “Për peshkimin dhe akuakulturën”; ligji nr.7875, datë 23.11.1994 “Për mbrojtjen e faunës së egër dhe gjuetinë”; ligji nr. 7722, datë 15.06.1993 “Për mbrojtjen e fondit të bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore”, me ndryshimet e mëvonshme dhe me aktet nënligjore në zbatim të tyre).

Përbërësit mjedisorë dhe të biodiversitetit që ka zona, si pyjet, kullotat, livadhet, bimët medicinale, kafshët e shpendët e egra, janë të njohur për qeverisjet vendore. Ata vlerësohen si pasuri të zonës e si burime që ndihmojnë begatimin e komunitetit të tyre. E rëndësishme është sidomos se, me këto ligje, këto pasuri shtetërore u lihen në përdorim organeve të qeverisjeve vendore.

- Në legjislacionin e urbanistikës dhe të turizmit (Ligji “Për Urbanistikën”; ligji nr.7665, datë 21.01.1993 “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin”, me ndryshimet e mëvonshme dhe me aktet nënligjore në zbatim të tyre).

- Në legjislacionin e kësaj fushe ka mjaft kompetenca e detyra për organet e qeverisjes vendore, të cilat u japin mundësi këtyre organeve të ruajnë mjediset urbane, të disiplinojnë ndërtimet e ndërhyrjet në territor, të shtojnë sipërfaqet e gjelbra, vendet çlodhëse etj.

- Në legjislacionin e ri mjedisor, siç është sqaruar edhe më parë, aktualisht funksionon një legjislacion krjet i ri mjedisor, që vlerëson dukshëm rolin dhe funksionet e qeverisjeve vendore në mbrojtje të mjedisit, jo thjesht duke caktuar disa detyra për to.

Sipas këtij legjislacioni, organet e qeverisjes vendore përfaqësojnë strukturën më të rëndësishme shtetërore për administrimin dhe mbrojtjen e mjedisit që kanë në juridiksion, duke zbatuar përgjegjësitë, të drejtat e detyrat që u jep ligji.

Në mbrojtje të mjedisit, ato kanë për detyrë:

- a) të realizojnë zbatimin e ligjeve për mbrojtjen e mjedisit;
- b) të hartojnë plane vendore për mbrojtjen e mjedisit dhe planet e rregullimit të territorit;
- c) të bëjnë publike programet dhe masat për mbrojtjen e mjedisit;
- ç) të njoftojnë publikun për gjendjen e mjedisit dhe për veprimtaritë vendore, subjekte të vlerësimit të ndikimit ndaj mjedisit;
- d) të nxisin e të mbështesin veprimtaritë e organizatave jofitimprurëse për mjedisin, duke tërhequr mendimin e tyre në vendimmarrjet për mjedisin;
- dh) të përcaktojnë vendet e grumbullimit e të përpunimit të mbeturinave prodhuese dhe jetësore, në përputhje me kriteret mjedisore dhe me planet e zhvillimit;
- e) të organizojnë depozitimin e mbetjeve dhe të lëndëve të rrezikshme dhe ruajtjen e zonave të gjelbra në qendrat qytetare dhe rreth tyre;
- ë) të administrojnë mbeturinat urbane, impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura dhe të mbeturinave të ngurta;
- f) të disiplinojnë transportin dhe ndërtimet në mjediset qytetare.

Roli dhe funksionet e organeve të qeverisjeve vendore për mbrojtjen e mjedisit, detyra konkrete për to në këtë fushë, formulohen edhe në dokumente shtetërore të detyrueshme për t'u zbatuar siç janë:

- Strategjia dhe Plani Kombëtar i Veprimit për Mjedisin
- Plani Kombëtar i Veprimit për Mjedisin dhe Shëndetin
- Strategjia dhe Plani i Veprimit për ruajtjen e biodiversitetit
- Strategjia e zhvillimit të pyjeve
- Plani i manaxhimit të zonës bregdetare
- Planet Lokale të Veprimit për Mjedisin
- Planet Lokale të Veprimit për Mjedisin dhe Shëndetin etj.

Si përfundim i kësaj pjese të parashtrësës, meriton të nënvizohet fakti që organet e qeverisjes vendore, veç kompetencave dhe funksioneve vetjake që marrin në fushën e mjedisit, vendosen krahas dhe në bashkëpunim me organet qendrore për të zgjidhur së bashku detyrat për administrimin dhe mbrojtjen e mjedisit. Madje, në shumë prej tyre, organet vendore vlerësohen përfituese, sepse marrin funksione e kompetenca për të rritur praninë dhe ndikimin e tyre në administrimin e përbërësve të rëndësishëm mjedisorë si pyjet, kullotat, livadhet, ujërat etj. Në këtë kuptim, është e rëndësishme të theksohet se ka një vlerësim të rolit e të pozitës së tyre si shprehëse të drejtpërdrejta të interesave të bashkësisë për të jetuar në një mjedis të pastër e të shëndetshëm, për t'i përdorur përbërësit e tij për vete e për brezat e ardhshëm.

Pikërisht për të përmbushur sa më mirë misionin si përfaqësuese të drejtpërdrejta të komunitetit, qeverisjet vendore caktohen pjesëmarrese, palë e vlerësuar, bashkëpunuese për veprimtari të rëndësishme publike në fushën e mjedisit, siç janë:

- Hartimi i strategjive dhe planeve të veprimit për mjedisin dhe për përbërësit e tij
- Hartimi i strategjive dhe planeve të veprimit për degë e fusha të ndryshme të zhvillimit ekonomik e shoqëror
- Hartimi i planit për shpalljen e zonave të mbrojtura

- Hartimi dhe zbatimi i planeve të menaxhimit të këtyre zonave
- Në procesin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për projekte e veprimtari që kërkojnë të zbatohen në territorin e tyre
- Në caktimin e zonave urbane me ndotje të veçantë të ajrit dhe në përcaktimin e normave për shkarkimet në ajër për këto zona etj.

Për vitin 2005 sugjerohet që këto organe të angazhohen sidomos në hartimin e Planeve Lokale të Veprimit për Mjedisin, për disa arsye:

1. Së pari, hartimi dhe zbatimi i këtyre planeve përfaqëson procesin, ku gjejnë realizim konkret mjaft nga kërkesat e Konventës për informim dhe pjesëmarrje të publikut për çështje të mjedisit.
2. Së dyti, hartimi dhe zbatimi i këtyre planeve përfaqëson dokumentin dhe veprimtaritë në të cilat detyrimisht zbatohen kërkesat që shtron ligji mjedisor për organet e qeverisjeve vendore. Në ligj, për këto plane theksohet:
 - Organet e qeverisjes vendore hartojnë plane veprimi për mjedisin, në përputhje me përparësitë dhe me kërkesat e strategjisë kombëtare të mjedisit.
 - Ministrinë e linjës ndihmojnë në hartimin dhe në zbatimin e planeve vendore për mjedisin, duke paraqitur të dhënat e nevojshme dhe ekspertizën teknike.
 - Në hartimin dhe në miratimin e planeve dhe të programeve mjedisore, organet e qeverisjes vendore angazhojnë publikun dhe organizatat jofitimprurëse mjedisore dhe profesionale të biznesit.

Kryetarët e bashkive, në fund të çdo viti, raportojnë në Këshillin e Qarkut për zbatimin e planit vendor për mjedisin.
3. Së treti, gjatë vitit 2003 u bë e mundur që në Qarkun e Korçës këto plane t'i hartojnë 17 komuna, çka dëshmon se ekzistojnë kapacitetet dhe përvoja e nevojshme për ta kryer këtë detyrë.

Nisur nga të gjitha këto, është e kuptueshme dhe e përligjur që organet e qeverisjeve vendore të mbajnë peshë të rëndësishme dhe të luajnë rol vendimtar në zbatimin e kërkesave të Konventës së Aarhusit. Krahas organeve të specializuara për mbrojtjen e mjedisit, që janë përgjegjësit kryesorë për zbatimin e Konventës në nivel kombëtar, qeverisjet vendore janë po aq të detyruara dhe kontribuese në ecjen mbarë të procesit zbatues në nivel lokal.

4. Institutet kërkimore-shkencore

Siç dihet, në Shqipëri ekziston një rrjet i gjerë qendror dhe lokal, institucionesh kërkimore-shkencore, i përbërë nga institute, laboratore, katedra universitare publike dhe që po zgjerohet edhe me organizma të tilla private. Këta japin ndihmesë të pazëvendësueshme në monitorimin e mjedisit dhe në zhvillimin e mendimit shkencor në fushat që punojnë. Si të tillë, ata janë prodhuesit e parë të pazëvendësueshëm të të dhënave dhe të informacioneve për gjendjen e mjedisit e të përbërësve të tij. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.103, datë 31.03.2002 “Për monitorimin e mjedisit në Republikën e Shqipërisë”, që ka detajuar treguesit që do të monitorohen për secilin përbërës të mjedisit, ka përcaktuar angazhimet konkrete të çdo instituti dhe përfaqëson bazën më të rëndësishme ligjore për përmirësimin e dukshëm të procesit të monitorimit të mjedisit, si dhe për rritjen e ndihmesës së instituteve në këtë proces.

Në kuadër të hartimit të kësaj strategjie, është e natyrshme të sugjerohet përfshirja e tyre më e gjerë dhe më efektive në dy drejtime:

1. Për të përpunuar dhe për të publikuar informacionin mjedisor.

Përcaktimi i indikatorëve për matje, analiza e vëzhgime; i metodikave të sakta për grumbullimin dhe shqyrtimin e të dhënave në kuadër të monitorimit; analizat cilësore të të dhënave të grumbulluara dhe zbulimi i prirjeve për dukuri të ndryshme mjedisore, përfaqësojnë ndihmesa unike të tyre në gjithë sistemin e ndërlikuar të informimit mjedisor. Në këtë kuptim ata përfaqësojnë një element domosdoshmërisht të përfshirë në përpjekjet për ta njohur shkencërisht mjedisin dhe për të kumtuar të dhëna e informacione me cilësi dhe nivel të lartë. Ka ardhur koha që, në bashkëpunim me ta, të përpunohen zgjidhje të pranueshme edhe prej tyre, të cilat marrin në konsideratë punën dhe investimet që ata bëjnë në grumbullimin e të dhënave dhe në përpunimin e informacionit që respektojnë të drejtën e autorit etj. dhe të kalohet në një stad të ri që ata të shndërrohen në furnizues aktivë të publikut me informacione mjedisore.

2. Për të dhënë ndihmesë më të dukshme në popullarizimin e dijeve shkencore për mjedisin.

Mendimi shkencor ambientalist i lëvruar në këto organizma të konsoliduara dhe me përvojë, i përfaqësuar nga profesori dhe nga punonjës shkencorë të afirmuar, kërkohet më aktiv e më i pranishëm në jetën shoqërore. Me projekte, botime, seminare, konferenca e forma të tjera pune e komunikimi, ndihmesa e tij në emancipimin e opinionit është parësore dhe e autoritetshme.

4/1. Instituti i Statistikës

Përpunimit dhe publikimit të informacionit mjedisor dhe në tërësi informimit të publikut për gjendjen e mjedisit, do t'i ndihmonte së tepërmi thellimi i bashkëpunimit midis Ministrisë së Mjedisit dhe Institutit të Statistikës, për të futur në përpunimet dhe në publikimet e këtij të fundit sa më shumë tregues dhe të dhëna për mjedisin. Me përvojën që ka, me metodat specifike të përpunimit dhe me reputacionin që kanë merituar botimet e publikimet e tij, Instituti i Statistikës duhet të zerë vendin që i takon edhe në të dhënat mjedisore dhe të përfaqësojë një zë më vete, të besueshëm, duke thënë për to fjalën e tij me peshë. Në këtë linjë, është e nevojshme të ecet edhe drejt unifikimit të të dhënave mjedisore shqiptare me ato të vendeve të rajonit e të Evropës, duke përshtatur zërat, rubrikat e treguesit mjedisorë që përdorin Agjencia Evropiane e Mjedisit dhe EUROSTAT.

5. Organizatat jofitimprurëse për mbrojtjen e mjedisit

Për të paraqitur statusin, pozicionin, gjendjen dhe angazhimet e Organizatave Jofitimprurëse Mjedisore, atë çka mund të bëjnë këto organizata dhe që po bëjnë faktikisht, duhet t'u drejtohem legjislacionit të veçantë për shoqatat, legjislacionit të ri mjedisor dhe praktikës ku ato operojnë konkretisht. Edhe pse nuk është detyrë e këtij materiali kjo analizë kaq e gjerë, në funksion të tij mund të konstatohen:

- Prej disa vitesh ekziston dhe zbatohet konkretisht një legjislacion i plotë dhe bashkëkohor për organizimin dhe funksionimin e shoqatave ambientaliste.
- Është i ngritur, i kompletuar dhe funksional, rrjeti institucional që zbaton këtë legjislacion.
- Në legjislacionin e ri mjedisor, trajtimi dhe përkrahja e OJF-ve nga organet shtetërore mjedisore është trajtuar deri me detaje.

- Ky kuadër ligjor dhe institucional i favorshëm është shfrytëzuar nga iniciatorë të ndryshëm dhe, tashmë, në praktikë ekzistojnë shumë OJF mjedisore kombëtare dhe lokale. Nga të dhëna paraprake, në nivel vendi janë mbi 100 OJF mjedisore.
- Ka një polarizim dhe shkallëzim të tyre në angazhimet e kontributet që japin.
- Nuk janë të pakta rastet që OJF-të kombëtare dhe ca më shumë ato lokale, janë vyshkur, kanë kaluar në apati dhe rrezikojnë të bëhen inekzistente.
- Ndërkohë, mjaft të tilla po rrisin personalitetin e tyre, nëpërmjet angazhimeve dhe kontributeve që po japin në shumë drejtime dhe procese, që zhvillohen për mbrojtjen e mjedisit shqiptar.
- Vazhdon të jetë akoma i zbalancuar raporti midis shtimit të ndjeshëm të shoqatave ambjentaliste dhe rritjes së ngadaltë të personalitetit të secilës. Aktualisht, zor se mund të gjendet një rreth a një qytet që nuk ka të tilla, madje, jo një, por disa; por në më shumë se 10 vjet ekzistencë, janë ende të pakta ato që kanë formuar një emër e janë afirmuar si elemente të rëndësishme të shoqërisë civile.
- Konventa e Aarhusit dhe zbatimi i saj ka kohë që është synim parësor për shumë OJF kombëtare dhe lokale. Janë të panumërta OJF-të pjesëmarrëse në trainime për zbatimin e Konventës, janë, gjithashtu, të shumta ato që janë angazhuar me detyra konkrete në projekte që i janë kushtuar zbatimit të Konventës; ndërkohë që janë ende të pakta ato që dinë të zbatojnë konkretisht në praktikë të drejtat që u jep Konventa.
- Rritja e dijeve dhe e përvojave për të operuar lirshëm brenda kuadrit të Konventës, si për të kërkuar informacion mjedisor, për pjesëmarrje dhe rol aktiv në vendimmarrjet mjedisore, për të realizuar natyrshëm oponencën dhe lobingun ndaj qëndrimeve që i vlerësojnë në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit mjedisor dhe, në mënyrë të veçantë, për t'u ankuar në gjykatë, në kushtet që parashikon Konventa, mbetet objektiv për t'u arritur prej shumicës dërrmuese të OJF-ve; ajo përfaqëson një hap të rëndësishëm në maturimin e tyre.

Duke reflektuar ndaj këtyre dukurive e karakterizimeve që lidhen me OJF-të mjedisore, duke i vlerësuar ato si organizma shumë të rëndësishme vullnetare në mbrojtje të mjedisit e veçanërisht për zbatimin e Konventës, legjislacioni i ri mjedisor ka përcaktuar detyra të qarta për organet që mbrojnë mjedisin, në mbështetje dhe në përkrahje të tyre. Në ligjin “Për mbrojtjen e mjedisit” theksohet:

1. Organizatat jofitimprurëse mjedisore gëzojnë të drejtat e oponencës dhe të bashkëpunimit me organet e mbrojtjes së mjedisit.
2. Ministri i Mjedisit përcakton rregullat dhe procedurat e detyrueshme për organet mjedisore, për të realizuar të drejtat e organizatave jofitimprurëse, sidomos:
 - a) në hartimin e politikave, të strategjive, planeve të zhvillimit, si dhe të programeve për mbrojtjen e mjedisit;
 - b) në hartimin dhe në zbatimin e planeve të menaxhimit të zonave të ndryshme;
 - c) në hartimin dhe në zbatimin e programeve të monitorimit;
 - ç) në kontrollet mjedisore;
 - d) në procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe të miratimit të lejes mjedisore;
 - dh) në hartimin e projekt-akteve normative mjedisore.

Përfaqësues të organizatave jofitimprurëse marrin pjesë si anëtarë në këshilla e komitete që krijohen për administrimin dhe mbrojtjen e mjedisit. Ministria e Mjedisit mbështet projektet e organizatave jofitimprurëse për mbrojtjen e mjedisit, sipas rregullave të miratuara nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit të Mjedisit.

Zbatimi tërësor dhe i programuar i këtyre kërkesave ligjore nga Ministria e Mjedisit dhe strukturat e saj, përbën një tjetër përparësi të angazhimeve të ministrisë në favor të zbatimit të Konventës.

6. Organizatat profesionale të biznesit

Lidhur me përfshirjen e biznesit dhe të organizmave që përfaqësojnë interesat e tij, në veprimtaritë për zbatimin e Konventës, ka një konstatim të saktë, ndonëse jo shumë të pëlqyer. Ky aktor i rëndësishëm dhe me peshë, deri tani ka mbetur disi në hije, nuk është vlerësuar dhe nuk është tërhequr sa dhe si duhet në veprimtaritë zbatuese. Për më tepër, investitorët dhe biznesi vendas, organizmat që i përfaqësojnë ata, janë akoma larg pozitive të avancuara dhe përgatitjeve për të vendosur urat e lidhjes dhe të bashkëpunimit normal me organet e ngarkuara për mbrojtjen e mjedisit për të kontribuar në hartimin dhe në zbatimin e programeve të zhvillimit, të administrimit e të mbrojtjes së mjedisit, të cilat janë veçanërisht të dobishme edhe për ta.

Angazhimi dhe përfshirja e biznesit në zbatimin e Konventës përbën një plotësim të ndjeshëm në punët zbatuese të deritanishme dhe një detyrim tashmë të përcaktuar për të ardhmen e afërt, zbatimi i të cilit kërkon:

- Marrjen e masave për të realizuar lehtësisht në praktikë kërkesat e legjislacionit të ri mjedisor, i cili për këtë çështje saktëson: “Organizatat jofitimprurëse profesionale të biznesit paraqesin pikëpamjet e veta në rrugë institucionale për administrimin dhe për mbrojtjen e mjedisit. Ato marrin pjesë në hartimin dhe në zbatimin e programeve të zhvillimit, të administrimit e të mbrojtjes së mjedisit.”
- Njohjen e përvojave të vendeve të përparuara për këtë çështje dhe përshtatjen e tyre në kushtet e vendit tonë.
- Shpeshimin e kontakteve me organizmat që përfaqësojnë biznesin, të cilat ekzistojnë dhe veprojnë në vendin tonë prej disa vitesh. Përvoja e Bashkisë së Tiranës për të komunikuar me to, për të debatuar e për të gjetur zgjidhje për probleme të ndryshme urbane të kryeqytetit ka ndikuar pozitivisht edhe në riparimin e mjediseve të tij.
- Organizimin e veprimtarive njohëse, zbrërthuese e sensibilizuese me biznesin, të fokusuara veçanërisht në legjislacionin e ri mjedisor, në metodologjitë bashkëkohore me të cilat po operohet aktualisht në mbrojtjen e mjedisit, në zbatimin në Shqipëri të kategorive e praktikave bashkëkohore, si sistemet e akreditimit, përdorimi i suksesshëm i mekanizmave ekonomikë e financiarë në shërbim të mjedisit, krijimi dhe funksionimi normal i lidhjeve ndërmjet biznesit dhe bankave, organeve shtetërore të mjedisit etj., për të cilat mjedisi shqiptar po ndjen nevojë në rritje.

7. Kontributi i mediave në zbatimin e Konventës

Nëse do të bëhej një renditje e të gjitha subjekteve që janë angazhuar në problematikën mjedisore dhe kanë ndihmuar realisht në rritjen e interesit, të dijeve, të edukatës e të sjelljes ndaj tij që kanë ngritur probleme dhe kanë sensibilizuar opinionin për mbrojtjen e mjedisit, është e mbarëpranuar që vendin e parë e meritojnë mediat. Gati në të gjitha llojet e nivelet e tyre, mjedisi është tematikë e përditshme, e lëvruar me të gjitha rubrikat e komunikimit, me artikuj, me kronika, me lajme, me njoftime, me biseda etj.

Në këtë klimë shumë të begatë përvojash e kontributesh, janë të gjitha mundësitë që mediat të orientohen më mirë në angazhimet për zbatimin e kërkesave të Konventës. Zgjerimi i lidhjeve dhe i bashkëpunimit me to, trainimi mjedisor i gazetarëve të rinj, transparenca ndaj tyre për gjendjen dhe problemet e mjedisit, janë disa nga drejtimet e punës së organeve shtetërore që mediat të ndihmojnë në:

- mbrojtjen e interesave kombëtare në fushën e mjedisit;
- rritjen e dijeve dhe të kulturës bashkëkohore për mjedisin;
- realizimin e së drejtës të publikut për të marrë të dhëna për gjendjen e mjedisit;
- përhapjen e arritjeve teknike dhe shkencore në fushën e mjedisit dhe të veprimtarive kombëtare në këtë fushë.

Nga organet shtetërore duhet të përcillen me vëmendje dukuritë më të qënësishme të kësaj fushe, si:

- Fakti që teknologjitë e komunikimit janë duke u zhvilluar me shpejtësi dhe po shtrihen në të gjithë territorin e vendit.
- Edhe në vendin tonë televizioni është bërë burimi kryesor i lajmeve dhe i informacionit. Është një mjedis i fuqishëm ky për të prezantuar mesazhe pozitive dhe negative për problemet e mjedisit dhe të shëndetit. Aksesit në programe të ndryshme televizive inkurajon pjesëmarrje dhe përgjigje të shikuesve. Njoftimet e shërbimeve publike për problemet sociale dhe shëndetësore, të bëra nga agjencitë shtetërore ose OJF-të si pjesë e fushatave të shëndetit publik apo të fushatave të tjera, krijojnë një tjetër mundësi për ndërgjegjësimin e publikut. Ka arsye për të inkurajuar këto njoftime në nivel nacional rregullisht dhe pa pagesë. Gjithashtu, është rasti për një moral të fuqishëm për të kufizuar publicitetin e produkteve, të cilat dëmtojnë shëndetin ose mjedisin.

KREU IV

MBËSHETJA E NEVOJSHME FINANCIARE PËR ZBATIM

Pasi u identifikua se çfarë duhet bërë më tej për zbatimin e Konventës dhe nga kush duhen realizuar praktikisht, natyrshëm vijmë tek anët financiare të problemit dhe, për kushtet e vendit tonë, kjo është pjesa më pikante e materialit. Madje, në disa materiale të tilla të mëparshme, që kanë dhënë plane, programe, përparësi e synime, edhe pse profesionalisht kanë qenë me nivel, janë zbatuar pjesërisht apo kanë mbetur pa u zbatuar, kanë mbetur në letër siç thuhet rëndom, dhe aspekti financiar i tyre, nga pikant, ka degjeneruar në zhgënjyes.

Për të mos ndodhur kështu edhe në këtë rast, në këtë pjesë të materialit do të bëhet një përpjekje rekomanduese, me qëllim që të shmangen sa të jetë e mundur zhgënjimet.

Është mëse e njohur se dokumente të tilla, si strategjitë dhe planet e veprimit, kanë edhe aspektin e vet financiar. Sado me dorë të shtrënguar të gjykohet e të veprohet, veprimtaritë për zbatim kanë një kosto, duhet të mbështeten e të mbulohen financiarisht. Vijmë kështu te trajtimet ballas të kostove e të përllogaritjes së tyre, të sigurimit të fondeve e të mjeteve financiare, te përdorimi sa më efektiv i tyre etj. për të cilat është e domosdoshme të jepen rekomandime.

Edhe pse për nga radha, trajtimi i kësaj problematike po vihet nga fundi i materialit, si shqetësim e angazhim ai ka qenë i pranishëm në trajtimin e të gjitha pjesëve deri këtu. Ka qenë një nga konstantet që përshkojnë gjithë trajtesat e bëra deri në këtë pjesë dhe nga kjo pikëpamje është bërë kujdes të përcaktohen e të sugjerohen nisma, veprimtari, aksione e sipërmarrje që kanë kosto të ulët; që mund të shfrytëzojnë fonde të destinuara etj.

Në kushte më optimale, në gjendje më të begatë pasurore e financiare, është e natyrshme që kjo problematikë do të ishte më e thjeshtë, do të përballohej më me lehtësi e normalitet, nuk do të gjeneronte trysni e çekuilibre te zbatuesit, tek të cilët çangazhimet e demotivimet bëhen disi të natyrshme, kur u mungojnë paratë për të realizuar veprimtari praktike zbatuese.

Në këtë kuptim, synime parësore të kësaj trajtese do të mbeten ngushtimi tërësor i terreneve, ku lindin e vegjetojnë këto negativitete mendësore e psikologjike dhe zbatuesit të ndihmohen të gjejnë rrugë, forma e mundësi të përdorshme për të realizuar veprimtaritë e sugjeruara në pjesët përkatëse të këtij materiali dhe të marrin prej tyre efektshmëri të lartë.

Momenti i parë, ku donim të tërhiqim vëmendjen, ka të bëjë me faktin që shumica e veprimtarive konkrete të sugjeruara për t'u kryer në kuadër të zbatimit të kërkesave të Konventës, janë pjesë e punës dhe e angazhimeve të zakonshme të strukturave e organeve, të cilat janë të ngritura, funksionale dhe vepruese prej disa kohësh. Specialistët e këtyre organizmave i kanë njohuritë dhe përvojën e nevojshme për t'i përballuar me nivel këto kërkesa. Për më tepër, ajo që mund të quhet shtesë apo ngarkesë plus në punën e tyre të deritanishme është ende e vogël dhe e lidhur organikisht me punën që bëjnë, me funksionet, detyrat e kompetencat e tyre ligjore. Në këtë mënyrë gjykimi dhe trajtimi do të përfshiheshin natyrshëm në të tëra

veprimtaritë imediate, që janë përcaktuar në material për mjaft organe qendrore e lokale dhe që kanë të bëjnë me listimet e shumta të mjaft dokumenteve e materialeve që disponohen nga këto organe, me formatimet dhe publikimet e tyre në versione elektronike apo me forma të tjera të thjeshta, që konsumohen lehtësisht nga publiku dhe nga të interesuarit. Këto veprimtari, që, në dukje shfaqen si rutinë, kanë meritën të zgjidhin një problem themelor: të qartësojnë përfundimisht se çfarë të dhënash dhe informacionesh disponohen për mjedisin, ku ndodhen konkretisht dhe të shpërndahet përfundimisht mjegullnaja ekzistuese, e krijuar artificialisht që për mjedisin nuk ka të dhëna e informacione. Nëse arrihet të bëhet kjo gjatë vitit 2005, është hedhur një hap i fuqishëm në vendosjen e rregullit e të rendit të gjërave në fushën e informacionit mjedisor.

Moment tjetër, ku do të tërhiqim vëmendjen, është fakti që, gjithashtu, shumë veprimtari të sugjeruara si të domosdoshme për t'u kryer në dobi të zbatimit të Konventës, janë konceptuar si pjesë të natyrshme të veprimtarive apo të aksioneve më të gjëra, të cilat janë të mbështetura apo nuk e kanë problemk aspektin financiar. Jo vetëm për Ministrinë e Mjedisit, por gati për të gjitha organet janë sugjeruar hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore, rregullatore e procedurale që lehtësojnë zbatimin e kërkesave të legjislacionit dhe ndihmojnë ndjeshëm në zbatimin e kërkesave të Konventës. Normalisht, këto akte do të hartohen dhe do të funksionojnë në kuadër të reformës legjislativë që po zbaton qeveria dhe organizmat e saj, të cilat, i kanë të përcaktuara këto detyrime në matricat dhe programet e tyre të punës dhe do t'i realizojnë pavarësisht nga kërkesat e planit për zbatimin e Konventës. Konventa dhe zbatimi i saj, në këtë rast, janë përfitues, ndonëse përfitimi nuk është i vogël. Nëse gjatë vitit 2005 do të thellohet procesi i hartimit të akteve rregullatore të sugjeruara, ecet në mënyrë të sigurt drejt plotësimit të të gjithë kuadrit rregullator të nevojshëm për zbatimin e kërkesave të Konventës dhe, natyrisht, që kjo përbën një fitore.

Nuk mund të mos tërhiqet vëmendja edhe te një moment tjetër, që ka të bëjë me realizimin në praktikë të mjaft veprimtarive të sugjeruara si të domosdoshme për zbatimin e kërkesave të Konventës, por që janë urdhëruar të realizohen në kuadër të angazhimeve të tjera. Sigurisht që secila prej tyre ka një kosto të caktuar, por çështja është se kjo kosto apo efektet financiare që shfaqen në këto raste u janë parafaturuar veprimtarive dhe angazhimeve të tjera. Në ligjin nr. 9108, datë 17.07.2003 "Për substancat dhe preparatet kimike", urdhërohet ngritja dhe funksionimi i Zyrës për Regjistrimin e Kimikateve, si organizëm kombëtar dhe që ngrihet për herë të parë në vendin tonë, nga e cila pritet vendosja e rregullave në fushën e administrimit të kimikateve dhe një informacion i bollshëm për to, i cili, aktualisht, mungon. Po kështu, në ligjin nr.8934, datë 05.09.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit", urdhërohet ngritja dhe funksionimi i organizmave mjedisore në përbërje të institucioneve qendrore dhe në organet e qeverisjes vendore, prej të cilave pritet të marrin realisht në dorë zbatimin e detyrimeve të këtyre organeve për zbatimin e Konventës. Realizimi në praktikë i këtyre detyrimeve ligjore gjatë vitit 2005 do të jetë, në fakt, zgjerim dhe fuqizim i rrjetit institucional, i domosdoshëm për të realizuar përmirësime të ndjeshme në zbatimin e Konventës. Ai do të realizojë komunikimet dhe shkëmbimet e informacionit në nivel shtetëror, që, siç dihet, nuk funksionojnë si duhet; do të mundësojë ngritjen e rrjetit kombëtar të pikave të kontaktit të ngarkuar me zbatimin e kërkesave të Konventës; do të publikojë informacionet dhe do të kujdeset për tërheqjen e publikut në vendimmarrjet për çështje të mjedisit. Me këto vlera e ndikime

pozitive, përmirësimet institucionale, që u përmendën, sigurisht që krijojnë terrene optimale, në rrafshin institucional, aq të nevojshme për zbatimin e Konventës.

Deri këtu, krijohet përshtypja sikur kjo strategji e ky plan veprimi, madje, dhe gjithë puna për zbatimin e kërkesave të Konventës, e paska të zgjidhur aspektin financiar dhe se shqetësimet për të siguruar mbështetjet financiare, qenkan të kota apo të ekzagjeruara. Një gjë është e qartë dhe mëse e sigurt: sado të mbështetura, të mbuluara e përfituese të jenë shumë veprimtari që sugjerohen të kryhen, sado të jenë rezultate përpjekjet për ta zvogëluar sasinë e veprimtarive që kërkojnë mbështetje të drejtpërdrejtë financiare, ato që mbeten, ato që kanë medoemos një kosto dhe duan një faturë individuale se ndryshe nuk mund të kryhen, janë akoma të shumta e të larmishme. Çështja është si mund të sigurohet mbështetja e nevojshme financiare për to. Po e theksojmë që në fillim se parimisht ekzistojnë shumë mundësi edhe në realitetet e vendit tonë dhe rezultatet do të varen nga angazhimet dhe aftësitë për t'i shfrytëzuar këto mundësi.

Siç dihet, në vendin tonë janë aktive dhe veprojnë disa programe për mjedisin a për përbërës të tij. Për më tepër, këto programe zhvillohen edhe në fusha të tjera dhe që, me pak përpjekje, mund të shfrytëzohen që të sjellin ndikime pozitive ndaj mjedisit, përfshi edhe zbatimin e Konventës. Nëse zbulohen lidhjet e Konventës me këto programe, kur identifikohen synime e pika të përbashkëta midis tyre, kur projektohen alternativa me përfitime të ndërsjella e të dobishme për të dy, jemi brenda kufijve të normalitetit bashkëpunues dhe themi se është ndërtuar traseja për të zgjidhur me natyrshmëri edhe problemet e mbështetjes financiare, që nevojitet për të mbuluar disa nga veprimtaritë që sugjerohen për zbatimin e Konventës. Ka një varg të gjatë veprimtarish konkrete të sugjeruara si veprime të detyrueshme të organeve të ndryshme shtetërore, që do të sjellin përmirësime të dukshme në praktikat e informimit të publikut, të tërheqjes e të pjesëmarrjes së tij në problematika mjedisore. Shumë prej tyre, për të mos thënë të gjitha, janë pjesë e natyrshme e synimeve të programeve që zbatohen dhe, si të tilla, mund të mbulohen financiarisht nga këto programe, edhe pse kërkojnë të zbatohen në kuadër të veprimtarive zbatuese të Konventës. Duke ecur nga këto mendësi dhe duke kërkuar zgjidhje të tilla, zbatimi i sugjerimeve të planit të veprimit mund të përfitojë shumë, akoma më tepër kur flitet për veprimtari konkrete zbatuese ku jemi ende deficitarë.

Gati e njëjta gjë mund të thuhet edhe për projektet që zbatohen në vendin tonë. Nëse do të tentonim të listonim projekte që aktualisht zbatohen për mjedisin dhe për të gjitha fushat e tjera, sigurisht që lista do të ishte shumë e gjatë, por ajo që duhet nënvizuar në këtë rast është se të gjitha projektet e kanë komponent të detyrueshëm komunikimin me publikun e zonës ku realizohet projekti, informimin dhe tërheqjen e tij në veprimtaritë e projektit. Kur këto komponentë realizohen me nivel, përftohen zbatime konkrete të kërkesave të Konventës dhe, kur bëhet e mundur që këto komponentë të merren përsipër nga organizma a OJF jashtë projektit e si nënkontraktore të tij, çështja e financimeve është e zgjidhur dhe rezultatet supozohen më të efektshme e më të drejtpërdrejta në favor të zbatimit të Konventës.

Siç dihet, tashmë, është i konsiderueshëm numëri i Konventave dhe i Protokolleve mjedisore, në të cilat vendi ynë është palë nëpërmjet nënshkrimit, ratifikimit apo aderimit në to. Lidhjet e ndërsjella të tyre me Konventën e Aarhusit janë, gjithashtu, të njohura e të zbuluara, ndërkohë që në kuadër të secilës ndërmerren mjaft veprimtari

zbatuese, që i shërbejnë edhe zbatimit të Konventës së Aarhusit. Shfrytëzimi i veprimtarive që realizohen në kuadër të Konventave dhe Protokolleve mjedisore, për sa kohë që janë të mbuluara e të mbështetura financiarisht, është një hapësirë që duhet përdorur më mirë për të realizuar mjaft nga sugjerimet për zbatimin e Konventës së Aarhusit. Me këmbëngulje dhe përpjekje të kuptueshme për fazën që jemi, mjaft nga OJF-të mjedisore, në këtë hapësirë kanë mundësi të gjera të realizojnë projekte të rëndësishme dhe me peshë, që kanë përfitime të dyfishta: edhe OJF-të rriten e maturohen, edhe kontributet e tyre bëhen më të dukshme në zbatimin e Konventës.

Nën synimin e angazhimit sa më intensiv të OJF-ve në zbatimin e kërkesave të Konventës, çka është edhe një nga drejtimit kryesore të saj dhe, kur dihet se shoqatat janë më të zbuluarat nga pikëpamja financiare, vlejné të mbahen parasysht edhe disa rekomandime të tjera.

Ka një angazhim të Ministrisë së Mjedisit, dhe jo vetëm të kësaj, që të mbështeten financiarisht projekte të OJF-ve, duke e vlerësuar këtë si një ndihmesë konkrete të shtetit për fuqizimin e tyre dhe për rritjen e kontributeve që ato pritet të japin në zhvillimin e demokracisë. Në vazhden e përvojës që po fitohet vit pas viti në këtë mbështetje, organet shtetërore duhet të rrisin progresivisht pjesën e buxhetit të tyre të destinuar për mbështetjen e projekteve të OJF-ve, të shpallin njoftime për objektiva e përparësi që kërkojnë t'i përballojnë me projekte, të përpunojnë rregullat dhe procedurat e hartimit, të paraqitjes, të pranimit e të shqyrtimit të projekteve dhe këto t'ua njoftojnë publikisht OJF-ve; ndërkohë që OJF-të pritet të konkurojnë me projekte dinjitoze. Në këtë bashkëpunim ka nevojë të fitojnë gjithnjë e më shumë terren mendësitë bashkëkohore që organi shtetëror pranon dhe beson se disa shërbime mund t'i kryejnë OJF-të dhe është dakord që për to të paguajë, ndërkohë që duhet të humbasin terren mendësitë se organi është i detyruar që ca para t'ua japë disa OJF-ve, se kështu duhet, dhe ato i vlerëson si shpenzime të kota.

Ka mëse dy vjet që Ministria e Financave ka porositur ministrinë e linjës që secila prej tyre, nga buxheti që u jepet, të veçojnë pjesën që do ta përdorin në dobi të mjedisit. Jo vetëm kaq, por me ligjin e ri për mbrojtjen e mjedisit, ministrin të Mjedisit i është dhënë e drejta të bashkëpunojë me ministrat e tjerë për të saktësuar pjesën e mjedisit në buxhetet e tyre dhe për të vendosur përdorimet sa më racionale të këtyre fondeve në dobi të mjedisit. Sigurisht që për kushtet konkrete të vendit tonë, kjo është një hapësirë mëse interesante, nga e cila mund të përfitojnë OJF-të dhe të gjithë të angazhuarit në zbatimin e Konventës. Nëse arrihet të bëhen në kohën e duhur rakordimet e nevojshme për identifikimin, veçimin dhe përcaktimin e drejtimeve të përdorimit të këtyre fondeve, mund të sigurohen mbështetje të sigurtat e të garantuara financiare për realizimin e shumë veprimtarive të sugjeruara në këtë material. Tashmë, mund të quhet e konsoliduar përvoja që buxheti i shtetit jep fondet vjetore për të realizuar monitorimin ritmik të gjendjes dhe të cilësive të mjedisit. Nëpërmjet tyre bëhet i mundur angazhimi i instituteve të specializuara për të realizuar monitorimet dhe nëse institutet e angazhuara realizojnë me nivel sugjerimet e këtij materiali, që kanë të bëjnë me rritjen e cilësisë së monitorimeve dhe me publikimin e të dhënave e të informacioneve që disponojnë, vendoset në funksionime normale një pjesë kryesore e kërkesave të Konventës, realizohet për herë të parë në vendin tonë informimi vijues i publikut për gjendjen e mjedisit dhe çka është më e rëndësishme, me të dhëna e informacione cilësore. Është e qartë që kjo ndikon fuqishëm në zbutjen e ndikimeve financiare për zbatimin e Konventës.

Nuk kanë reshtur dhe as mendohet që të zvogëlohen apo të tkurren për momentin mundësitë që ofrojnë donatorët dhe mbështetësit e ndryshëm për përmirësimin e gjendjes së mjedisit në Shqipëri. Madje, në disa raste vërehet paaftësia e OJF-ve dhe e organizmave të tjera për t'i bërë ata të interesuar dhe aktiv në mbështetjen e projekteve të ndryshme. Çështja e konceptimit të projekteve të vlefshme e të pranueshme nga donatorët, rritja e aftësive për të merituar dhe absorbuar fonde të mundshme apo të paracaktuara, përbën një moment kyç ku kërkohen përmirësime të ndjeshme e të shpejta. Shfrytëzimi i këtyre mundësive e zbut shumë problemin e koklavitur të sigurimit të mbështetjeve të nevojshme financiare për të siguruar rezultate të prekshme në zbatimin e Konventës.

Dhe së fundi, në këtë linjë të parashtrësive, meritojnë vëmendje edhe dy momente: Siç dihet, të gjitha subjektet dhe operatorët e veprimtarive ndotëse janë të detyruara me ligj të realizojnë vetëmonitorimin e veprimtarive të tyre dhe të publikojnë të dhënat e rezultatet që dalin prej këtyre monitorimeve. Gjithashtu, me legjislacionin e ri mjedisor ato janë të detyruara të mbajnë regjistrat e ndotësve dhe të shkarkimeve që gjeneron veprimtaria e tyre në tokë, në ujë e në ajër dhe të dhënat e këtyre regjistrave t'i publikojnë në afatet kohore që kërkon ligji. Insistimi i Inspektoratit të Mjedisit dhe i ARM-ve që operatorët t'i zbatojnë me përpikëri këto detyrime, do të sjellë përmirësime të ndjeshme në informimin e publikut të interesuar e të ndikuar. Gjithashtu, sipas legjislacionit të ri mjedisor, subjektet që duan të zbatojnë projekte e veprimtari që kanë apo mund të kenë ndikime negative në mjedis, janë të detyruara të komunikojnë me komunitetin lokal, pranë të cilëve do të zbatohet projekti a veprimtaria. Edhe më tej, në kuadër të procedurave për vlerësimin e ndikimit në mjedis e të marrjes së lejes mjedisore, subjektet duhet të përballojnë debatin publik që organizohet në qeverisjen vendore, ku do të zbatohet veprimtaria. Këto praktika mundësojnë jo vetëm informimet e publikut, por edhe tërheqjen e tij në problematikat mjedisore dhe kontribuojnë ndjeshëm në zbatimin e kërkesave të Konventës, ndërkohë që shpenzimet dhe kostot përballohen përgjithësisht nga subjektet dhe operatorët. Më së paku, këto vlerësohen si rrugë që ulin kostot dhe shpenzimet për zbatimin e Konventës, duke detyruar një shpërndarje të tyre midis shtetit dhe investitorëve e biznesit.

KREU V

MONITORIMI I ZBATIMIT TË KONVENTËS

1. Monitorimi i zbatimit të planit dhe programeve

Zbatimi në praktikë i kërkesave dhe i sugjerimeve të planit të veprimit, i detajimeve të specifikuar në programe të ndryshme kombëtare e lokale, në bazë dege a institucioni dhe, në përgjithësi, ecuria e zbatimit të Konventës përfaqëson një proces disi të komplikuar për t'u ndjekur. Momente të tilla, si sigurimi i informacioneve të sakta dhe në kohën e duhur për veprimtaritë që janë realizuar, nevoja e raportimit nga secili i detyruar për detyrat që ka realizuar, hartimi i një pasqyre të saktë se si ecën ky proces në shkallë vendi, rajoni, në drejtime të veçanta për secilën nga të tria të drejtat që parashikon Konventa etj., e bëjnë të domosdoshëm drejtimin dhe organizimin e procesit zbatues. Është krejt e natyrshme që me këto funksione do të vazhdojë të jetë e ngarkuar Ministria e Mjedisit. Në bashkërendime dhe akorde me ministritë e linjës, me qeverisjet vendore, me institutet kërkimore-shkencore, me OJF-të e me të gjithë të angazhuarit për zbatimin e Konventës, ajo do të vazhdojë të kërkojë më me insistim dhe në rrugë institucionale realizimin e efektshëm të angazhimeve nga secili i detyruar. Kjo pa dyshim që do të japë rezultate, por përvoja tregon se në rastet e zbatimit të dokumenteve me shtrirje të gjerë institucionale, ku përfshihen shumë aktorë, bëhet i nevojshëm një organizëm ndërsektorial i përkohshëm, që çon përpara punët zbatuese. Në rastin konkret, një organizëm i tillë mund të ishte në nivel zëvendësministrash dhe me pjesëmarrje të përfaqësuesve të OJF-ve, që do të ndiqte zbatimin e Konventës përkundrejt planit të veprimit e programeve të detajuara. Kjo zgjidhje nuk e përjashton nga përgjegjësia Ministrinë e Mjedisit, përkundrazi e vë edhe atë në pozita më kërkuese ndaj vetes dhe ndaj të tjerëve.

Skema e funksionimit sugjerohet të jetë pak a shumë e tillë:

Mbi bazën e kërkesave të Konventës, të legjislacionit të ri mjedisor dhe të sugjerimeve të këtij materiali, organet e ndryshme dhe secili i detyruar duhet:

- Të hartojë programin e angazhimeve të tij konkrete për administrimin dhe mbrojtjen e mjedisit.
- Në këtë program trajtohen si zë më vete angazhimet në funksion të zbatimit të Konventës.
- Angazhimet, veprimtaritë, masat dhe aksionet, që programohen për t'u zbatuar, sistemohen në të menjëhershme, afatmesme e afatgjata.
- Programet i dërgohen Ministrisë së Mjedisit, e cila, mbi bazën e tyre ndërton programin vjetor, të cilin ia paraqet për shqyrtim dhe miratim organizmit ndërsektorial që do të krijohet. Ky program, pasi të miratohet, publikohet në sistemet elektronike të Ministrisë së Mjedisit.
- Çdo i detyruar, në fund të çdo viti, harton raportin për zbatimin e programit të tij, i cili, gjithashtu, publikohet në version elektronik.

Arsyet dhe logjikat që i bëjnë të domosdoshëm drejtimin dhe organizimin e procesit zbatues, janë të vlefshme dhe dominuese edhe për nevojën e monitorimit të këtij procesi. Në praktikat bashkëkohore, koncepti i monitorimit të veprimtarive zbatuese është themelor, ca më tepër që në këtë rast kemi të bëjmë me një proces relativisht të

gjatë, gjithëpërfshirës dhe me pretendime prestigjioze.

Veçse do të ngushtojë sferën e spontaniteteve e të neglizhencave që nuk janë të huaja në realitetet aktuale, monitorimi i procesit zbatues do të disiplinojë sa të jetë e mundur zbatuesit, do të informojë në vijimësi publikun për ecurinë e procesit dhe do të japë argumente bindëse për të bërë ndërhyrje e riparime të dobishme në angazhimet e aktorëve dhe në vlefshmërinë e tyre.

2. Caktimi i një strukture monitoruese në nivel kombëtar, rrjeti i saj në qarqe e rrethe

Në përputhje me natyrën dhe me synimet e Konventës së Aarhusit, duket se monitorimi i procesit zbatues do t'i shkonte shumë mirë një OJF-je mjedisore të njohur, me përvojë dhe të afirmuar në kuadrin e OJF-ve, që veprojnë në vendin tonë. Kësaj OJF-je do t'i binte barra të krijonte lidhjet me organet shtetërore të angazhuara në zbatimin e Konventës, të konsolidonte bashkëpunimet me simotrat e saj në rrethe, që do ta furnizojnë me të dhëna për punën që bëhet në nivel lokal, do të sugjeronte indikatorë sa më analitikë që shprehin punën e bërë dhe, në tërësi, shumë shpejt do të konsolidohej si organizëm me njohuri të plota, i dëgjueshëm dhe i respektuar për ecurinë e zbatimit të Konventës.

Këmbëngulim në këtë sugjerim dhe shpresojmë të përkrahet kjo zgjidhje edhe për arsyen e rëndësishme se nëpërmjet saj do të funksionojë për herë të parë në fushën e mjedisit shqiptar monitorimi i pranuari i veprimtarisë së organeve shtetërore nga një OJF. Dhe për realitetet tona kjo nuk është pak. Madje, në sfondin e zbatimit të kërkesave të Konventës kjo zgjidhje përfaqëson një tregues shumë cilësor për vlerësimin nga shteti të rolit e të kontributeve që janë të afta të japin këto organizma të shoqërisë civile.

Sigurisht që kjo zgjidhje është njëherësh edhe një barrë shumë e rëndë për një OJF, barrë reale dhe jo potenciale. Prej saj kërkohen shumë angazhim, përpjekje të gjithëfarshme për të vendosur lidhjet e për të siguruar të dhënat, përpunim skemash e programesh dhe përpjekje për funksionimin e tyre etj. Në këtë kontekst, ajo meriton mbështetje e përkrahje prej shumëkujt, kërkon mirëkuptimin e të gjithë aktorëve. Akoma më konkretisht, nëse, realisht, duam që kjo skemë të funksionojë, e quajmë të domosdoshme që të paktën 2 vjetët e para (2006-2007) sa të konsolidohet, monitorimi i zbatimit të Konventës të vlerësohet si një projekt parësor dhe të mbështetet si i tillë, duke shfrytëzuar mundësitë dhe hapësirat ekzistuese në kuadër të asistencave që jepen për zbatimin e Konventës.

3. Përcaktimi i indikatorëve për të matur punën zbatuese

Hapi tjetër, jo më pak i komplikuar dhe ku nuk mund të pretendohet se ekziston ndonjë përvojë e pasur, ka të bëjë me përcaktimin e treguesve, mbi bazën e të cilëve do të matet puna zbatuese. Është e njohur që treguesit diferencohen në tregues të gjendjes dhe në tregues të progresit. Në të dy këto grupe bëhen përpjekje për të përcaktuar tregues të thjeshtë, të matshëm e të numërueshëm, të cilët janë të aftë të karakterizojnë me të dhëna të kursyera anët sasiore dhe cilësore të procesit që monitorohet.

Sigurisht që ky material nuk mund të ofrojë një listë të gatshme treguesish, por nga mënyra si është ndërtuar, përpjekjet që ka bërë për të identifikuar detyra konkrete për aktorë konkretë, është një bazë e mirë nga mund të nisët puna për përcaktimin e treguesve që do të përdoren. Në planin praktik, përcaktimi i treguesve është fryt i bashkëpunimeve dhe marrëveshjeve të monitoruesit me zbatuesit e planit e të programeve të miratuara. Treguesit nuk mund të jenë të parapërgatitur a të listuar dhe të detyrueshëm për zbatuesit, pa pëlqimin e tyre paraprak. Nga ana tjetër, nuk mund të pretendohet që qysh në fillim të arrihet lista e plotë e treguesve dhe të futet menjëherë në zbatim. Duket se do të fillohet me disa tregues të pranuar, të cilët do të shtohen progresivisht në varësi të përpjekjeve mirëkuptuese të monitoruesit e të zbatuesve.

Nëse ky material nuk mund të japë një listë treguesish, ndërkohë ai insiston dhe konfirmon se është në synimet e tij që monitorimi të realizohet mbi bazën e indikatorëve, jo vetëm si metoda më e mirë, por edhe për ta shfrytëzuar këtë shans që kjo përvojë të çajë rrugë e të bëhet normale edhe në fushën e mjedisit.

Megjithatë, për të qenë sa më i dobishëm dhe ndihmues në zbatimin e sugjerimeve që po jep, sa për ilustrim, po përqëndrohemi në disa momente. Në këtë material është insistuar që ministrinë e linjës të zbatojnë gjatë vitit të ardhshëm detyrat ligjore në fushën institucionale, që kanë të bëjnë me krijimin brenda strukturave të tyre të njëjësive mjedisore. Për të fiksuar se si është gjendja aktuale dhe përparimet e bëra, do të mjaftonin një tregues i gjendjes (sa ministri nuk kanë organizma të tilla) dhe një i progresit (sa ministri i krijuan këto organizma gjatë vitit 2004). Po kështu, në material është kërkuar që institucionet që disponojnë të dhëna për mjedisin, të listojnë dokumentacionet ku janë këto të dhëna dhe t'i vënë në dispozicion të publikut me sisteme elektronike apo me metoda të tjera lehtësisht të përdorshme. Edhe në këtë rast do të mjaftonin dy-tre tregues për të karakterizuar gjendjen dhe progresin. Në këtë mënyrë mund të vazhdohet për një mori kërkesash e veprimesh që kërkohen të kryhen nga të detyruarit në zbatimin e Konventës.

Ndihmë të vlefshme në përcaktimin e treguesve japin edhe dokumentet që hartohen nga organet e ndryshme shtetërore, ku pasqyrohet puna e tyre për realizimin e programeve, të përparësive, të matricave, të strategjive etj. për të cilat këto organe raportojnë vazhdimisht. Nga kjo punë, që kryhet në vijimësi, mund të shfrytëzohen shumë tregues të gatshëm në dobi të monitorimit të zbatimit të Konventës.

Me këtë rast, vlen të theksohet edhe një rrethanë: Ndjekja e zbatimit të Konventës, rezultatet që arrihen në veprimtarinë zbatuese ka nevojë të gjykohen me të dhëna të sakta dhe me metodika shkencore. Në këtë optikë duket se do të jenë të nevojshme që edhe anketimet, testimet, vëzhgimet e kryera me iniciativë nga struktura monitoruese edhe analizat e rezultatet e të dhënave që sigurohen prej tyre, të kryhen nga sociologë, sepse garantojnë nivel dhe cilësi shkencore.

4. Hartimi dhe miratimi i dokumentacionit standard që pasqyron punën zbatuese dhe komunikimin e të dhënave

Duke evidencuar nevojën e operimit me dokumentacion të standardizuar, ky material ka si synim që të konsolidohet përvoja e hartimit dhe e përdorimit të dokumenteve të

formatuar e të standardizuara, e cila, tashmë, ka nisur dhe është e pranishme në fushën e mbrojtjes së mjedisit. Thellimi i kësaj nisme edhe në kuadër të monitorimit të procesit për zbatimin e Konventës, ndihmon publikimet, lehtëson shkëmbimet e të dhënave, jep mundësi që për analizën e tyre të përdoren metoda të përparuara statistikore dhe matematikore dhe, në tërësi, është ndihmesë për vetë procesin monitorues.

Në këtë angazhim, ky material tërheq vëmendjen në vlerësimin më të kujdesshëm të një sërë dokumenteve të përmendura, të cilat gjatë vitit 2005 duhet të jenë të zbatueshme, si:

- regjistrat e ndotësve, regjistrat e shkarkimeve, regjistrat e kërkesave të publikut për informacion etj;
- programet vjetore të punës për secilin aktor;
- listimet e identifikuara në material për të dhënat e informacionet që disponohen në nivele e drejtime të ndryshme për secilin organ;
- formatimi i dokumentave mbi bazën e të cilit subjektet ndotëse të raportojnë të dhënat për shkarkimet që gjeneron veprimtaria e tyre;
- krijimi i dosjeve mjedisore për secilin subjekt të pajisur me leje mjedisore etj.

5. Lidhjet me Sekretariatit e Konventës

Lidhjet me Sekretariatit e Konventës, siç i parashikon vetë Konventa, përfaqësojnë veprimtari të rëndësishme, të dobishme në disa plane, si për raportuesin e ca më shumë për Sekretariatit, i cili do të dijë në çdo kohë se si po ecën zbatimi i Konventës, të bëjë përgjithësime e ndërhyrje të nevojshme, si dhe të përhapë përvoja të dobishme që procesi zbatues të jetë sa më rezultativ.

Jo vetëm në parim, por edhe praktikisht me Sekretariatit e Konventës mund të mbajë lidhje kushdo, duke e informuar, duke i kërkuar ndihmë, duke evidencuar ankesa për dobësi të procesit zbatues etj. Në mënyrë të veçantë Ministria e Mjedisit, REC-u, OJF-të e angazhuara në procesin zbatues, OJF-ja që do të monitorojë zbatimin, duhet të forcojnë lidhjet me të dhe ta informojnë në vijimësi me raporte e informacione për punën zbatuese dhe të kërkojnë prej tij asistencë sa më të gjera e të larmishme. Në këtë kontekst, raportet e informimit vjetore, përfshi realizimet gjatë vitit që mbyllet dhe programet për vitin pasardhës, janë të domosdoshme.

Tiranë, shkurt 2005

Plani i Veprimit për Zbatimin e Konventës së Aarhusit në Shqipëri

Aktivite të përgjithshme

Fusha	Veprimi	Financimi/ afati kohor	Institucioni/et Pergjegjës/e
Ndergjegjesimi	Të zgjerohen veprimtaritë njohëse në nivel lokal, me grupe konkrete dhe homogjene, si me gratë, biznesin, mediat, etj., me qëllim aktivizimin, përfshirjen e pjesëmarrjen e tyre në problematikat mjedisore.	Në vazhdimësi Buxheti i MM REC-OJF/	MM, REC, Mileu Kontakt, OJF
	Të realizohen projekte pilot për trainimin e operatorëve dhe punonjësve shtetëror qendror dhe lokal të obliguar me zbatimin ose me kontrollin e zbatimit të programeve të monitorimit dhe administrimit të regjistrave të ndotjeve, si dhe zhvillimi i programeve kombëtare e lokale, të përgjithëshme dhe sektoriale për këto veprimtari	Afatshkurtër REC, OJF-te/	MM, Inspektoriati i Mjedisit, ARM-të, Instituti i Mjedisit
	Botimet e tekstit të vetë Konventës si dhe të materialeve të thjeshta në zbërthim dhe propagandim të ideve e kërkesave të saj si dhe artikuj njohës e problemor, fletë-palosje, postera, ilustrime, etj	Afatshkurtër REC, OJF-te/	REC, MM, Mileu Kontakt, OJF
	Përkthimi, botimi dhe shpërndarja e një përmbledhjeje ligjore, me direktivat europiane mjedisore, të cilat kanë si objekt dhe si qëllim të tyre zbatimin e kërkesave të konventës.	Afatmesëm REC, MM OJF/	REC, MM, Mileu Kontakt,
	Publikimi i dokumentave të hartuar e të miratuar nga organe të ndryshme shtetërore,që kanë lidhje me mbrojtjen e mjedisit, strategjitë, planet e veprimit, planet e manaxhimit, programet e monitorimit, raportet e gjendjes së mjedisit, përmbajtja e regjistrave, vendimet e licensimit, raportet e grupeve të inspektimit.	Afatmesëm Buxheti i MM	MM, Dikasteret, REC, OJF

Realizimi i anketimeve dhe pyetësoreve për të njohur interesimin e publikut e të grupeve të ndryshme lidhur me kërkesat e konventës.	Afatshkurtër REC MM OJF/	REC, MM, Mileu Kontakt
Përfshirja në trainimet e nëpunësve civilë që organizon Departamenti i Administratës Publike, e problematikave që lidhen me mjedisin dhe Konventën e Aarhusit.	Afatmesëm Buxheti i MM	MM
Trainimi i nëpunësve të organeve lokale për legjislacionin mjedisor dhe detyrimet që rrjedhin nga Konventa e Aarhusit.	Afatmesëm MM, REC,OJF	MM, Ministritë e linjës dhe organet vendore, institute të ndryshme, OJF, Mileukontakt, etj. MM, REC, Psikologë, Sociologë, OJF, etj. MM, DAP
Integrimi i dijeve e të edukatës mjedisore në programet mësimore të shkollave të të gjitha niveleve.	Afatshkurtër Buxheti i MM,REC	
Krijimi i Katedrës së të Drejtës Mjedisore në Fakultetin Juridik	Afatmesëm Buxheti i MM	
Funksionimi i kualifikimeve pasuniversitare për të drejtën mjedisore.	Afatmesëm Buxheti i MM, MASH	
Të organizohet Konferenca Kombëtare për Ecurinë e Zbatimit te Konventës	Afatmesëm Buxheti i MM,	

		REC/	
Legjislacioni	Hartimi dhe zbatimi i programeve të vetmonitorimit, krijimi dhe administrimi i regjistrave të ndotësve, me qëllim që të arrihen normat e shkarkimeve të BE	Afatshkurtër Buxheti i MM	MM, Inspektoriati i Mjedisit, ARM-të, Ins. i Mjedisit

Shtylla e parë Informimi i Publikut

Legjislacioni	Hartimin i akteve nënligjore dhe rregullatore që bëjnë të mundur zbatimin e kërkesave që tashmë janë të sanksionuara me ligj.	Afatshkurtër Buxheti i MM	MM
	Hartimi i udhëzimeve dhe rregulloreve që përcaktojnë rregullat, afatet, mënyrat konkrete të pranimit të kërkesës për informacione dhe për dhënien e përgjigjes, të drejtën për t'u ankuar kur nuk u plotësohet kërkesa, etj.	Afatshkurtër Buxheti i MM	MM
Publikime	Publikimin e informacionit me qëllim që grumbullimi, përpunimi dhe publikimi i tij të bëhet drejtim i përhershëm i punës së organeve përgjegjëse.	Afatshkurtër Buxheti i Ministrive të linjës	MM, Ministrinë e linjës, organet vendore
	Të hartohen e miratohen sa më shpejt rregulloret dhe udhëzimet përkatëse me rregulla detyruese të thjeshta e procedura operative që mundësojnë informime të menjëhershme e pa komplikime.	Afatshkurtër Buxheti i Ministrive të linjës	MM, Ministrinë e linjës, organet vendore
	Dhënia e informacionit në raste aksidentesh industriale.	Afatshkurtër Me shpenzimet e Subjektit	MM, Subjekti përgjegjës
	Hartimi dhe miratimi i Planit Kombëtar të Veprimit për përballimin e aksidenteve mjedisore apo emergjencave civile.	Afatshkurtër Buxheti i MM	MM, MPVD
Informacioni mjedisor	Hartimi i procedurave që duhet të ndiqen në rastin e aksidenteve mjedisore apo emergjencave civile.	Afatshkurtër Buxheti i MM	MM, , MPVD organet vendore
	Të zhvillohen programet për mbledhjen dhe shpërndarjen e informacionit mjedisor në parqet kombëtare apo në zonat e mbrojtura.	Afatshkurtër Buxheti i MBU (DPPK)	MM, MBU,DPPK, DPP
	Të hartohet dhe publikohet planin i zonave që do të shpallen të mbrojtura.	Afatmesme Buxheti i MM	MM, MBU,DPPK, DPP, organet vendore

Të bëhen publike zonat e mbrojtura, të miratuara, monumentet natyrore, llojet e bimëve dhe të kafshëve, veçanërisht të mbrojtura, gjetjet minerare dhe paleontologjike, si dhe kushtet për mbrojtjen e tyre;	Afatshkurtër Buxheti i MM	MM, MBU, DPPK, DPP
Të fillojnë nga puna administratat e zonave të mbrojtura	Afatmesme Buxheti i MM dhe i DPPK	MM, DPPK, organet e pushtetit vendor
Miratimi dhe shpallja e planeve për menaxhimin e zonave të mbrojtura, për burimet ujore dhe liqenet natyrore e artificiale në këto zona.	Afatshkurtër Buxheti i MM	MM, DPPK, organet e pushtetit vendor, MM, DPPK,
Krijimi i skedareve qendror te MM per zonat e mbrojtura.	Afatshkurtër Buxheti i MM dhe i DPPK	MM, Institutet pergjegjese
Hartimi dhe miratimi i rregullave për ndërtimin, funksionimin dhe shfrytëzimin e skedarit qendror.	Afatshkurtër Buxheti i MM	MM
Perpunimi i skemes kombetare te publikimit te informacionit mjedisor	Afatshkurtër Projekti CARDS (ELPA)	MM, Ministrite e linjes
Te percaktohen strukturat e posacme ose personat pergjegjes qe do te merren me informacionin mjedisor ne institucione dhe ne qeverisjet vendore, me qellim krijimin e rrjetit kombetar te kontaktit.	Afatshkurtër Projekti CARDS (ELPA)	MM, Ministrite e linjes, organet e pushtetit vendor
Te percaktohen metodikat per perpunimin e te dhenave e pergatitjen e informacionit per ta publikuar, ne perputhje me llojin dhe natyren e informacionit	Afatshkurtër Buxheti i MM	MM, Instituti i Mjedisit

Shtylla II:

Fusha	Veprimi	Afati kohor/ Financimi	Institucioni pergjegjës
	Te identifikohen organet qe sipas ligjit realizojne vendimarrje qe kane te bejne me mjedisin.	Afatshkurtër Buxheti i MM	MM
	Te hartohen aktet nenligjore si udhezime e rregullore per proceduren qe do te ndiqet gjate procesit te terheqjes se publikut ne vendim marrje.	Afatshkurtër Buxheti i MM	MM, Ministrite e linjes
Legjislacion	Te nxitet pjesemarrja e publikut ne aktivite qe lidhen me zbatimin e programeve dhe planeve te veprimit ne mjedis.	Afatmesem Projekte te OJF-ve	MM, OJF
	Te organizohen debate me komunitetin per veprimtarite e rendesishme qe pajisen me leje mjedisore nga ministria (per procesin e VNM-se), te cilat drejtohen nga organet e qeverisjes vendore.	Afatshkurtër Shpenzime të Subjektit	MM
	Te realizohet pjesemarrja e publikut ne hartimin dhe zbatimin e programeve te monitorimit te mjedisit, ne veprimtarite kontrolluese te gjendjes e cilesise se mjedisit dhe te veprimtarive ndotese.	Afatmesëm Buxheti i MM	MM
	Te identifikohen dhe te publikohen vendimarrjet dhe veprimtarite ku terheqja dhe pjesemarrja e publikut eshte e detyrueshme sipas konventes dhe legjislacionit vendas, kjo sidomos nga organet e qeverisjes vendore.	Afatshkurtër Buxheti i MM	MM, Ministrite e linjes
	Autoritetet kompetente te informojne publikun per vendimet e marra dhe per arsyet mbi te cilat ato jane mbeshtetur per marrjen e vendimit.	Afatshkurter Buxheti i MM	MM, Ministrite e linjes, organet e qeverisjes vendore
	Te realizohet pjesemarrja e publikut ne veprimtarite per zbatimin e kerkesave te strategjive, programeve e planeve te veprimit per mjedisin	Afatmesëm Buxheti i MM	MM, OJF
Informacion	Te informohet publiku me ane te mjeteve te thjeshta te komunikimit per procedurat e pjesemarrjes.	Afatshkurtër Buxheti i MM, shpenzimet e subjektit	MM, Media, subjekti

<p>Ti kijohen kushte publikut qe te formuloje obsione dhe dhenie mendimesh, perpara miratimit te vendimeve qe i perkasin planeve dhe programeve mjedisore.</p>	<p>Afatmesëm Buxheti i MM</p>	<p>MM</p>
<p>Te hartohet Adresari i OJF-ve mjedisore kombetare.</p>	<p>Afatshkurtër Projekt i REC</p>	<p>REC, OJF</p>
<p>Te hartohen adresaret nga agjencite rajonale per OJF-te e qarkut ku ato veprojne.</p>	<p>Afatshkurtër Buxheti i MM</p>	<p>ARM</p>
<p>Tu shperndahen OJF-ve botime e materiale te Ministrise dhe te organeve te tjera qe lidhen me mjedisin dhe Konnventen.</p>	<p>Afatshkurtër Projekti i REC</p>	<p>MM, Ministrite e linjes, REC, Organet vendore</p>
<p>Te formohet ne biblioteken e MM fondi i botimeve te OJF-ve.</p>	<p>Afatshkurtër Buxheti i MM</p>	<p>MM, OJF</p>
<p>Te publikohen prioritetet e Ministrise ne fushen e projekteve dhe te nxiten OJF-te per t'u angazhuar ne hartimin e projekteve konkret.</p>	<p>Afatshkurtër, Buxheti i MM</p>	<p>MM, OJF</p>
<p>Te nxiten OJF-te per te botuar materiale ne Buletinin e Ministrise se Mjedisit.</p>	<p>Afatmesëm Buxheti i MM</p>	<p>MM, OJF</p>
<p>Te thellohet bashkepunimi i OJF- ve me simotrat e vendeve fqinje dhe te rajonit.</p>	<p>Afatmesëm Projekt i REC</p>	<p>REC, OJF</p>
<p>Te ndiqen me perparesi zbatimimi i kerkesave te MoU me OJF-te</p>	<p>Afatmesëm Buxheti i MM</p>	<p>MM, OJF</p>
<p>Te nxiten OJF-te te shkembejne informacione me organet shteterore dhe midis tyre</p>	<p>Afatmesëm Projekt i REC</p>	<p>MM, OJF, REC</p>
<p>Te zhvillohet sistemi kombetar per vleresimin e impaktit strategjik te mjedisit dhe shendetit, duke perfshire edhe kerkesat per pjesemarrjen e publikut. (strategic environmental and health impact assessment).</p>	<p>Afatmesëm Buxheti i MM dhe i MSH</p>	<p>MM, MSH</p>
<p>Ne nivel qendror dhe qarqesh te vendosen numrat telefonik (telefoni i gjelber), per te ndihmuar cdo te interesuar te paraqesin ankesat, denoncimet, sugjerimet e verejtjet qe kane per administrimin e mbrojtjen e mjedisit, per ndotjet e demtimet qe konstatojne.</p>	<p>Afatmesëm Buxheti i MM</p>	<p>Inspektoriati i mjedisit, qeverisjet vendore</p>

	Te hartohet listimi i dokumentave sektorial si programe, plane, strategji dhe publikimi i tyre.	Afatshkurtër Buxheti i Ministrive të linjës	Ministrite e linjes
	Te hartohet lista e projekteve mjedisore apo qe kane ndikime ne mjedis	Afatshkurtër, Buxheti i MM	Ministrite e linjes
	Te hartohet listimi i veprimtarive te ndryshme qe kerkojne te licensohen si dhe ato qe jane licensuar nga strukturat e ministrise.	Afatshkurtër Buxheti i MM	Ministrite e linjes
	Te behen publike te dhenat vjetore te regjistrat te kerkesave per informacion mjedisor.	Afatshkurtër Buxheti i MM	Ministrite e linjes
	Te caktojne piken e kontaktit dhe personi pergjegjes qe do t'u pergjigjet kerkesave te publikut per informacion mjedisor. Ky person duhet te mbaje lidhje me piken fokale te Ministrise se Mjedisit.	Afatshkurtër Buxheti i MM	Ministrite e linjes
Ndergjegjesim	Te krijohen dhe te administrohen regjistrat e kerkesave te publikut per informacion mjedisor.	Afatshkurtër Projekt i REC	Ministrite e linjes
	Te bashkepunohet me OJF-te per festimin e diteve te Kalendarit Mjedisor.	Afatshkurtër Buxheti i MM	MM,OJF
	Te kryhen veprimtari kualifikuese me perfaqesues te OJF-ve si per hartimin e projekteve, per njohjen me synimet e Ministrise, per zberthim ligjesh, konventash e programesh per te implementuar strategji e plane te miratuara,etj.	Afat mesem Projekt i REC	MM, OJF, REC
Pjesemarrja	Te realizohet mundesia per pjesemarrjen e publikut ne vendim marrje qe kane ndikime mbi shendetin.	Afatmesem Buxheti i MM	MM, MSH

Shtylla III:

Fusha	Veprimi	Afati kohor/ Financimi	Institucioni pergjegjes
Informacioni	Te informohet publiku per te drejtat dhe garancite ligjore qe ai gezon ne legjislacionin shqiptar (psh. ne Kodin Civil, ne Kodin e Procedures Civile, ne Kodin e Procedurave Administrative)	Afatshkurter Projekte te REC	MM, MD, Ministrite e linjes
	Te informohet publiku per te drejtat qe ia garanton Konventa e Aarhusit dhe Direktiva e 2003 e Parlamentit e te Keshillit European.	Afatshkurter Projekte te REC	MM, REC, OJF
	Te informohet publiku per te drejten e tij te ankimimit nga pikepamja proçeduriale.	Afatshkurter Projekte te REC	MM,MD
	Te informohet publiku se per ceshtje te mjedisit, ka te drejte te ankimoj edhe ne Gjykatën Nderkombetare te Hages.	Afatshkurter Projekt i REC	MM, MD, OJF
	Te krijohet nje zyre a nje organizem paragjyqsor me kompetenca qe te zgjidhe problemet e mjedisit dhe shendetit.	Afatmesem Projekt i REC	MM, OJF
	Te percaktohen detyrimet per komunikimin me publikun dhe per realizimin e pjesemarrjes se publikut ne vendim marrje ne kuader te procesit te licensimit dhe te VNM-se.	Afatshkurter Buxheti i MM	ARM
	Te hartohen dhe te publikohen ne nivel qarku raporte me te dhenat qe tregojne gjendjen e mjedisit te cdo juridiksioni te caktuar.	Afatmesem Buxheti i MM, Projekti SIDA	ARM, Organet e pushtetit vendor
	Te organizohen grupe kontrolli mjedisor me pjesemarrjen e perfaqesuesve te komunitetit e te OJF-ve.	Afatmesem Buxheti i MM	Inspektoriati i mjedisit
	Te hartohen dhe te zbatohen projekte pilot per te ndihmuar personat fizikë e juridikë për të realizuar vetëmonitorimin, verifikimin dhe zbatimin e sistemeve të integruara të administrimit.	Afatmesem Buxheti i MM	Inspektoriati i mjedisit
Ndergjegjesim	Te realizohen me punonjesit e organeve te ndryshme shteterore dhe te drejtesise veprimtari njohese per legjislacionin mjedisor, Konventen dhe me direktivat perkatese te BE.	Afatshkurter Projekte te REC, Buxheti i MM	MM, MD
	Te trainohet punonjesit e organeve shteterore per te realizuar zbatimet praktike te te drejtes per t'u ankuar ne gjykate.	Afatshkurter Projekt i REC	MM, MD

	Te realizohen veprimtari njohese e ndergjegjesuese me komunitetin e me biznesin lokal per konventen e per legjislacionin e ri mjedisor.	Afatmesem Projekte te REC, OJF, Buxheti i MM	MM, ARM, REC
	Te hartohet dhe te publikohet plani i kontrolleve mjedisore ne shkalle vendi dhe ne nivel lokal.	Afatmesem Buxheti i MM	Inspektoriati i mjedisit
	Te hartojne dhe te zbatojne programet per trainimin e tyre ne bashkepunim me Ministrine e Mjedisit.	Afatshkurter Buxheti i MM	Ministrite e linjes, MM, REC
	Organizimi i veprimtarive njohese, zbethyese e sensibilizuese me biznesin per legjislacionin e ri mjedisor. Te realizohet bashkepunimi dhe informimi me mediat Te kryhen trainime mjedisore te gazetareve te rinj.	Afatshkurter OJF, Projekte te REC, Buxheti i MM	Media, MM Media, MM, REC
Legjislacion	Te plotesohet legjislacioni aktual me norma qe t'i njohin publikut te drejten qe te ankohet ne gjykate edhe kur i cenohen, i pengohen, i vonohen, etj, te drejatat e tij per informacion mjedisor e per te marre pjese ne vendimarrjet per mjedisin.	Afatmesem Buxheti i MM	MM, MD
	Te krijohet gjykata mjedisore, fillimisht si nje nendarje e gjykates administrative.	Afatgjate Buxheti i MD	MM, MD
	Te zbatohet kerkesa ligjore qe ministrite e linjes te krijojne pikat e kontaktit per probleme mjedisore, brenda strukturave te tyre.	Afatshkurter Buxhetet e Ministrive te linjes	Ministrite e linjes
	Te hartojne rregulloret e brendshme per zbatimin e detyrave konkrete te ketyre organizmave.	Afatshkurter Buxhetet e Ministrive te linjes	Ministrite e linjes

	Te hartojne metodikat, rregullat e procedurat per publikimin e informacioneve mjedisore qe disponojne.	Afatshkurter Buxhetet e Ministrive te linjes	Ministrive e linjes
	Te hartohen Planet Lokale te Veprimit per Mjedisin sipas nje programi paraprak te hartuar mes Ministrise se Mjedisit dhe Ministrise se Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit	Afatmesem Projekte te REC, Projekti SIDA	Organet e qeverisjeve vendore
	Te realizohen kontakte me organizmat qe perfaqesojne biznesin.	Afatshkurter Projekt i REC	Organizatet profesionale te biznesit
Masa organizative	Te krijohet organizmi ndersektorial ne nivel qendror qe do te organizoje dhe do te ndjeki zbatimin e konventes.	Afatshkurter Buxheti i MM	MM, REC
	Dikasteret dhe qeverisjet vendore (qark, rreth) te hartojne dhe te publikojne programin vjetor te veprimtarive qe do te kryejne per zbatimin e konventes.	Afatshkurter Buxheti i MM	MM
	Ne fund te cdo viti, dikasteret dhe qeverisjet vendore te hartojne dhe te publikojne raportin per realizimin e programeve veti qe do te kryejne per zbatimin e konventes.	Afatshkurter Buxheti i MM	MM
	Te njoftohet sistematikisht sekretariati i konventes per ecurine e zbatimit te saj dhe te kerkoet asistence per thellimin e procesit zbatues	Afatshkurter Buxheti i MM OJF	MM, REC, OJF

Shtojca:

- **Konventa e Aarhusit (teksti)**
- **Lista e kuadrit ligjor mjedisor në fuqi në Shqipëri**
- **Listë e botimeve rreth Konventës së Aarhusit**
- **Lista e Konventave dhe Marrëveshjeve Ndërkombëtare ku Shqipëria është palë**
- **Deklarata e Lucca-s**
- **Instruksione nga BE (2003)**
- **Botimi “The road to Aarhus”**